

Raporti për kontrollin post-legjislativ i ligjit “Për barazinë gjinore në shoqëri”

Autore: Mirela Arqimandriti, eksperte për çështje të barazisë gjinore

Kontrolli post-legjislativ i ligjit “Për barazinë gjinore në shoqëri”

Raporti për kontrollin post-legjislativ

Tabela e përmbajtjes

LISTA E AKRONIMEVE	3
HYRJE	4
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	5
GJETJET KRYESORE.....	5
RRETH KËTIJ RAPORTI	8
KONTEKSTI DHE ARSYETIMI.....	8
PËRVOJA E MËPARSHME ME KONTROLLIN POST-LEGJISLATIV DHE PRAKTIKA TË NGJASHME.....	10
KONTEKSTI POLITIK I RËNDËSISHËM PËR ZBATUESHMËRINË E LBGJ.....	12
KONTEKSTI INSTITUCIONAL I RËNDËSISHËM PËR LBGJ.....	15
KONTEKSTI I TË DREJTAVE TË NJERIUT DHE I BARAZISË GJINORE I RËNDËSISHËM PËR LBGJ.....	18
METODOLOGJIA E KONTROLLIT POST-LEGJISLATIV	20
FAZA E PLANIFIKIMIT	20
FAZA E ZBATIMIT	21
SFIDAT GJATË VLERËSIMIT TË KONTROLLIT POST LEGJISLATIV	22
GJETJET NGA ANALIZA.....	23
HISTORIKU SE SI ËSHTË PËRDORUR LIGJI DERI MË TANI DHE RËNDËSIA AKTUALE E OBJEKTIVAVE TË LIGJIT SOT.....	23
AGJENCIA ZBATUESE PËRGJEGJËSE PËR LBGJ-NË.....	24
RËNDËSIA E VERIFIKIMIT NËSE LIGJI I SHËRBEN ENDE QËLLIMIT TË TIJ	25
REKOMANDIME PËR PËRPARIMIN E STATUSIT AKTUAL TË LBGJ	43
REKOMANDIME PËR PARLAMENTIN E SHQIPËRISË.....	43
REKOMANDIME PËR QEVERINË E SHQIPËRISË.....	43
SHTOJCA.....	45
<i>Shtojca.1 Rekomandime të rëndësishme për pjesët e Ligjit të Barazisë Gjinore.....</i>	<i>45</i>
<i>Shtojca 2 : Lista e Institucioneve të konsultuara.....</i>	<i>47</i>
<i>Shtojca 3: Lista e individëve të konsultuar/intervistuar.....</i>	<i>48</i>
<i>Shtojca 4. Pyetjet kërkimore.....</i>	<i>50</i>
<i>Shtojca 5 Disa mendime shtesë për përmirësime në bazën ligjore ku duhet të mbështetet LBGj.....</i>	<i>51</i>
KUVENDI I SHQIPËRISË	56
RRJETI I KOMITETEVE PARLAMENTARE PËR TË DREJTAT E NJERIUT DHE BARAZINË GJINORE NË BALLKANIN PERËNDIMOR (HUGEN).....	58

Lista e akronimeve

CEDAW	Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave
KMD	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi
DPSBGj	Drejtoria e Përfshirjes Sociale dhe Barazisë Gjinore
DhBGJ	Dhuna me Bazë Gjinore
DhF	Dhuna në Familje
LBGj	Ligji i Barazisë Gjinore në Shoqëri
LMD	Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi
MEPJ	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
MShMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
NSGE	Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Plani i Veprimit (2016-2020)
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëveprim në Evropë
KPL	Kontrolli Post Legjislativ
FWD	Fondacioni Westminster për Demokraci
APU	Analizë Universale Periodike

Hyrje

Ky raport u përgatit me mbështetjen e nismës së Fondacionit për Demokraci Westminster (WFD) dhe Nënkomisionit për Barazi Gjinore dhe Parandalimin e Dhunës kundër Grave dhe Nënkomisionit Për të Drejtat e Njeriut, pranë Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. WDF-ja zbaton një program rajonal që synon forcimin e bashkëpunimit mes parlamenteve në Ballkanin Perëndimor, përmes krijimit të një rrjeti rajonal me komisionet të drejtat e njeriut dhe barazinë gjinore. Kohëzgjatja e zbatimit të programit është nga muaji prill 2019 deri në muajin nëntor 2021, me mbështetjen e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Norvegjisë.

Rrjeti i Komisioneve për të Drejtat e Njeriut dhe Barazinë Gjinore në Ballkanin Perëndimor¹ (më poshtë: HUGEN) u themelua zyrtarisht më 8 tetor 2019, gjatë një konference rajonale për parlamentet, e cila u mbajt në Cetinje, Malin e Zi. Rrjeti HUGEN mbledh organet për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore nga tetë parlamentet në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Në takimin e parë të këtyre organeve, u themelua Bordi i Rrjetit HUGEN që mbledhte kryetarët/nënkryetarët e komisioneve për çështjet e të drejtave të njeriut dhe barazi gjinore.

Një nga aktivitetet e para të përbashkëta të rrjetit HUGEN, ishte dhe mbështetja për parlamentet në pilotimin e procesit të kontrollit post-legjislativ. Gjatë muajit nëntor 2019, u organizua një kurs treditör për temën e kontrollit post-legjislativ, i certifikuar, për deputetët dhe shërbimet parlamentare profesionale që marrin pjesë në punimet e rrjetit. Menjëherë pas kësaj, gjashtë parlamentet përzgjedhën ligjet përkatëse që do t'i nënshtroheshin procesit të kontrollit post-legjislativ (KPL) si dhe metodologjinë përgjegjëse. Procesi rezultoi në një raport KPL që u mbështet në një proces pjesëmarrës dhe të hapur për konsultime me palë interesi të ndryshme, çka kontribuoi në cilësinë e vetë raportit KPL.

WFD dëshiron të shprehë mirënjohjen gjithë institucioneve, organizatave, individëve, ekspertëve si dhe aktivistëve që kontribuan në përgatitjen e raportit KPL. Një falënderim i veçantë i drejtohet autores së Raportit për Kontrollin Post-Legjislativ.

Qëndrimet e shprehura në këtë dokument i përkasin autorit dhe ato nuk miratohen domosdoshmërisht nga WFD, Parlamenti i Shqipërisë ose Ministria Norvegjeze e Punëve të Jashtme, të cilët nuk pranojnë të marrin përgjegjësi për këto qëndrime dhe për mbështetje të tyre.

¹ Më shumë informacion gjendet në- <https://www.hugenwb.net/>

Përmbledhje Ekzekutive

Ky punim sjell informacion për praktikën aktuale të Kuvendit të Shqipërisë për vlerësimin e zbatimit të ligjeve dhe ndikimin e tyre në shoqërinë shqiptare. Gjithashtu, punimi prezanton Kontrollin Post-Legjislativ (KPL) për Ligjin e Barazisë Gjinore në Shoqëri (LBGj) në Shqipëri. Punimi pasurohet me gjetje dhe rekomandime për procesin e përmirësimit të LBGj në të ardhmen, bazuar në opinionin e autorit dhe aktorëve të ndryshëm që kanë njohuri lidhur me funksionimin e Kuvendit dhe zbatimin e LBGj-së në shoqërinë shqiptare.

Gjetjet Kryesore

- Kontrolli post-legjislativ kryhet pjesërisht nga legjislativi shqiptar në formën e kontrollit parlamentar të parashikuar me Kushtetutë apo në rregulloren e brendshme të Kuvendit.
- Nismat për hartimin e ligjeve të reja apo për ndryshimin e atyre ekzistuese, qofshin nisma të Këshillit të Ministrave, të deputetëve apo të qytetarëve, vijnë si rezultat i vlerësimit ciklik të politikave, legjislacionit dhe vlerësimit post-legjislativ të ligjeve në fuqi. Projektligjet, krahas relacioneve shpjeguese, shoqërohen me një raport për vlerësimin e ndikimit. Megjithatë, jo të gjitha nismat ligjore shoqërohen nga ky raport i vlerësimit të ndikimit.
- Vitet e fundit janë bërë përpjekje për të rritur kapacitetin e Kuvendit për të kryer vlerësime dhe analiza të legjislacionit, kryesisht për reforma të rëndësishme dhe me ndikim të madh, si reforma në drejtësi, reforma zgjedhore apo reforma administrativo-territoriale. Këto ndryshime të mëdha në legjislacion nxisin një sërë analizash, vlerësimesh dhe raportesh para dhe pas zbatimit të tyre. Por, kjo nuk ndodh me të gjitha ligjet dhe politikat që miraton parlamenti dhe që zbatohen më pas nga pushteti ekzekutiv.
- Projektligjet e paraqitura në parlament shoqërohen me një relacion shpjegues dhe ndonjëherë hartohet dhe një raport për vlerësimin e ndikimit (RIA) që konsiston në një përmbledhje të problematikave dhe paraqet nevojën për ndërhyrje ligjore. Raportet për vlerësimin e ndikimit reflektojnë mbi elementët bazë në lidhje me analizën dhe të dhënat, duke u fokusuar në kontekstin ku vepron ligji dhe shkaqet rrënjësore të problemit që identifikohet, të cilin ligji synon të trajtojë.
- Baza ligjore për kontrollet legjislative të ligjeve është e parashikuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe në Rregulloren e Brendshme të Kuvendit të Shqipërisë. Nga këndvështrimi ligjor, kontrolli parlamentar i atribuohet së pari parlamentit, siç përcakton neni 80 i Kushtetutës.
- Një rishikim i fundit i Rregullores së Brendshme të Kuvendit të Shqipërisë përfshiu dispozita për vlerësimin *ex post*, sidomos për legjislacionin e përafuar me *acquis* të BE-së. Miratimi i një neni të ri² parashikon që për legjislacionin e përafuar duhet të ketë një rishikim të pjesëve të legjislacionit jo më vonë se 3 vjet pas zbatimit. Rregullorja gjithashtu përcakton një plan vjetor për kryerjen e vlerësimit *ex post*.
- Konteksti politik i Shqipërisë është bërë gjithnjë e më favorizues për përfaqësimin dhe pjesëmarrjen e e barabartë të grave e burrave në proceset e rëndësishme vendimmarrëse.
- Në vitin 2019, Qeveria Shqiptare renditej si një prej vendeve me kabinetin qeveritar më të barabartë në botë, pasi gratë përbënin mbi 50% të ministrave.
- Në Kuvendin e Shqipërisë është krijuar Aleanca e Grave Deputete, e cila në periudha të caktuara vepron njëzëri, pavarësisht përkatësive të kundërta partiake.

² Rregullorja e Brendshme miratuar nga Kuvendi Vendim nr. 12/2020 "Për disa shtesë në Vendimine Kuvendit nr. 166, datë 16.12.2004 "Për miratimin e Rregullores së Brendshme të Kuvendit të Shqipërisë", i ndryshuar.

- Shqipëria ka ndërtuar një mekanizëm gjithëpërfshirës për gjininë që shtrihet nga niveli lokal në atë kombëtar dhe nga pushteti legjislativ tek ai ekzekutiv e më gjerë.
- Ligji për Barazinë Gjinore është një nga mjetet më të rëndësishme në luftën për barazi gjinore në shoqërinë shqiptare, pasi përcakton kornizën institucionale dhe atë të politikave për të luftuar diskriminimin dhe pabarazitë me bazë gjinore.
- Ligji për Barazinë Gjinore është bërë funksional përmes zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore, aktualisht në përsëritjen e tij të tretë (2016-2020). Që nga miratimi i tij në vitin 2008, ligji nuk ka pësuar asnjë ndryshim.
- Gjashtë akte nënligjore janë miratuar që prej miratimit të LBGj-së.
- Analiza e zbatimit të ligjit dhe intervistat me aktorë të ndryshëm theksojnë nevojën për një rishikim domethënës të LBGj-së, nga fushëveprimi dhe objektivat, deri në funksionimin e tij.
- Dispozitat dhe sanksionet e Kodit Zgjedhor dhe LBGj-së mbi kuotat gjinore nuk janë në përputhje, prandaj një rishikim i këtij të fundit është i nevojshëm për të siguruar harmonizimin me Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.
- Rastet e diskriminimit të përfaqësuara nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konsiderojnë si bazë ligjore Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në vend të LBGj-së. Kjo ndodh për arsye se, objektivi i përcaktuar për të siguruar mbrojtje efikase nga diskriminimi për shkak të gjinisë, në Ligjin për Barazi Gjinore, nuk është funksional. Dispozita e parashikuar në këtë ligj në vitin 2008, tashmë gjendet e parashikuar në mënyrë më të avancuar në Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i cili ka gjithashtu një mekanizëm zbatues, që është Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD).
- LBGj-ja nuk përmban dispozita të posaçme mbi dhunën për shkak të gjinisë, si një nga format më të rënda të diskriminimit dhe një manifestim i pabarazive midis burrave dhe grave. Këto janë të mbuluara nga ligji për dhunën në familje. Sidoqoftë, të dy ligjet duhet të jenë të ndërlidhura dhe përafruara me njeri-tjetrin.
- Gratë shqiptare vazhdojnë të jenë të marginalizuara dhe të diskriminuara dhe LBGj-ja nuk ofron mbrojtje ndaj formave të shumta të diskriminimit. Gratë nga grupe të ndryshme përfshijnë forma të shumta të pabarazisë. Faktorë si raca, besimi, përkatësia etnike, mosha, aftësia e kufizuar, seksualiteti, vendndodhja dhe statusi i punësimit, kur gërshetohen edhe me gjininë, krijojnë përvoja veçanërisht shqetësuese lidhur me diskriminimin dhe pabarazinë. Megjithatë, këta faktorë dhe të tjerë të ngjashëm nuk gjenden të përmendur në Ligjin për Barazi Gjinore.
- Ligji e përkufizon qartë gjininë si dhe mundësitë dhe atributet shoqërore të lidhura me të qenit grua ose burrë, si dhe marrëdhëniet mes tyre. LBGj-ja në përkufizimet e tij nuk bën dallimin mes gjinisë dhe seksit. Gjithashtu, nuk përmban asgjë sa i përket "identitetit gjinor". Gjithashtu, në përkufizimet e tij nuk përfshin "dhunën për shkak të gjinisë" dhe "dhunën seksuale". Lidhur me përkufizimet gjinore, Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka përparuar duke përfshirë më shumë përkufizime dhe koncepte të lidhura me diskriminimin dhe gjininë. Prandaj, mbështetur në rregullin e teknikës legjislative, referimet për raste të diskriminimit gjinor mund të bëhen bazuar në Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Sidoqoftë, vetë LBGj-ja duhet të përfshijë më shumë përkufizime dhe koncepte gjinore, të përditësuara sipas standardeve ndërkombëtare.
- Ligji Nr. 17/2018, "Për Statistikat Zyrtare" nuk e ka marrë në konsideratë LBGj-në dhe në asnjë prej neneve të saj nuk përmendet rëndësia e të dhënave për mosmarrëveshje gjinore.
- Ligji për Barazinë Gjinore, mbështetet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Konventën "Për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Grave", dhe nga të gjitha aktet e tjera ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.³ Sidoqoftë, LBGj-ja duhet të marrë në konsideratë edhe angazhime të tjera ndërkombëtare të Shqipërisë siç janë Konventa e Stambollit dhe Direktivat e BE-së në fushën e barazisë gjinore, praktikat e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GjEDNj) dhe Gjykatës Evropiane të Drejtësisë (GjED).
- Megjithëse ligji përfshin nene të rëndësishme, disa prej tyre kanë natyrë thjesht deklarative dhe nuk kanë ndonjë ndikim për barazinë gjinore në shoqëri.

³ Neni 3 LBGj.

- Kuotat gjinore mund të konsiderohen si një objektiv i përmbushur i LBGj-së. Zbatimi i ligjit për barazinë gjinore ka çuar në përmirësimin e bilancit gjinor, në të gjitha nivelet e barazisë gjinore, veçanërisht në parlament dhe Këshillin e Ministrave. Përfshirja e kuotës gjinore në ligj ishte shtysa e nevojshme për të rritur ndjeshëm përfaqësimin e grave në proceset politike dhe në vendimmarrje. Numri i madh i grave që kanë përfituar nga kjo politikë, siç përcaktohet në LBGj, është një nga arritjet kryesore të ligjit.
- Sidoqoftë, LBGj-ja nuk ka qenë i suksesshëm në rritjen e pjesëmarrjes së grave në të gjitha sferat dhe për më tepër mungojnë të dhënat për të parë përfaqësimin e grave në disa sektorë të rëndësishëm. Për shembull, sipas INSTAT 2020, në nivelet e larta drejtuese, në vitin 2019 vetëm 1 grua mban gradën e Drejtuesit të Lartë dhe 1 grua të Drejtuesit të Parë në organet e Policisë së Shtetit. Kandidatet fituese gra për kryetare bashkie ishin 13,1 %, në zgjedhjet vendore të vitit 2019. Në sistemin e drejtësisë vihet re se, pjesëmarrja e grave është shumë e ulët në pozicionet e larta, si Kryetar i Gjykatës së Lartë, Kryetar i Gjykatës së Apelit, Kryetar i Gjykatave të Rretheve Gjyqësore dhe Kryetar i Gjykatës Administrative. Nuk ka të dhëna për përfaqësimin e grave në bordet e ndërmarrjeve publike dhe agjencive të pavarura.
- Vlen të përmendet se LBGj-ja ka pasur një ndikim pozitiv në mbledhjen dhe shpërndarjen rregullisht të statistikave në lidhje me barazinë gjinore dhe / ose të dhëna të ndara sipas gjinisë. Megjithatë, mbetet i pakënaqshëm përdorimi aktual i të dhënave, të ndara sipas gjinisë dhe statistikave gjinore për zhvillimin e politikave, buxhetimin dhe monitorimin e përparësive të zhvillimit kombëtar.
- Sistemi aktual statistikor karakterizohet nga një hendek i konsiderueshëm midis të dhënave dhe informacionit të mbledhur nga institucionet nga njëra anë, dhe treguesve të kërkuar në nivelin ndërkombëtar për monitorimin e barazisë gjinore nga ana tjetër.
- Neni 14 (hartuar për sigurimin e barazisë gjinore në nivelin lokal) i LBGj nuk është në përputhje me zhvillimet e reja në Shqipëri dhe kuadrin ligjor që rregullon çështje të pushtetit lokal ndaj dhe duhet të rishikohet.
- Ligji për Barazinë Gjinore nuk përfshin ndonjë dispozitë për buxhetimin e përgjegjshëm gjinor (BPGj) në nivelin lokal apo qendror, megjithëse që nga viti 2012 Shqipëria ka përparuar me kornizën ligjore të BPGj-së dhe zhvillimin e politikave dhe programeve në këtë fushë.
- Siç është hartuar në vitin 2008, LBGj-ja përmban nene që nuk mund të zbatohen në praktikë, pasi gjuha e përdorur është e paqartë dhe mungon mundësimi i masave konkrete për zbatim. Gjithashtu, mungojnë autoritetet përkatëse që do të mundësojnë zbatimin e tij. Konkretisht, kjo vërehet në nenin 15, shkronja “a”⁴ ku rezulton se nuk ka asnjë autoritet të përcaktuar që të mbikëqyrë respektimin e detyrimit të parashikuar në këtë nen të ligjit. Ndaj është e nevojshme parashikimi i një mekanizmi monitorues si dhe sanksione në lidhje me këtë dispozitë në mënyrë që të garantohet zbatimi efektiv i saj.
- Në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ekziston një Sektor për Barazinë Gjinore, i cili është kryesisht i ngarkuar me bashkërendimin e punës për barazinë gjinore ndërmjet ministrive të linjës, përmes punonjësve të tyre të barazisë gjinore, si dhe në nivelin lokal përmes pikave fokale gjinore dhe / ose koordinatorët kundër dhunës në familje. Në organogramën e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Sektori i Barazisë Gjinore përbëhet nga dy specialistë dhe një përgjegjës sektori. Duke marrë parasysh shumëllojshmërinë e detyrave të ngarkuara sektorit përgjegjës dhe spektrin e gjerë të çështjeve të barazisë gjinore, burimet njerëzore nuk janë të mjaftueshme për të kryer të gjitha detyrat që kërkohen prej tyre.

⁴ Ligji për Barazinë Gjinore në Shoqëri, Neni 15 - Pjesëmarrja në procesin e vendimmarrjes; 1. Përfaqësimi i barabartë gjinor në të gjitha organet e pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor dhe në institucionet e tjera publike arrihet kur: a) sigurohet përfaqësim në masën mbi 30 për qind për secilën gjini, përfshirë edhe në organet e tyre drejtuese;

Rreth këtij raporti

Në pjesën e parë të tij, ky raport prezanton informacion në lidhje me Kontrollin Post-Legjislativ (ShPL) dhe dy dimensionet kryesore të këtij procesi të rëndësishëm për të kuptuar impaktin e një ligji apo pjesë të caktuar të tij. Kjo pjesë bazohet në analizën e Udhëzuesit për Parlamentin mbi procesin KPL, hartuar nga Fondacioni Westminster për Demokraci. Pasi shpjegohet rëndësia e procesit ShPL, kjo pjesë jep një panoramë se si vlerësimi *ex ante* i ligjit organizohet në Shqipëri nga Kuvendi apo komisionet parlamentare. Gjithashtu, pjesa e parë përmban një panoramë të kontekstit institucional, politik dhe të barazisë gjinore dhe të drejtave të njeriut në Shqipëri që ka të bëjë me ligjin në shqyrtim.

Pjesa e dytë evidenton objektin e KPL-së. Kjo pjesë shpjegon pse është vendosur të kryhet KPL-ja për Ligjin e Barazisë Gjinore në Shoqëri (LBGJ). Një analizë tërësore i është kushtuar të gjitha akteve nënligjore dhe vetë LBGJ-së. Gjithashtu, kjo pjesë vazhdon me një analizë të të gjithë informacionit zyrtar në dispozicion, me analizën e neneve dhe akteve nënligjore, se si aktet nënligjore shtjellojnë nene të rëndësishme të LBGJ-së dhe se si këto ndikojnë në agjendën e barazisë gjinore në Shqipëri. Analizat në këtë pjesë bazohen në literaturë, raporte ndërkombëtare për barazinë gjinore dhe në lidhje me zbatimin e LBGJ-së në Shqipëri, në intervistat e strukturuar, gjysmë të strukturuar, vrojtime sasiore/cilësore, diskutime në grupe të fokusuar dhe të dhëna të ndara sipas gjinisë.

Pjesa e tretë prezanton gjetjet e ShPL-së në zbatim të LBGJ-së dhe nëse dispozitat e ligjit janë vënë në zbatim. Kjo pjesë hulumton se si juristët dhe qytetarët e kanë përdorur ligjin. Përveç kësaj, vlerëson ndikimin e LBGJ-së në shoqërinë shqiptare dhe nëse objektivat e politikës së ligjit janë përmbushur dhe me sa efektivitet.

Pjesa e katërt përmban rekomandime për përmirësimin e zbatimit të LBGJ-së në shoqërinë shqiptare.

Ky raport ka disa kufizime, sepse nuk përmban një vlerësim të përgjithshëm të njohurive që ka publiku shqiptar rreth LBGJ-së dhe zbatueshmërisë së tij. Kjo mund të bëhej me një vërtetim të gjerë. Gjithashtu, nuk përmban opinionet e diskutimeve me grupe të fokusuar, siç janë punonjësit e barazisë gjinore në nivel vendor dhe qendror, gjykatës, juristë, OSHC-të etj. Një kufizim tjetër lidhet me analizën për të kuptuar se si po zbatohet kuota gjinore në institucionet e pavarura. Me udhëzim të përfaqësuesve të Parlamentit Shqiptar u dërguan disa pyetje të strukturuar në 21 institucione të pavarura 13 nga të cilët kthyen përgjigje. Rezultati i paraqitur në një nga shtojcat nuk është përfaqësues për të nxjerrë përfundime në lidhje me zbatimin e kuotës gjinore në institucionet publike në Shqipëri.

Konteksti dhe arsyetimi

“Kontrolli Post-Legjislativ i referohet fazës kur parlamenti i bën pyetjen vetes: A po i arrijnë rezultatet e pritshme ligjet e vendit dhe deri në çfarë mase dhe, nëse jo, pse?”⁵

Procesi pilot i Kontrollit Post-Legjislativ po ndodh si pjesë e aktiviteteve të rrjetit HUGEN (Rrjeti i Komiteteve për të Drejtat e Njeriut dhe Barazinë Gjinore në Ballkanin Perëndimor). Programi mbështetet nga Ministria Norvegjeze e Punëve të Jashtme dhe zbatohet nga Fondacioni Westminster për

⁵ Fondacioni Westminster për Demokraci (2017). Kontrolli Post-Legjislativ: Udhëzues për Parlamentet. Faqja 7. Marrë nga https://www.wfd.org/wp-content/uploads/2018/07/ÉFD_Manual-on-Post-Legislative-Scrutiny.pdf

Demokraci (EëFD) në periudhën prill 2019-nëntor 2002. Kuvendi i Shqipërisë si pjesë e rrjetit HUGEN vendosi të eksplorojë se në çfarë mase zbatohen vlerësimet legislative *ex ante*, Vlerësimet e Ndikimit Rregullator dhe raporte shpjeguese mbi legjislacionin e ri që praktikohet ose zbatohet në Shqipëri. Gjithashtu, Parlamenti Shqiptar vendosi të analizojë, kontrollojë me metodologjinë KLP, Ligjin për Barazinë Gjinore në Shqipëri (LBGJ), sipas metodës që sugjeron WFD në "Vlerësimin Post-Legjislativ – Udhëzues për Parlamentet“.

Udhëzuesi shpjegon pse ShPL-ja është e dobishme për parlamentin. Arsyeja kryesore lidhet me faktin se, megjithëse parlamentet angazhojnë një pjesë të madhe të burimeve njerëzore dhe financiare për procesin e miratimit të legjislacionit, shpeshherë anashkalohet vlerësimi i zbatimit të legjislacionit.⁶ Sipas këtij udhëzimi, procesi i kontrollit post-legjislativ vlerëson zbatimin e ligjit, nëse dispozitat e tij janë vënë në zbatim, se si gjykatat i interpretojnë ligjet dhe se si juristët dhe gazetarët e kanë përdorur ligjin, në kuptimin më të gjerë. KPL-ja sheh ndikimin e legjislacionit, nëse janë përmbushur objektivat e synuar të politikës së ligjit dhe me sa efektivitet.⁷

Parlamentet duhet të përpiqen të kryejnë të dyja format e ShPL-së, ose të dy dimensionet e tij: (1) të vlerësojnë miratimin teknik dhe zbatimin në praktikë të një akti ligjor; (2) të vlerësojnë marrëdhënien e tij me rezultatet e synuara të politikave.⁸ ShPL-ja ose Vlerësimet e Ndikimit Rregullator (RIA) janë metodologjitë e përshtatshme për Parlamentin e Shqipërisë, sepse mund të propozojnë ndryshime (legjislative dhe jolegjislative) politikash që mund të prekin sektorin publik, privat, OShC-të apo bizneset.

Përmes një argumentimi me shkrim, deputetët vendosën të përgatitin ShPL-në për Ligjin e Barazisë Gjinore në Shqipëri. Parlamenti i Shqipërisë si shumë parlamente të tjera kërkon të dijë deri në çfarë mase është zbatuar LBGJ-ja e miratuar në vitin 2008 dhe cili ka qenë ndikimi i tij. Kontrolli Post-Legjislativ (ShPL) është përfshirë në praktikën rutinë parlamentare në mbarë botën sipas procedurave të ndryshme dhe do të jetë arritje e madhe nëse Parlamenti i Shqipërisë e miraton dhe parashikon procedura për kryerjen periodike të procesit ShPL.

Argumentimi për procesin ShPL të Ligjit për Barazinë Gjinore në Shqipëri, bazohet në faktin se, vlerësimi i zbatimit të legjislacionit, identifikimi i ndikimit të tij, ndreqja e boshllëqeve të mundshme dhe eliminimi i pasojave të pasynuara të legjislacionit, do të forcojnë dhe do të përparojnë shkallën e barazisë gjinore në Shqipëri. Zbatimi i të drejtave të njeriut shpesh vuan nga moskuptimi i duhur i ligjit, boshllëqet në legjislacion apo ekzistenca e modeleve diskriminuese të vendit.⁹ Nevojitet një përjasje tërësore e ShPL-së për të kapërcyer këto sfida dhe për të garantuar që qytetarët të përfitojnë nga mundësitë dhe mbrojtja e barabartë që u ofron ligji dhe aktet në zbatim të tij.

Një publikim i fundit i WFD-së analizon rregullat, praktikat dhe tendencat kryesore të ShPL-së në Evropë, duke u fokusuar në përvojën e shtatë parlamenteve në Belgjikë, Gjermani, Francë, Itali, Suedi, Zvicër dhe Mbretëri të Bashkuar.¹⁰ Sipas këtij dokumenti, Komisioni i Ligjeve në Mbretërinë e Bashkuar përcaktoi katër arsye kryesore pse nevojiten akte sistematike që vlerësojnë ligjet e miratuara prej parlamentit, të njohura si ShPL: 1) të shihet nëse legjislacioni po funksionon në praktikë, ashtu siç synohet 2) të kontribuohet në rregullim më të mirë të tij (aktet nënligjore); 3) të përmirësohet fokusi i zbatimit dhe arritjes së qëllimeve të politikave; 4) të identifikohet dhe të shpërndahen praktikat e mira në mënyrë që të nxirren mësimet prej sukseseve dhe dështimeve që evidenton ky kontroll.¹¹ Gjithashtu,

⁶ Po aty, fq.7

⁷ Po aty, fq.11

⁸ Po aty.

⁹ **Fondacioni i Uestminsterit për Demokraci. (2018). Ndjekja e ligjit: Lufta ndaj diskriminimit dhe shkeljeve të të drejtave të njeriut përmes kontrollit post-legjislativ**

<https://www.wfd.org/2019/10/30/following-the-law-combatting-discrimination-and-human-rights-violations-through-post-legislative-scrutiny/>

¹⁰ De Vrieze, F. (2020). Kontrolli Post-Legjislativ në Evropë. Fondacioni i Uestminsterit për Demokraci.

¹¹ Po aty.

ShPL-ja shërben për të parandaluar efektet e mundshme negative të legjislacionit të ri në çështje të të drejtave të njeriut.¹²

Për kryerjen e ShPL-së, parlamenti duhet fillimisht të ngrrejë një strukturë në organizimin e brendshëm. Gjithashtu, parlamenti duhet të evidentojë njësitë e rëndësishme (të brendshme ose të jashtme) përgjegjëse për mbledhjen paraprake të fakteve dhe masat analitike, qëllimi i të cilave është të vlerësohen efektet e zbatimit të një akti ligjor apo të një politike publike të caktuar – bazuar në një apo më shumë ligje. Me njësi të brendshme nënkuptohet ngritja e një njësie kërkimore që të zhvillojë ekspertizë autonome për vlerësimet e ndikimit legjislativ, ndërsa një njësi e jashtme nënkupton pajtimin e agjencive apo institucioneve të pavarura të jashtme me njohuri dhe përvojë specifike në fushën e vlerësimit të politikave dhe të ndikimit të legjislacionit.¹³ Në të dy rastet, parlamenti duhet të alokojë burimet e përshtatshme buxhetore dhe njerëzore për realizimin e ShPL-së. Alokimi i burimeve të mjaftueshme për realizimin e ShPL-së është parakusht për suksesin e saj.¹⁴

Përvoja e mëparshme me kontrollin post-legjislativ dhe praktika të ngjashme

Kontrolli post-legjislativ kryhet pjesërisht nga Kuvendi i Shqipërisë në formën e kontrollit parlamentar të parashikuar me Kushtetutë apo me rregulloren e brendshme dhe procedurat e Kuvendit. Janë bërë përpjekje vitet e fundit për të rritur kapacitetin e Kuvendit për të kryer vlerësime dhe analiza të legjislacionit, kryesisht për reforma të rëndësishme dhe me ndikim të madh, si reforma në drejtësi, reforma zgjedhore apo reforma administrativo-territoriale. Këto ndryshime të mëdha në legjislacion nxisin një sërë analizash, vlerësimesh dhe raportesh para dhe pas zbatimit të tyre. Por, jo gjithmonë ndodh kështu me të gjitha ligjet dhe politikat që miraton parlamenti dhe që zbatohen më pas në pushtetin ekzekutiv.

Projektligjet e paraqitura në parlament shoqërohen me një relacion shpjegues dhe ndonjëherë hartohet një Raport për Vlerësimin e Ndikimit (RIA) që konsiston në një përmbledhje të problematikave dhe nevojën për ndërhyrje ligjore, si edhe reflekton mbi elementët bazë për analizën dhe evidencat, duke u fokusuar në kontekstin ku vepron ligji dhe shkaqet rrënjësore të problemit që identifikohet, të cilin ligji synon të adresojë. Pjesë e Raportit për Vlerësimin e Ndikimit është edhe faza e vlerësimit, që përmbledh masat monitoruese dhe vlerësuese si edhe kriteret/treguesit e suksesit që janë identifikuar. Vlerësimet *ex post* janë kryer kryesisht nga komisionet parlamentare për zbatimin e legjislacionit specifik, akteve nënligjore dhe institucionet përgjegjëse për zbatimin e tyre. RIA është kryer vitet e fundit nga një njësi specifike në Kryeministri, personeli i të cilës kishte marrë trajnim të posaçëm për realizimin e RIA.

Mund të themi që në Shqipëri, në mungesë të një procesi ShPL *per se*, ekzistojnë njësi institucionale dhe procese të ndryshme që realizojnë vlerësime dhe raporte, të ngjashme me KPL-në.

Baza ligjore për kontrollet legjislative të ligjeve është e parashikuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe në Rregulloren e Brendshme të Kuvendit të Shqipërisë. Nga këndvështrimi ligjor, kontrolli parlamentar i atribuohet së pari parlamentit, siç përcakton neni 80 i Kushtetutës që thotë shprehimisht se: *1. Kryeministri dhe çdo anëtar tjetër i Këshillit të Ministrave është i detyruar t'u përgjigjet interpelancave dhe pyetjeve të deputetëve brenda tri javëve. 2. Anëtari i Këshillit të Ministrave ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet e Kuvendit ose të komisioneve të tij; atij i jepet fjala sa herë që e*

¹² Fitsilis, F. & De Vrieze, F. (2019). Si Parlamentet Monitorojnë Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm – Bazë për Zbatimin e Kontrollit Post-Legjislativ, punim i prezantuar në Seminarin Akademik për Kontrollin Post-Legjislativ në Azi, Fondacioni i Uestministerit për Demokraci, Jangon, qershor 2019.

¹³ Po aty.

¹⁴ Fitsilis, F. & De Vrieze, F. (2019). Si Parlamentet Monitorojnë Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm – Bazë për Zbatimin e Kontrollit Post-Legjislativ, punim i prezantuar në Seminarin Akademik për Kontrollin Post-Legjislativ në Azi, Fondacioni i Uestministerit për Demokraci, Jangon, qershor 2019.

kërkon. 3. Drejtuesit e institucioneve shtetërore, me kërkesë të komisioneve parlamentare, japin shpjegime dhe informojnë për çështje të ndryshme të veprimtarisë së tyre për sa e lejon ligji.¹⁵

Rregullorja e Brendshme e Kuvendit përmban një grup dispozitash në pjesën e tretë të "Kontrollit Parlamentar", që përcakton mekanizmat për ushtrimin e kontrollit parlamentar në nenin 102 i cili parashikon se: "1. Komisionet e përhershme të Kuvendit mund t'i paraqesin Kuvendit raporte ose propozime për çështje që janë nën kompetencën e tyre ose kur një gjë e tillë u është kërkuar nga Kuvendi. 2. Komisionet kanë të drejtë të thërrasin ministrat në çdo kohë për të dhënë shpjegime dhe sqarime për çështje të fushave të përgjegjësisë së tyre, ose për zbatimin e ligjeve, të vendimeve, rezolutave dhe deklaratave të miratuara nga Kuvendi. Drejtuesit e institucioneve shtetërore, me kërkesë të komisioneve, japin shpjegime dhe informojnë për çështje që lidhen me veprimtarinë e tyre, si dhe për çështje që lidhen me zbatimin e rekomandimeve të institucioneve të pavarura të adresuara kundrejt tyre. 3. Komisionet e përhershme, brenda fushave përkatëse të përgjegjësisë, mund të kryejnë kontrolle ose të kërkojnë dokumentacione që i konsiderojnë të nevojshme për kontrollin e një çështjeje të caktuar. Në këtë rast Kryetari i Kuvendit njoftohet me shkrim nga kryetari i komisionit. Në përfundim të kontrollit, komisionet hartojnë një raport, i cili i përcillet Kryetarit të Kuvendit dhe bëhet i njohur publikisht, duke përfshirë edhe mendimin e pakicës."¹⁶

Pas rishikimit të fundit të Rregullores së Brendshme, në të u futën dispozita për vlerësimin *ex post*, sidomos për legjislacionin e përafuar me *acquis* të BE-së. Neni i ri i miratuar¹⁷ parashikon që për legjislacionin e përafuar duhet të ketë një rishikim të pjesëve të legjislacionit jo më vonë se 3 vjet pas zbatimit; përcakton një plan vjetor për kryerjen e vlerësimit *ex post*; krijon një mekanizëm institucional sipas të cilit plani u përcillet ministrive të linjës; ngarkon ministritë e linjës me përgatitjen e raporteve të vlerësimit paraprak për kuadrin ligjor që do të rishikohet. Paskëtaj, një komision i posaçëm kryen vlerësimin *ex post* të legjislacionit, duke mbajtur konsultime publike dhe dëgjesa me grupet e interesit për të mbledhur materiale shtesë. Në fund, raportet e përgatitura prezantohen dhe diskutohen midis Komitetit të Integritimit Evropian dhe komisioneve të përhershme, edhe më pas raporti miratohet dhe publikohet në faqen e internetit të Kuvendit.

Ligji nr. 8550, datë 18.11.1999 "Statusi i Deputetit", neni 4, pika 2 parashikon se *deputeti ka të drejtë të ushtrojë vetë dhe në kuadrin e veprimtarisë së komisionit kontrollin e zbatimit të ligjeve, vendimeve e akteve të tjera të nxjerra nga Kuvendi, nga Këshilli i Ministrave, nga ministritë, nga organet e qeverisjes vendore dhe institucionet e tjera qendrore*. Por, meqë deputeti mund të jetë në parim pjesëtar i vetëm një komisioni të përhershëm, anëtarësia e komisioneve është relativisht e gjerë dhe fushat e përgjegjësisë janë të përcaktuara gjerësisht. Personeli, një këshilltar ligjor dhe një këshilltar teknik për çdo komision, nuk ofrojnë kapacitetet e duhura për të ndjekur situatën në të gjitha fushat e përcaktuara dhe të ofrojnë mbështetjen e nevojshme ligjore, mbikëqyrëse dhe politikbërëse.¹⁸

Sipas Kuvendit të Shqipërisë, komisionet parlamentare kanë kryer vlerësime të pjesshme *ex post* për mbikëqyrjen parlamentare të zbatimit të ligjeve, nxjerrjen e akteve nënligjore dhe organeve përgjegjëse sipas ligjit. Gjithashtu, përmes vizitave monitoruese dhe dëgjësive publike të mbajtura vitet e fundit, komisionet parlamentare kanë kryer vlerësime të pjesshme *ex post* të ligjeve, duke monitoruar zbatimin e tyre dhe nëse janë hasur pengesa në zbatim. Megjithëse kërkuam nuk u mor informacion për ndonjë vlerësim *ex post* të kryer nga institucionet shtetërore.

Sipas Kuvendit të Shqipërisë, nismat për hartimin e ligjeve të reja apo për ndryshimin e atyre ekzistuese, qofshin nisma të Këshillit të Ministrave, të deputetëve apo të qytetarëve, vijnë si rezultat i vlerësimit

¹⁵ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, fq. 15. Marrë nga <https://www.osce.org/files/f/documents/3/2/41888.pdf>

¹⁶ Rregullorja e Brendshme e miratuar nga Kuvendi me Vendimin nr. 12/2020 "Për disa shtesë në Vendimin e Kuvendit nr. 166, datë 16.12.2004 "Për miratimin e Rregullores së Brendshme të Kuvendit të Shqipërisë", i ndryshuar.

¹⁷ Rregullorja e Brendshme miratuar nga Kuvendi me Vendimin nr. 12/2020 "Për disa shtesë në Vendimin e Kuvendit nr. 166, datë 16.12.2004 "Për miratimin e Rregullores së Brendshme të Kuvendit të Shqipërisë", i ndryshuar.

¹⁸ Instituti Demokratik Kombëtar (2017). Shërbimet legjislative në parlamente. Funksionimi i departamenteve legjislative dhe shembuj të opionioneve legjislative.

ciklik të politikave, legjislationit dhe kontrollit post-legjislativ të ligjeve në fuqi. Projektligjet, krahas relacioneve shpjeguese, shoqërohen me një raport për vlerësimin e ndikimit (RVN). Megjithatë, jo të gjitha nismat ligjore shoqërohen nga ky raport.

Vitet e fundit vihet re një interesim dhe ndërgjegjësim në rritje i parlamentit për nevojën e kontrollit post-legjislativ, si nga deputetët ashtu edhe nga personeli. Ka pasur raste kur grupe interesi kanë paraqitur kërkesa apo ankesa pranë komisioneve parlamentare për mospërbushjen e detyrimeve ligjore nga ana e organeve përgjegjëse për nxjerrjen e akteve nënligjore. Komisionet parlamentare kanë organizuar dëgjesa në prani të grupeve të interesit dhe përfaqësuesve të organeve ligjzbatuese. Në fund, komisionet parlamentare kanë realizuar një vlerësim dhe kanë dhënë rekomandime lidhur me zbatimin e ligjeve nga ana e organeve përgjegjëse.

Pavarësisht dispozitave ligjore për kryerjen e KPL-së, kapacitetet organizative të brendshme gjenden në komisionet parlamentare që mbështeten nga shërbimi ligjor i ekspertëve të parlamentit dhe ekspertëve të jashtëm. Pra, nuk ka një strukturë të qartë me burimet e duhura që të mbështetë përpjekjet që KPL-ja të kryhet periodikisht dhe gjerësisht. Në vlerësimin e projektligjeve, komisionet presin vlerësime nga institucionet, organizatat, universitetet apo konsulentët. Në kuadrin e kontrollit post-legjislativ, komisionet kërkojnë informacion që të bëjnë vlerësimin, por deri tani nuk ka pasur asnjë rast vlerësimi të plotë legjislativ të ndonjë ligji nga ana e komisioneve.

Një tjetër mangësi lidhet me mungesën e një plani apo kalendari vjetor legjislativ parlamentar, që do të ofronte më shumë planifikim dhe do të përfshinte nismat legjislative që vijnë nga deputetët si edhe dëgjesat dhe aktivitetet e tjera që lidhen me ligjvënien.¹⁹ Raporti i vlerësimit për funksionimin e pushtetit ligjvënës në Shqipëri identifikoi edhe faktin që funksionet legjislative dhe mbikëqyrëse pengohen nga afatet e ngushta ndërmjet komisioneve dhe procedurave të seancave plenare, ku ndonjëherë parashikohen vetëm dy ditë nga hartimi i ligjit deri te diskutimi i tij në seancë plenare.²⁰

Gjatë vitit 2016, komisionet e përhershme parlamentare dhe nënkomisionet organizuan 232 dëgjesa publike në total, 133 nga të cilat ishin për procesin legjislativ, 18 për procesin zgjedhor dhe 60 për mbikëqyrjen parlamentare. Në vitin 2017, komisionet parlamentare dhe nënkomisionet organizuan 24 dëgjesa me OSHC-të dhe grupet e interesit, 14 takime konsultative për projektligjet dhe tri dëgjesa në terren. Edhe pse numri i dëgjesave publike është relativisht i lartë, nuk mbahen evidenca të përshtatshme se sa informacion i përfutur nga dëgjesat publike është përdorur në procesin e hartimit të legjislationit dhe/ose mbikëqyrjes.²¹

Siç u përmend më lart, ekzistojnë praktika për kryerjen e vlerësimeve *ex ante* apo *ex post* për akte ligjore specifike që miratohen prej Kuvendit. Një shembull vjen nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, në rastin e miratimit të Ligjit për Trashëgiminë Kulturore, ku u zhvillua një proces monitorimi për zbatimin e tij. Komisioni parlamentar përgjegjës për çështjet kulturore, në kuadrin e rolit të vet kontrollues, realizoi monitorimin e zbatimit të ligjit, nxjerrjes së akteve nënligjore dhe aspekteve të tjera të zbatimit të tij në nivel vendor.²² Siç shihet, ekzistojnë mekanizma, por nevojiten më shumë përpjekje për të institucionalizuar dhe për të bërë funksional ShPL-në brenda strukturës së Kuvendit të Shqipërisë.

Konteksti politik i rëndësishëm për zbatueshmërinë e LBGj

Konteksti politik i Shqipërisë është bërë gjithnjë e më favorizues për përfaqësimin dhe pjesëmarrjen e e barabartë të grave e burrave në proceset e rëndësishme vendimmarrëse. Ky progres është më i

¹⁹ NDI. Raporti Përfundimtar i Vlerësimit.

²⁰ Po aty.

²¹ NDI. Raporti Përfundimtar i Vlerësimit.

²² Intervistë me Prezencën e OSBE-së në Shqipëri.

dukshëm në numra. Ndërkohë që nga fundi i regjimit komunist kishte një numër domethënës të grave në parlament (mbi 30% nga fundi i viteve 1980), vitet e para të tranzicionit demokratik shënuan një rënie të fortë të përfaqësimit të grave në politikë dhe në vendimmarrje, duke arritur pikën më të ulët në parlamentin e vitit 1997 ku përfaqësimi i tyre ishte 7%. Ligji për Barazinë Gjinore në Shoqëri solli rritje të të qëndrueshme të numrit të grave deputete, duke arritur në 29% në legjislaturën e vitit 2017.²³

Si rezultat i kuotës gjinore të sanksionuar në LBGj, dhe i përforcuar në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, në zgjedhjet e fundit vendore të mbajtura në muajin qershor 2019, gratë përbënin 43.6% të këshillave bashkiakë, por një numër të ulët ndjeshëm në nivelin e kryetarëve të bashkive (vetëm 13%).²⁴ Në vitin 2019, Qeveria Shqiptare renditej si një prej vendeve me kabinetin qeveritar më të barabartë në botë, pasi gratë përbënin mbi 50% të ministrave.²⁵ Në Kuvendin e Shqipërisë është krijuar Aleanca e Grave Deputete që në periudha të caktuara vepron njëzëri, pavarësisht përkatësive të kundërta partiake.²⁶ Aleancë e tillë u krijua edhe në nivel vendor mes këshilltareve në disa bashki. Takimi i parë i përbashkët mes këtyre dy aleancave u zhvillua në vitin 2018, ku u diskutua për sfidat në përfaqësimin dhe pjesëmarrjen e grave në politikë dhe politika, si edhe si të çohet më tej axhenda e tyre.²⁷

Neni 15 i ligjit sanksionon përfaqësimin e grave me jo më pak se 30% në listën e kandidatëve për zgjedhjet vendore, në një sistem proporcional në listën e kandidatëve të paraqitur prej partive politike, si edhe përfaqësim mbi 30% të secilës gjini në administratën zgjedhore qendrore dhe vendore. Këto dispozita shërbejnë si bazë për ndryshimet pasuese në Kodin Zgjedhor, duke filluar nga viti 2008, të cilat futën jo vetëm kuotën 30% për gjininë më pak të përfaqësuar në listën e partive për zgjedhjet kombëtare, por më pas edhe kuotën 50% me një sistem zinxhir (*zipper*)²⁸ për kandidatët për këshillat bashkiakë. Në fillim, Kodi parashikonte se në zgjedhjet kombëtare: "Për çdo zonë zgjedhore, të paktën 30% e listës shumë-emërore dhe/ose një në tre emrat e parë të listës shumë-emërore duhet t'i përkasë secilës gjini". Duke shkruar "dhe/ose", Kodi Zgjedhor solli një kuadër ligjor të paqartë për përfaqësimin e grave në politikë. Në vend që të vendosnin më shumë gra në lista, partitë e panë më të udhës që të paguanin gjobën 39,000 lekë (rreth 300 USD) që shkaktonte mosrespektimi i kuotës. Ky është një efekt i dëmshëm i krijuar nga ligji për kuotat.²⁹

Pavarësisht numrave dhe përqindjeve premtuese, ekziston një dallim real midis përfaqësimit dhe pjesëmarrjes kuptimplotë *de jure* dhe *de facto* në vendimmarrje. Ende ka probleme dhe sfida në garantimin e zërit të fortë dhe të qartë të grave në proceset e formulimit të politikave gjinore. Për më tepër, pakicat mbeten të nënpërfaqësuar në Kuvend dhe në organet e tjera qeverisëse. Pavarësisht ekzistencës së Aleancës së Grave Deputete, rrezja e veprimit të tyre është e kufizuar, shpesh ngaqë përkatësitë partiake ndërhyjnë me interesat e përbashkëta në përfaqësimin e grave. Për shkak të dobësive të tyre, këto aleanca dhe gratë e angazhuara në proceset politike shpesh kanë pak zë dhe influencë në shpërndarjen e mjeteve dhe përcaktimin e agjendës politike.

Për këtë arsye, përtej përfaqësimit sasior, është e rëndësishme të analizohet pushteti vendimmarrës aktual dhe përfshirja thelbësore e të dyja gjinive në çdo proces vendimmarrës. Së fundmi, një monitorim i realizuar nga një organizatë e shoqërisë civile shqiptare, tregoi se gratë janë 14% më efektive sesa burrat në pjesëmarrjen në çështjet legjislative, si dhe më aktive në nismat ligjore, në propozimin e

²³ INSTAT. (2019). Gratë dhe Burrat në Shqipëri. Marrë nga, http://ëëë.instat.gov.al/media/6413/burra-dhe-gra_2019.pdf

²⁴ Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (2019). Rezultatet e zgjedhjeve vendore. Marrë nga, <http://cec.org.al/ëp-content/uploads/2020/02/2019-Tabela-Permbledhese-Final-1.pdf>

²⁵ Iknöpolitics ku renditet Shqipëria nga kabinetet me barazi më të lartë gjinore 5th. Nga, <https://www.iknowpolitics.org/en/learn/knoëledge-resources/here-are-most-gender-balanced-cabinets-world-today>

²⁶ Për më shumë informacion mbi ALeancën e Grave Deputete, shih: <https://ëëë.parlament.al/Kuvendi/AleancaGraDeputete>

²⁷ Agjencia Telegrafike Shqiptare. Grate deputete dhe keshilltare bashke per barazine gjinore. 16 dhjetor 2018:

<https://ata.gov.al/2018/12/16/grate-deputete-dhe-keshilltare-bashke-per-barazine-gjinore/>

²⁸ Sistemi zinxhir (i njohur gjithashtu si "barazi vertikale") është një metodë për hartimin e listave të partive në sistemet zgjedhore me përfaqësim proporcional. Kërkon që kandidatët në listë të alternojnë burra dhe gra në mënyrë që të sigurojnë përfaqësim të barabartë në kandidaturë dhe anëtarëve të zgjedhur potencialisht.

²⁹ https://www.transparency.ge/sites/default/files/post_attachments/the_role_of_women_in_political_sphere_france_albania_and_estonia_by_cyrille_montecot.pdf

legjislacionit, debatet në seancë plenare dhe diskutimet në komisione parlamentare. Përveç kësaj, deputetet ishin më aktive në mbajtjen e fjalimeve. Konkretisht, gratë mbajtën 168 fjalime, ose mesatarisht 19% më shumë sesa kolegët e tyre meshkuj.³⁰

Gjetje të ngjashme janë evidentuar edhe në nivel vendor. Monitorimi i fundit i këshillave bashkiakë tregoi se rritja e pjesëmarrjes së grave nuk është reflektuar detyrimisht në zë më të fortë të tyre.³¹ Përkundrazi, këshilltarët përballen me pengesa strukturore lidhur me influencimin e tyre në procesin e politikave. Vetë gratë raportojnë se kolegët burra janë më të fuqishëm brenda partive politike dhe këshillave bashkiakë, për sa i përket fuqisë së zërit, përfaqësimit dhe vendimmarrjes.³² Gjithashtu, një studim bazuar në intervistat e grave doli në përfundimin se pjesëmarrja e këshilltareve në politikën vendore mund të jetë më pak shprehje e angazhimit të tyre ndaj të drejtave, fuqizimit dhe barazisë gjinore të grave, dhe më shumë një detyrim për t'u shërbyer interesave të kryetarëve të partisë.³³ Sipas një studimi të fundit, 89% e grave deputete besojnë se arritën të fitojnë një vend në parlament për shkak të dy faktorëve kryesorë: mbështetja e kryetarit të partisë dhe mbështetja nga baza e partisë. Asnjë grua nuk e pati nismë të vetën kandidimin për deputete.³⁴ Për më tepër, gratë e shohin futjen në Kuvend si rezultat i dy faktorëve: sistemi i kuotës gjinore dhe mbështetja e kryetarit të partisë – një tregues ky i natyrës së sistemit aktual zgjedhor dhe partiak ku rol vendimtar luan më shumë partia sesa individit.³⁵

Një zhvillim pozitiv për rritjen e pushteti politik dhe vendimmarrës së grave është ngritja e Platformës Kombëtare për Gratë (PKG), i cili është një rrjet me 1500 politikane aktive në politikën vendore dhe kombëtare. Këto të fundit kanë pasur sukses në rritjen e ndërgjegjësimit për çështjet gjinore dhe me influencën e tyre për formimin e grupimeve/forumeve të grave nëpër parti, që funksionojnë në nivel vendor, me qëllim lobimin për rritjen e fuqisë së grave brenda strukturave partiake.³⁶

Studimet e mëparshme në procedurat e partive politike për fuqizimin e grave brenda strukturave politike tregojnë se, edhe pse ekzistojnë disa rregulla, nuk ndiqen politika tërësore për të rritur peshën e tyre brenda strukturave partiake. Disa parti e kanë të parashikuar në status kuotën 30% në pozicionet drejtuese dhe në kryesinë e partisë. Një prej partive politike (Partia Demokratike) ka një forum grash të ngarkuar me përfaqësimin e interesave të tyre si edhe anëtarësi me rreth 20,000 gra. Edhe parti të tjera kryesore e kanë të përcaktuar kuotën 30% bashkë me kuotën 50% për kongreset e partive dhe në nivelet dhe organizimet më të ulëta, si në rastin e Partisë Socialiste. Por, ka pak të dhëna për të vlerësuar nëse këto angazhime të sanksionuara në statutin e partisë zbatohen në praktikë.³⁷

Të gjitha këto zhvillime dhe hapat e progresit drejt arritjes së barazisë gjinore në vendimmarrje tkurren nga krizat e vazhdueshme politike në Shqipëri që janë përkeqësuar (në shkallë të ndryshme) vitet e fundit. Viti 2019 ishte veçanërisht trazues, pasi partitë opozitare e braktisën parlamentin dhe refuzuan pjesëmarrjen në zgjedhjet vendore të qershorit. Fokusi kryesor janë reformat si, reforma zgjedhore dhe reforma në drejtësi, çka ka bërë që t'i kushtohet pak vëmendje çështjeve të tjera, siç është krijimi i mjedisit që mundëson që gratë të jenë të pranishme dhe të kontribuojnë në proceset politike.

Përgjatë vitit 2019, polarizimi i fortë dhe bojkoti i përsëritur i veprimtarisë parlamentare nga opozita, ka ndikuar negativisht në punën e Kuvendit. Që nga muaji shtator 2018, opozita ka marrë pjesë në shumë pak veprimtari parlamentare, kryesisht në ato në nivel komisioni, ndërsa konsensusi ndërpartiak u arrit

³⁰ Instituti për Studime Politike (2018). Raporti i parë Monitorues për Parlamentin 2017.

³¹ Dauti M. dhe Cepani E. (2015). Forcimi i Pushtetit Vendimmarrës së Grave Këshilltare në Shqipëri, UNDP, Marrë nga, <https://www.al.undp.org/content/albania/en/home/library/poverty/study-strengthening-the-decision-making-power-of-councilwomen-in.html>

³² Dauti, M dhe Metaj, G. (2017). Raport Kërkimor. Kuotat Gjinore dhe përfaqësimi thelbësor i grave në Këshillat Vendore në Shqipëri. Marrë nga <file:///C:/Users/User/Downloads/ENGLISH.pdf>

³³ UN Women dhe UNDP. Raport Gjinor 2016. Marrë nga <https://eca.unwomen.org/en/digital-library/publications/2016/10/albania-gender-brief>

³⁴ Institute for Political studies. (2020). Anketim me gra deputete. Marrë nga <http://isp.com.al/ep-content/uploads/2020/03/ISP-survey-ëith-Women-MPs-Main-findings-and-recommendations.pdf>

³⁵ Po aty.

³⁶ OSBE. 2013. Studim krahasuar i strukturave të grave deputete në rajonin e SOBE-së. Marrë nga <https://ëëë.osce.org/odihr/105940>

³⁷ Për analizë më të hollësishme, shih: <https://ëëë.ëfd.org/ep-content/uploads/2019/07/Women%E2%80%99s-Participation-in-Politics-in-the-Eastern-Balkans.pdf>

vetëm për një numër të kufizuar ligjesh.³⁸ Në mesin e kësaj atmosfere politike të tendosur, integrimi evropian qëndron si shtysë kryesore për masat e qeverisë së Shqipërisë. Mungesa e dialogut ndërpartiak dhe bojkoti i vazhdueshëm i partive politike kanë penguar përpjekjet për ta çuar përpara axhendën e integritit dhe reformat e nevojshme. Siç e thekson edhe Raporti 2019 i BE-së për Shqipërinë, "Vullneti politik për të avancuar agjendën e BE-së duhet të kombinohet me kapacitetet e përshtatshme administrative për harmonizimin me *acquis* të BE-së".³⁹

Situata politike në nivel kombëtar reflektohet gjerësisht edhe në politikën vendore dhe në kontekstin e qeverisjes vendore, gjë që shton sfidat për gratë që të funksionojnë si aktore politike. Shqipëria kaloi një reformë thelbësore administrative dhe territoriale në vitin 2015, me të cilën synohej të rikonfigurohej territori i vendit dhe të ripërcaktohen marrëdhëniet dhe kompetencat e qeverisjes vendore përkundër qeverisjes qendrore. Analiza e ndikimit të reformës territoriale tregon se ende ekzistojnë sfida thelbësore në arritjen e pavarësisë dhe funksionalitetit të synuar të njëjësive të qeverisjes vendore.⁴⁰

Konteksti Institucional i rëndësishëm për LBGj

Shqipëria ka ndërtuar një mekanizëm gjithëpërfshirës për gjininë që shtrihet nga niveli lokal në atë kombëtar dhe nga pushteti legjislativ tek ai ekzekutiv e më gjerë. Analiza e mëposhtme fokusohet tek institucionet kryesore përgjegjëse dhe agjentët përgjegjës për garantimin e barazisë gjinore dhe për fuqizimin e grave në vend.

Organi që bashkon pothuajse të gjitha nivelet institucionale është *Këshilli Kombëtar i Barazisë Gjinore* (KKBGj), i cili funksionon si organ këshillues i nivelit të lartë përgjegjës për drejtimin strategjik të axhendës së barazisë gjinore. KKBGj-ja u themelua në vitin 2009 dhe drejtohet nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si dhe përbëhet nga 9 zëvendësministra dhe tre përfaqësues të OSHC-ve. Me përjashtim të disa takimeve që ka mbajtur dhe të disa raporteve/rekomandimeve që ka hartuar, KKBGj-ja nuk është plotësisht funksional, nuk mblidhet rregullisht dhe nuk ka fuqi të konsiderueshme për ta drejtuar agjendën e barazisë gjinore në një drejtim strategjik. Me qëllim përmbushjen e plotë të potencialit të tij, anëtarësimi, funksionaliteti dhe përgjegjësitë e KKBGj-së duhet të rishikohen.⁴¹

Organet legjislative

Kuvendi i Shqipërisë ka disa komisione dhe nënkomisione që adresojnë çështjet e lidhura me barazinë gjinore. Ato janë:

- Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, i cili adreson çështjet e lidhura me barazinë gjinore dhe luftën kundër dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje;
- Nënkomisioni "Për barazinë gjinore dhe parandalimin e dhunës ndaj gruas" me vendimin nr. 113/2017, Kuvendi ngriti nënkomisionin "Për barazinë gjinore dhe parandalimin e dhunës ndaj gruas" brenda Komisionin për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë. Objekti dhe fusha e përgjegjësisë së këtij nënkomisioni janë a) ndërmarrja e hapave të nevojshëm për adresimin e dhunës ndaj grave dhe vajzave; b) gjetja e mekanizmave efikasë për parandalimin dhe reduktimin e dhunës në familje; c) propozimi i ndërhyrjeve ligjore të nevojshme që ndihmojnë në përmirësimin e mbrojtjes së grave dhe vajzave dhe rritjes së sigurisë së jetës së tyre; d) mbikëqyrja parlamentare e institucioneve përgjegjëse për trajtimin e rasteve të dhunës në

³⁸ Bashkimi Evropian. Raporti për Shqipërinë 2019. Marrë nga <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20190529-albania-report.pdf>

³⁹ Po aty.

⁴⁰ Po aty.

⁴¹ UN Women Albania. Dosja gjinore 2016. Marrë nga https://www.unWomen.org/-/media/field%20office%20eca/attachments/publications/country/albania/un%20gender%20brief%20albania%202016_en_ëeb.pdf?la=en&vs=5235

familje, përmbushja prej tyre e të gjitha detyrimeve ligjore, zbatimi i masave për parandalimin e dhunës ndaj grave dhe vajzave dhe fuqizimi social dhe ekonomik i tyre.

- Nënkomisioni për të drejtat e njeriut. Me vendimin nr. 13/2018 Kuvendi ka themeluar nënkomisionin “Për të drejtat e njeriut” brenda Komisionit Parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut. Fusha e përgjegjesisë së këtij nënkomisioni janë çështjet e lidhura me të drejtat e njeriut, duke përfshirë barazinë gjinore.
- Kuvendi me vendimin nr. 11/2020 ka ngritur nënkomisionin “Për zhvillim të qëndrueshëm” në përbërje të komisionit për Ekonominë dhe Financat. Objekti dhe fusha e përgjegjesisë së këtij nënkomisioni është zhvillimi ekonomik dhe social, rritja ekonomike e qëndrueshme, realizimi i objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm dhe Agjenda 2030 e OKB-së.
- Kuvendi me vendimin nr. 99/2017 ka ngritur nënkomisionin “Për Qeverisjen Vendore” në përbërje të komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut. Objekti dhe fusha e përgjegjesisë së këtij nënkomisioni është organizimi dhe funksionimi i pushtetit vendor.
- Këshill kombëtar të integritit evropian dhe në kuadër të integritit adreson të drejtat e njeriut, kapitulli 23
- Grupi i deputetëve “Miq të fëmijëve” trajton çështje të djemve dhe vajzave

Aleanca e Grave Deputete (AGD) luan rol lobues brenda parlamentit. Ky organ ka promovuar barazinë gjinore dhe mbron përfshirjen e perspektivës gjinore në ligjeve. Gjatë 6 viteve të fundit, AGD ka kryer disa aktivitete dhe ka advokuar për rritjen e kuotave gjinore në parlament.

Organet ekzekutive

Në nivel ekzekutiv, Kryeministria zë rolin koordinues për barazinë gjinore ku **Zëvendëskryeministri** shërben si figura kyçe. Megjithatë, nuk ka role dhe përgjegjësi të qarta dhe kjo e vështirëson vënien para përgjegjesisë së Kryeministrit, ndaj lihet në dorë të vullnetit dhe angazhimit të personit përgjegjës për ushtrimin e funksioneve.

Që prej shtatorit të vitit 2017, **Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS)** ka qenë ministria drejtuese përgjegjëse për çështjet e lidhura me barazinë gjinore, dhunën me bazë gjinore dhe dhunën në familje dhe përbën një pjesë thelbësore të makinerisë kombëtare për barazinë gjinore. Ministria e ushtron mandatin e saj përmes Sektorit të Barazisë Gjinore. Sektori është pjesë e Drejtorisë së Përfshirjes Sociale dhe Barazisë Gjinore, nën Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave Sociale në MSHMS. Misioni i këtij sektori është:

- formulimi dhe hartimi i politikave për nxitjen e barazisë gjinore dhe reduktimin e dhunës me bazë gjinore (DHBGJ) dhe dhunës në familje (DHF).
- synimi për një harmonizim më të mirë të programeve të përfshirjes sociale (sidomos ato programe që fokusohen në grupe të ndryshme të marginalizuara grash); dhe
- mbështetja dhe angazhimi në përfshirjen e perspektivës gjinore.

Çka është më e rëndësishmja për qëllime të ShPL-së, Ministria është përgjegjëse edhe për monitorimin e zbatimit të politikës së qeverisë për barazinë gjinore. Për përmbushjen e funksionit të tij monitorues, mekanizmi kombëtar ka përgatitur raporte periodike për zbatimin e strategjive ekzistuese dhe të planeve të veprimit. Megjithatë, kapacitetet e strukturës për mbledhjen e të dhënave dhe për monitorimin e vlerësimit kanë nevojë të fuqizohen.⁴² Ndonëse vlerësimi i Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore (SKBGJ) dhe i Planit të saj të Veprimit (2016-2020), është kryer rregullisht, kjo gjë nuk mund të thuhet se është bërë për vetë LBGJ-në.

⁴² UN Women Dosja gjinore 2016. Online: https://www.unwomen.org/-/media/fieldoffice%20eca/attachments/publications/country/albania/un%20gender%20brief%20albania%202016_en_ëeb.pdf?la=en&vs=5235

Në nivel më të ulët ekzekutiv, në të gjitha ministritë kanë emëruar nëpunës të barazisë gjinore (NBGJ) që duhet të shërbejnë për përfshirjen e perspektivës gjinore në politikat e të ministrive të tyre përkatëse si dhe në bazë të nenit 4 të LBGJ-së ata kanë pozicione me kohë të plotë në administratën publike. Megjithatë, pavarësisht këtij titulli, në disa raste, nëpunësit e barazisë gjinore nuk kanë arsimin dhe/ose trajnimin e duhur për të trajtuar çështjet gjinore. Këta nëpunës/e ushtrojnë detyra dhe përgjegjësi të tjera në institucion, përveç atyre që lidhen me çështjet gjinore.⁴³ Roli i tyre është thelbësor në monitorimin dhe raportimin kundrejt angazhimeve të barazisë gjinore dhe mund të shërbejnë si një nga zbatuesit kryesorë të ligjit për barazinë gjinore me qëllim që ta bëjnë atë sa më funksional që të jetë e mundur brenda kufijve të tij. Megjithatë, UN Women ka theksuar më parë se mungesa e NBGJ-ve zyrtarë, të cilët kanë formimin e duhur dhe që punojnë me kohë të plotë, paraqet një sfidë për përfshirjen koherente të perspektivës gjinore në të gjithë sektorët.

Qeverisja vendore

Në nivelin vendor, 61 NBGj janë emëruar në 61 bashki. Megjithatë, këta nëpunës në shumicën e rasteve luajnë rolin e koordinatorëve vendorë për menaxhimin e rasteve të dhunës në familje dhe në shumë raste ushtrojnë detyra dhe përgjegjësi të tjera.

Ekzistojnë disa përkufizime që përdoren si pozicion pune për ata persona që merren me çështjet gjinore në nivelin vendor dhe atë ministror. Në nivelin ministror, personat përgjegjës kanë titullin zyrtar "Nëpunës i Barazisë Gjinore". Në nivel vendor, personat përgjegjës kanë titullin zyrtar të Nëpunësit të Barazisë Gjinore dhe disa të tjerë janë Koordinatorë Vendorë kundër Dhunës në Familje. Disa prej Koordinatorëve të Njësisë për Mbrojtjen e Fëmijëve veprojnë si Nëpunës të Barazisë Gjinore ose si Koordinatorë Vendorë kundër Dhunës në Familje.

Edhe në nivel bashkiak apo ministror, NBGj-të mbështeten pak në kryerjen e punës së tyre siç duhet. Vullneti i përgjithshëm politik mbetet vetëm në dorë të MShMS dhe Kryeministrit për miratimin e amendamenteve të rëndësishme. Megjithatë, vullneti politik në nivel ministror dhe bashkiak sa i përket mbështetjes dhe marrjes së masave për funksionin e duhur të këtyre nëpunësve dhe të mekanizmit të reagimit të komunitetit, mbetet në nivel të ulët.

Institucionet Kombëtare për të Drejtat e Njeriut

Edhe institucionet kombëtare për të Drejtat e Njeriut, si Avokati i Popullit dhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD) luajnë rol të ngjashëm në mbrojtjen e individëve nga diskriminimi për shkak të gjinisë. Ata janë të dy autoritete të pavarura publike që mbrojnë individët nga diskriminimi dhe nga shkelja e të drejtave të njeriut qoftë nga institucionet private dhe nga ato publike.

Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i ndryshuar (LMD) e identifikon gjininë si një nga bazat e diskriminimit, gjë që nënkupton përfshirjen e barazisë gjinore në fushëveprimin e tij. Gjithashtu, ndryshimet kushtetuese të bëra në vitin 2016 sanksionuan të drejtën e Komisionerit për t'i referuar çështjet në gjykatën kushtetuese (neni 134). Megjithatë duhet theksuar se, vetë KMD-ja pranon se aktet nënligjore që rregullojnë rolin e tij dhe zbatimin e ligjore ende nuk janë hartuar, ndërsa nga ana tjetër bëhen diskutime të vazhdueshme dhe sugjerime nga aktorë të ndryshëm për ndryshimin dhe zgjerimin e ligjit për mbrojtjen nga diskriminim. Për më tepër, të dhënat e zyrës së KMD-së tregojnë se ankesat me bazë gjinore janë relativisht të ulëta dhe, mes ankesave me temë gjininë, gratë janë paditëset dominuese.⁴⁴

⁴³ GFA. 2019. Raporti i vlerësimit të nevojave për trajnim për nëpunësit e barazisë gjinore në nivel vendor dhe ministror.

⁴⁴ UN Women Dosja gjinore 2016.

Konteksti i të drejtave të njeriut dhe i barazisë gjinore i rëndësishëm për LBGj

Që prej rënies së komunizmit, Shqipëria ka bërë progres të konsiderueshëm drejt avancimit të të drejtave të njeriut dhe fuqizimit të gruas. Tashmë kuadri ligjor, institucional dhe i politikave është miratuar për të garantuar të drejtat dhe liritë individuale, si dhe mbrojtjen e tyre. Vendi është angazhuar në mënyrë të konsiderueshme ndaj një sërë standardesh dhe institucionesh ndërkombëtare për të garantuar barazinë gjinore dhe respektimin e të drejtave të njeriut, të cilët mbikëqyrin legjislacionin e brendshëm.

Sa u përket angazhimeve ndërkombëtare, Shqipëria ka ratifikuar Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Ndaj Grave (CEDAW) në vitin 1993 dhe Konventën e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit) e ratifikuar nga Shqipëria në vitin 2012. Shqipëria është palë edhe e Platformës së Pekinit për Veprim (1995) dhe ka miratuar Rezolutën 1325 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara për gratë, paqen dhe sigurinë. Ajo përgatit rregullisht raporte për angazhimet e saj dhe për zbatimin e rekomandimeve nga instrumentet ndërkombëtare.

Në vitin 2020, Shqipëria publikoi për herë të parë Indeksin e Barazisë Gjinore, ku rezultati i përgjithshëm ishte 60.4 pikë (i cili është më i ulët se mesatarja e BE-së). Sipas përfundimeve të tij, ka akoma rrugë për të bërë përpara për arritjen e plotë të barazisë gjinore, e cila kërkon angazhim të të gjithë aktorëve, duke përfshirë qeveritë, sektorin privat, shoqërinë civile dhe qytetarët.⁴⁵

Dhuna ndaj grave dhe vajzave mbizotëron në zhvillimet dhe shqetësimet në fushën e barazisë gjinore dhe fuqizimit të gruas. Dhuna në familje, si një nga format më të zakonshme të dhunës ndaj grave, mbetet e përhapur dhe e pranuar në Shqipëri. Të dhënat e vitit 2019, tregojnë se janë lëshuar mbi 3200 urdhra mbrojtje për gratë e abuzuara nga partnerët dhe të afërmit. Dymbëdhjetë gra dhe vajza të reja kanë vdekur si pasojë e dhunës në familje në vitin 2019.⁴⁶ Këshilli i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, në ekzaminimin e tij për dokumentacionin e të drejtave të njeriut në Shqipëri, në bazë të procesit të Rishikimit Universal Periodik, vuri në dukje problemet rreth normës së ulët të raportimit të rasteve të dhunës me bazë gjinore ndaj grave, numrin e pamjaftueshëm të strehëzave dhe moszbatimin e vazhdueshëm të urdhrave të mbrojtjes.⁴⁷ Sondazhi më i fundit i INSTAT për popullsinë tregoi se 1 në 2 gra raportojnë se kanë përjetuar dhunë.⁴⁸

Përveç dhunës në familje, edhe përjetimet e dhunës në mjedisin e punës janë çështje mjaft shqetësuese. Diskriminimi i përhapur për shkak të gjinisë në punë, duke përfshirë ngacmimet seksuale, mbeten tej mase i paraportuar. Në një sondazh të kryer nga Qendra "Aleanca Gjinore për Zhvillim" (GADC), shumica e grave të anketuara raportuan se kanë qenë objekt i ngacmimit seksual dhe disa prej tyre raportuan se u është refuzuar leja e lindjes.⁴⁹ Për më tepër, hendeku i barazisë gjinore rritet gjithnjë e më shumë. Vetëm 19% e grave zotërojnë prona për shkak të zbatimit të dobët të ligjit për regjistrimin e pronës dhe si pasojë e traditës patriarkale që favorizon trashëgiminë e burrave.⁵⁰

Në korrik të vitit 2018, Kuvendi ndryshoi ligjin për dhunën në familje me qëllim zgjerimin e mbrojtjen së viktimave në marrëdhënie aktive apo bashkim civil. Ndryshimet krijuan një urdhër mbrojtës që mbron automatikisht edhe fëmijët. Policia ka zbatuar proceset e automatizuara të lëshimit për aplikimet e bëra brenda Sistemit të Menaxhimit të Çështjeve të Policisë, i cili mundëson lëshimin e shpejtë të urdhrave dhe gjeneron regjistrimin historik të urdhrave të lëshuar. Gjatë muajit gusht, sistemi gjeneroi mbi 1600

⁴⁵ INSTAT. 2020. Indeksi i Barazisë Gjinore. Marrë nga,

http://www.instat.gov.al/media/6661/gender_equality_index_for_the_republic_of_albania_2020.pdf

⁴⁶ Amnesty International. Report Albania 2019. Online: <https://ëëë.amnesty.org/en/countries/europe-and-central-asia/albania/report-albania/>

⁴⁷ Ibid.

⁴⁸ INSTAT. Dhuna ndaj grave dhe vajzave në Shqipëri. 2019.

⁴⁹ GADC 2019. Diskriminimi me bazë gjinore dhe punë në Shqipëri. Marrë nga https://ëëë.gadc.org.al/media/files/upload/GBD%20Labour%20Albania_EN.pdf

⁵⁰ Amnesty International. Raporti për Shqipërinë 2019. Marrë nga, <https://www.amnesty.org/en/countries/europe-and-central-asia/albania/report-albania/>

urdhra mbrojtës. Në dhjetor të vitit 2018, qeveria nisi funksionimin e qendrës së menaxhimit të krizës për viktimat e sulmeve seksuale në Qendrën Spitalore Universitare të Tiranës.⁵¹

Në vitin 2019, Shqipëria kaloi ciklin e tretë të Rishikimit Universal Periodik (UPR) në Këshillin e të Drejtave të Njeriut të OKB-së. Qeveria pranoi mbi 180 rekomandime për fusha të ndryshme të të drejtave të njeriut, ku numri më i lartë i rekomandimeve i përkiste barazisë gjinore dhe, specifikisht, dhunës ndaj grave. Në deklaratën e Shqipërisë në raportin UPR theksohej se “me rastin e 70 vjetorit të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, më 13 dhjetor 2018, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme të Shqipërisë (MEPJ) ka nisur një platformë online, e cila menaxhohet (ruhet) në faqen zyrtare të internetit të MEPJ, si mekanizëm monitorues për zbatimin e të drejtave të njeriut. Kjo platformë u zhvillua me mbështetjen e UN Women dhe UNFPA në Shqipëri dhe përfshin Planin e Veprimit për të Drejtat e Njeriut dhe Mekanizmin e Monitorimit për lehtësimin e procesit të monitorimit të zbatimit të rekomandimeve të UPR-së së ciklit të dytë dhe të rekomandimeve të organeve të tjera me bazë traktatet që lidhen me rekomandimet e UPR-së.”⁵² Prandaj, është pozitive të theksohet se Shqipëria ka tashmë mekanizmat e monitorimit dhe gjurmimit që mund dhe duhet të zgjerohen për të gjitha fushat e kuadrit ligjor që lidhen me barazinë gjinore dhe fuqizimin e gruas. Disa nga rekomandimet kryesore që iu dhanë Shqipërisë sa i përket agjendës për mbrojtjen e të drejtave të njeriut janë:

- Vazhdimi i harmonizimit të legjislacionit të brendshëm me rregulloret ndërkombëtare.
- Vazhdimi i forcimit të politikave dhe programeve kombëtare për të mbështetur mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të njeriut.
- Vazhdimi i fuqizimit të makinerisë për të drejtat e njeriut në vend për të mbështetur politikatat dhe kuadrin kombëtar.
- Sigurimi i burimeve të mjaftueshme financiare dhe njerëzore për institucionet kombëtare për të drejtat e njeriut me qëllim që të mund të kryejnë detyrat e tyre.
- Ndërmarrja e masave konkrete për të luftuar gjuhën e urrejtjes dhe diskriminimin me bazë orientimin seksual dhe përkatësinë etnike.
- Ndërmarrja e masave efektive për të luftuar dhunën në familje dhe atë me bazë gjinore, e cila zë një hapësirë të konsiderueshme të rekomandimeve të bëra.⁵³

Një nga fushat kryesore ku Shqipëria jep shembull të mirë në operacionalizimin e barazisë gjinore është Buxheti i Përgjigjshëm Gjnor (BPGJ). Ky i fundit zbatohet si në nivelin kombëtar, ashtu edhe në atë vendor. Në nivel kombëtar, BPGJ-ja përcaktohet në Strategjinë për Menaxhimin e Financave Publike (2015-2020) dhe u bë për herë të parë pjesë e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (2015-2020). Në vitin 2016, barazia gjinore u përfshi si një nga parimet themelore të Sistemit Buxhetor të Republikës së Shqipërisë, për të siguruar qasjen e barabartë të grave dhe burrave në Shqipëri ndaj të drejtave dhe mundësive. Rrjedhimisht, në buxhetin e vitit 2019, problemet e pabarazisë gjinore u përfshinë në 37 programe buxhetore të 14 ministrive, duke prekur disa prej sektorëve më të rëndësishëm si: arsimit, shëndetësia, bujqësia etj.⁵⁴ Puna vazhdon për përfshirjen e BPGJ-së në nivelin vendor në çdo njësi, ku nuk mungon si mbështetja ndërkombëtare, ashtu edhe gatishmëria dhe angazhimi i brendshëm. BPGJ-ja mundëson operacionalizimin e angazhimeve të të drejtave të njeriut dhe garanton mosmbetjen e këtyre angazhimeve në letër, por arrijen e ndikimit praktik në jetët e grave dhe vajzave, burrave dhe djemve.

Përveç pjesëmarrjes politike dhe dhunës me bazë gjinore, pjesëmarrja e grave në tregun e punës përbën një tjetër shtyllë që kërkon barazinë gjinore dhe fuqizimin e gruas, pasi të dyja këto shkojnë krah për krah njëra-tjetrës. Analizimi i pjesëmarrjes së grave në tregun e punës është një nga mënyrat më të rëndësishme të kuptimit të modeleve gjinore të shoqërisë shqiptare. Megjithatë, puna e grave shtrihet

⁵¹ Departamenti i Shtetit. Raport për të drejtat e njeriut në Shqipëri i vitit 2019. Marrë nga, <https://www.state.gov/wp-content/uploads/2020/02/ALBANIA-2019-HUMAN-RIGHTS-REPORT.pdf>

⁵² Për më shumë shih: <https://daccess-ods.un.org/TMP/96299.5551526546.html>

⁵³ Për më shumë shih: <https://www.ohchr.org/EN/HRBodies/UPR/Pages/ALindex.aspx>

⁵⁴ Për më shumë shih: https://www.unece.org/fileadmin/DAM/RCM_website/Albania.pdf

në shumë plane dhe është komplekse. Gratë mbeten përgjegjëse në aspektin riprodhues dhe të kujdesit në shtëpi, edhe pse, së bashku me burrat, punonin kundrejt pagesës sektorë të ndryshëm, duke përfshirë edhe ato më teknikët. Në Shqipërinë në ditët e sotme, vërehet dukshëm një ritradicionalizim i roleve dhe pozicioneve gjinore, ku gratë janë sërish pothuajse ekskluzivisht përgjegjëse për riprodhimin dhe punën e papaguar të kujdesit. Sot, gratë në Shqipëri ndeshen me sfida dhe pengesa të shumta sa i përket qasjes ndaj tregut të punës dhe vazhdojnë të mbajnë barra të shumëfishta të roleve tradicionale gjinore. Përfshirja ekonomike dhe fuqizimi i grave mbetet problematik. Pjesëmarrja e grave në krahun e punës është e ulët dhe një përqindje e lartë e grave janë shkurajuar për të hyrë në tregun e punës. Për më tepër, puna e papaguar e përkujdesjes është fusha ekskluzive e grave, duke penguar pjesëmarrjen e tyre në veprimtari prodhuese dhe të paguar.⁵⁵

Metodologjia e kontrollit post-legjislativ

Faza e planifikimit

Nënkomisioni për Barazinë Gjinore dhe Parandalimin e Dhunës ndaj Grave dhe nënkomisioni për të Drejtat e Njeriut të Parlamentit Shqiptar kanë vendosur të kryejnë kontrollin post-legjislativ të Ligjit për Barazinë Gjinore.

Fusha e zbatimit të KPL-së për Ligjin për Barazinë Gjinore është kontrolli i dekretimit të ligjit, kontrolli i hyrjes në fuqi të dispozitave ligjore të ligjit, i mënyrës së interpretimit të ligjit nga gjykatat dhe i mënyrës së përdorimit të tij nga profesionistët ligjorë dhe qytetarët. Për më tepër, ShPL-ja kontrollon ndikimin e LBGJ-së në shoqërinë shqiptare dhe përbushjen e objektivave të synuara të politikës së ligjit dhe efikasitetin e përbushjes së tyre. Në nisje të procesit të ShPL-së, ishte planifikuar të bëhej vlerësimi i zbatimit të kuotave gjinore. Nënkomisioni për Barazinë Gjinore dhe Parandalimin e Dhunës ndaj Grave dhe Nënkomisioni për të Drejtat e Njeriut të Parlamentit të Shqipërisë kanë marrë në konsideratë analizimin e faktorëve që kanë mbështetur zbatimin e kuotave gjinore në strukturat e vendimmarrjes, si dhe ndikimin e zbatimit të tyre së bashku me analizën e faktorëve që kanë penguar zbatimin e këtyre kuotave⁵⁶.

Kontrolli i dokumentacionit dhe mbledhjes së të dhënave

Ky raport është hartuar duke pasur parasysh metodologjinë e KPL-së, hartuar nga WFD⁵⁷. Për t'u përgjigjur e pyetjeve të përcaktuara për qëllime hulumtuese, janë përdorur dy grupe pyetjesh (**ju lutemi shihni shtojcën nr. 4 të këtij raporti**). Raporti u hartua duke përfshirë metodat e mëposhtme:

- **Analiza ligjore** ekzaminoi dhe vlerësoi legjislacionin në fuqi për barazinë gjinore, duke përfshirë çfarëdolloj mospërputhjeje në harmonizimin e legjislacionit kombëtar me *Acquis Communautaire* ("Acquis për Barazinë Gjinore"). Gjithashtu, analiza përpiqet të identifikojë institucionet përgjegjëse, si dhe rolet e përgjegjësive të tyre për zbatimin e LBGJ-së. Për raportin e ShPL-së, janë përdorur disa analiza të ligjeve, traktateve dhe konventave ndërkombëtare referencë për zbatimin e LBGJ-së. Analiza ligjore është kryer për kuptimin e zbatueshmërisë së LBGJ-së me kuadrin ligjor kombëtar dhe legjislacionin dytësor të hartuar.
- **Shqyrtimi i literaturës** është përdorur në pjesë të ndryshme të strukturës së dhënë të raportit për të mbështetur analizën dhe konkluzionet. Shqyrtimi i literaturës shërbeu edhe për të kuptuar mënyrën e zbatimit të LBGJ-së në bazë të analizave të bëra nga organizatat kombëtare dhe

⁵⁵ UN Women Albania. Dosja gjinore. 2016. Marrë nga, https://www2.unwomen.org/-/media/field%20office%20eca/attachments/publications/country/albania/un%20gender%20brief%20albania%202016_en_ëeb.pdf?la=en&vs=5235

⁵⁶ Parlamenti i Shqipërisë, Nënkomisioni për Barazinë Gjinore dhe Parandalimin e Dhunës ndaj Grave dhe Nënkomisioni për të Drejtat e Njeriut (2020). Pse bëhet KPL-ja për LBGJ-në?

⁵⁷ Fondacioni Westminster për Demokraci. (2017). Kontrolli post-legjislativ. Udhëzues për parlamentet. Faqja 7. Marrë nga https://www.efd.org/ëp-content/uploads/2018/07/ëFD_Manual-on-Post-Legislative-Scrutiny.pdf

ndërkombëtare, duke përfshirë rekomandimet për të ardhmen. Për shqyrtimin e literaturës janë përdorur dokumentet dhe kërkimet më të përshtatshme dhe më të fundit të bëra OSHC-së, organet ndërkombëtare, institucionet e pavarura dhe ekspertët e pavarur.

- **Intervistat dhe intervistat e gjysmë strukturuara (shihni shtojcën nr. 1 dhe 2)** me përfaqësuesit e institucioneve përkatëse për vlerësimin e avancimit të LBGJ-së në nivelin institucional dhe opinionet e tyre për zbatimin më të mirë të ligjit në të ardhmen.
- **Mbledhja e të dhënave** – Për përgatitjen e raportit është përdorur një grup parësor dhe dytësor të dhënash për të mbështetur analizën e neneve që lidhen më zbatimin e kuotave gjinore. Për të bërë një vlerësim të zbatimit të ligjit përsa i takon zbatimit të nenit 4 pika 5, të kuotave gjinore në institucionet shtetërore, me kërkesë nga Parlamenti Shqiptar dhe bazuar në një pyetësor të strukturuar u kërkua informacion nga 21 institucione të pavarura. Vetëm 13 prej tyre sollën informacion i cili është përpunuar në shtojcën 6 të kësaj analize. Vetëm të dhënat e ndara sipas gjinisë mundësojnë pasqyrimin e situatës reale të zbatimit të barazisë gjinore në fushën e arsimit, punësimit, pjesëmarrjes në jetën publike, vendimmarrjes, në organizata të ndryshme politike dhe sindikata, borde private, në organizata jo-qeveritare, në jetën ushtarake etj..
- **Verifikimi** - Raporti i ShPL-së u krye në bashkëpunim të ngushtë me Vasilika Hysin, Zëvendëskryetare e Parlamentit të Shqipërisë, Eglantina Gjermani, Kryetare e Nënkomisionit për Barazinë Gjinore dhe Parandalimin e Dhunës ndaj Grave dhe Ivan Radojevic, Menaxher Programi, Fondacioni Westminster për Demokraci (WFD). Për më tepër, raporti do të paraqitet në mbledhje/seancë sipas kërkesave të Parlamentit të Shqipërisë dhe WFD-së, që t'i nënshtrohet një verifikimi, të bëhen komente dhe të arrihet kuptimi i plotë i tij.

Faza e zbatimit

Faza e zbatimit e këtij raporti kaloi nëpër hapat e shkruar më poshtë:

Hapi 1: Identifikimi i fushës së zbatimit të ShPL-së

Gjatë fazës së fillimit, janë organizuar diskutime dhe konsultime nga përfaqësuesit e EFD-së. Një takim është organizuar me Znj. Vasilika Hysi dhe Znj. Eglantina Gjermani për të kuptuar qasjen dhe kërkesën për KPL-në. Identifikimi i fushës së zbatimit u krye bazuar në një dokument të hartuar nga Nënkomisioni i Barazisë Gjinore dhe Parandalimi i Dhunës ndaj Grave dhe të Drejtave të Njeriut nga Parlamenti i Shqipërisë të cilët në takimin e datës 10 janar 2020, vendosën të ndërmarrin kontrollin post-legjislativ për Ligjin për Barazinë Gjinore në Shoqëri sipas gjykimit më poshtë:

*“Pyetja kryesore e ShPL-së do të jetë: **Si kuota gjinore (nuk) zbatohet në praktikë në të gjitha strukturat vendimmarrëse në institucionet e zgjedhura dhe / ose të emëruara. Kanë kaluar 12 vjet që nga miratimi i Ligjit për Barazi Gjinore, ndaj duhet të hulumtohet zbatimi i kuotës gjinore. Nëse nuk zbatohet, cilët janë faktorët kryesorë që kanë penguar ose bllokuar zbatimin? Nëse është e mundur, duhet të paraqiten ndryshime të caktuara në legjislacion për të përmirësuar efektivitetin dhe zbatimin e kuotave gjinore, si dhe nëse masat institucionale që duhen marrë për të siguruar zbatimin e saj. Eksplorimi do të shërbente gjithashtu për të kuptuar se cilat hapa duhet të ndërmerren për të sfiduar stereotipat gjinorë dhe për të rritur angazhimin politik, dhe ndërgjegjësimin e shoqërisë shqiptare veçanërisht ndaj grave drejt pjesëmarrjes së barabartë në nivelet e vendimmarrjes dhe fuqizimit e grave. Në hulumtimin tonë, **do të përfshihet jo vetëm zbatimin e kuotës gjinore si pjesë e Ligjit për Barazinë Gjinore, por gjithashtu do të shqyrtojmë zbatimin e këtij ligji në përgjithësi. Zbatimi i Strategjisë Gjinore (2016-2020) në lidhje me kuotën gjinore do të hulumtohet gjithashtu, në mënyrë që të sigurojë më shumë informacion se si pjesëmarrja më e ekuilibruar e grave dhe burrave ka kontribuar në legjislacionin dhe politikën më të ndjeshme gjinore në Shqipëri.**”***

Hapi 2: Përcaktimi/strukturimi i projekt-konceptit (Concept note)

Hapi i dytë i përgatitjes së raportit ishte strukturimi i një projekt-koncepti (*Concept Note*), i cili u diskutua gjithashtu me WFD-në dhe Parlamentin e Shqipërisë. Gjatë këtyre fazave u përcaktuan metodat

kryesore të konsultimit dhe u krijua pyetësori, i cili u shpërnda tek institucionet e pavarura. Gjithashtu, u diskutua se cilët aktorë duhet të intervistohen, në mënyrë që të përzgjidhen ata të cilët janë më të përshtatshëm për zbatimin e LBGJ-së. Gjatë kësaj faze, u caktuan edhe dy punonjës të Parlamentit të Shqipërisë për të lehtësuar procesin e dërgimit dhe mbledhjes së informacioneve. Dy fazat e para të zhvilluara gjatë periudhës shkurt – mars 2020 u ndërprejnë për shkak të Covid-19-ës dhe puna për KPL-në dhe LGJB-në rifilloi gjatë muajit qershor 2020.

Hapi 3: Mbledhja e të dhënave parësore

Mbledhja e të dhënave parësore është procesi i mbledhjes së të dhënave cilësore dhe sasiore direkt nga literatura dhe institucionet. Mbledhja e këtyre të dhënave u arrit duke përdorur të dhënat e Institutit të Statistikave dhe përmes shqyrtimit të literaturës. Gjithashtu, me anë të pyetësorit, i cili u shpërnda institucioneve të pavarura, u mbledhën disa të dhëna parësore për pyetjet:

- si janë zbatuar kriteret e ligjit për kuotat gjinore në institucionin tuaj;
- numri total i punonjësve në institucionin tuaj dhe, në institucionet e varura prej tij, i ndarë sipas gjinisë;
- numri i grave dhe vajzave në pozicione drejtuese krahasuar me burrat dhe djemtë dhe pozicionet tyre drejtuese;

Hapi 4: Analiza të dhënave

Procesi i mbledhjes së të dhënave filloi përpara krizës së pandemisë COVID-19, megjithatë mbledhja e përgjigjeve zgjati deri në fillim të muajit korrik. Nga 21 institucione të pavarura që morën letrën ku parashtrohej kërkesa për të dhëna, u përgjigjën vetëm 13 prej tyre. Pas mbledhjes së të dhënave, përgjigjet janë përpunuar dhe analiza e rezultateve, si ajo cilësore, ashtu edhe ajo sasiore, janë përdorur për raportin.

Hapi 5: Shpërndarja

Hapi i fundit është thelbësor për komunikimin e rezultateve të KPL-së dhe LBGJ-së. Ai synon:

- Përmirësimin e kuptimit të LBGJ-së dhe të rëndësisë për ndryshime thelbësore të këtij ligji.
- Rritjen e mbështetjes nga Parlamenti i Shqipërisë.
- Avokimin për nisma të reja të kontrollit post-legjislativ për ligjet e tjera
- Nxitjen e vlerësimit *ex-ante* dhe *ex-post* të legjisllacionit në Parlamentin e Shqipërisë.

Sfidat gjatë vlerësimit të kontrollit post legjislativ

Në muajin mars të vitit 2020, Organizata Botërore e Shëndetësisë (ËËHO) e shpalli COVID-19 si pandemi, të shkaktuar nga virusi i ri SARS-CoV-2. Puna për hartimin e raportit të ShPL-së u prek nga pandemia dhe përhapja e virusit. Saktësisht, në mars të vitit 2020, u planifikua procesi i mbledhjes së të dhënave dhe intervistat ballë për ballë. Gjithashtu, u parashikuan diskutime në grupe fokusi me përfaqësues të shoqërisë civile dhe me nëpunës të barazisë gjinore në nivel qendror dhe vendor. Gjatë kësaj periudhë, vizitat në parlament për të diskutuar mbi zhvillimin e procesit të ShPL-së nuk mund të realizoheshin. Në fillim, pandemia krijoi një përvojë shokuuese dhe pak njerëz ishin të gatshëm për të folur dhe për të marrë pjesë në intervistat e zhvilluara online. Puna online e ngadalësoi edhe procesin, pasi njerëzit u mbingarkuan me këtë më mënyrë të re komunikimi. Sa i përket mbledhjes së të dhënave, shqyrtimi i literaturës dhe përpunimi i të dhënave dytësore nuk ishte i vështirë, pasi shumë materiale, raporte dhe studime kërkimore gjenden në internet. Vetëm procesi i marrjes së përgjigjes nga letrat që iu dërguan institucioneve të pavarura zgjati disa muaj.

Gjetjet nga analiza

Historiku se si është përdorur ligji deri më tani dhe rëndësia aktuale e objektivave të ligjit sot

Emergjencia e një ligji për barazinë gjinore në Shqipëri duhet të kuptohet në kontekstin e lëvizjes feministe në fund të viteve 1990 dhe fillim të viteve 2000. Organizata e parë e grave u krijua në 1991, e ndjekur nga disa më shumë midis 1991 dhe 1995. Vetëm në mesin e viteve 2000 numri i OJQ-ve arriti në një sektor të plotë të shoqërisë civile me rreth 600 organizata të regjistruara.⁵⁸ Shumica e kontributeve që solli kjo valë e re feministe në Shqipëri lidheshin me masat legjislative, ku OJQ-të e grave bënë të mundur miratimin e ligjeve të rëndësishëm si Kodi i Familjes, Ligji i Planifikimit Familjar e më vonë ligji kundër dhunës në familje, ligji i barazisë gjinore dhe ligji për mbrojtjen nga diskriminimi. Puna e këtyre organizatave dhe bashkëpunimi midis legjislativit dhe ekzekutivit çoi në ligjin e parë për barazinë gjinore të aprovuar në 2004.⁵⁹ LBGj-ja e vitit 2004 konsistoi në vendosjen e të dy gjinive në kushte të barabarta në fushën e punësimit, arsimit, punës dhe vendimmarrjes. Objektivat kryesore të deklaruara të ligjit ishin sigurimi i të drejtave të barabarta për gratë dhe burrat (siç parashikohet në nenin 18 të Kushtetutës), përcaktimi i masave për promovimin e mundësive të barabarta për të eliminuar diskriminimin e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë dhe përcaktimin e përgjegjësive të administratës qendrore dhe lokale në hartimin e politikave që synojnë promovimin e një shoqërie të barabartë gjinore.⁶⁰

Ligji i vitit 2004 për Barazinë Gjinore ishte jetëshkurtër dhe u zëvendësua menjëherë nga një Ligji për Barazinë Gjinore në Shoqëri, i miratuar në muajin dhjetor 2008, cili u konsiderua më gjithëpërfshirës. LBGj-ja kishte fushëveprim të përafuar me standardet ndërkombëtare, veçanërisht CEDAW dhe përfshinte një gamë më të gjerë fushash si dhe prezantoi kuota më specifike gjinore dhe dispozita inkurajuese për të rritur pjesëmarrjen e grave në fusha të ndryshme.

Ligji Nr. 9970 “Për barazinë gjinore në shoqëri” (LBGj), datë 24.07.2008, përcakton parimet kryesore të barazisë midis burrave dhe grave në jetën publike dhe private. Ai synon të sigurojë mbrojtje efikase kundër diskriminimit për shkak të gjinisë; përcakton masat mbrojtëse për mundësi të barabarta midis burrave dhe grave, në mënyrë që të eliminojë diskriminimin për shkak të gjinisë; përcakton përgjegjësitë e organeve shtetërore në mbështetjen e barazisë gjinore; dhe përcakton mbrojtjen nga diskriminimi dhe ngacmimi duke siguruar masa të veçanta për të garantuar të paktën 30% të përfaqësimit të gjinisë së nënpërfaqësuar në pozicionet politike dhe publike të vendimmarrjes për gjininë më pak të përfaqësuar.⁶¹ Për më tepër, ligji parashikon barazi gjinore në arsim, punësim dhe media.

Objekti i Ligjit për Barazinë Gjinore

Siç parashikohet në nenin 1, objekti - Ky ligj rregullon çështjet themelore të barazisë gjinore në jetën publike, të mbrojtjes dhe trajtimit të barabartë të grave e burrave, për mundësitë dhe shanset e barabarta për ushtrimin e të drejtave, si dhe për pjesëmarrjen e ndihmesën e tyre në zhvillimin e të gjitha fushave të jetës shoqërore.

Qëllimi i Ligjit për Barazinë Gjinore:

- a) të sigurojë mbrojtje efikase nga diskriminimi për shkak të gjinisë dhe nga çdo formë sjelljeje, që nxit diskriminimin për shkak të gjinisë;
- b) të përcaktojë masa për garantimin e mundësive të barabarta ndërmjet grave e burrave, për të eliminuar diskriminimin e bazuar në gjini, në çfarëdo forme me të cilën shfaqet;

⁵⁸ Ibid

⁵⁹ Për ligjin e plotë: <https://www.legislationline.org/documents/id/16295>

⁶⁰ Ibid.

⁶¹ Neni 1 kombinuar me nenin 2 të LBGj.

- c) të përcaktojë përgjegjësitë e autoriteteve shtetërore, qendrore dhe vendore, për të hartuar dhe zbatuar aktet normative, si dhe politikat që mbështesin zhvillimin dhe nxitjen e barazisë gjinore në shoqëri.

Parimet themelore të LBGJ-së të përcaktuara në nenin 3 të tij janë barazia dhe mosdiskriminimi. Këto parime bazohen te Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Konventa “Për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Ndaj Grave” dhe në të gjitha aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

Neni 4 i LBGJ-së përfshin disa përkufizime të lidhura me gjininë.

LBGJ-ja përkufizon barazinë gjinore, diskriminimin me bazë gjinore, përfshirjen gjinore, përfaqësimin e barabartë gjinor, masat e posaçme të përkohshme, nëpunësit që merren me çështjet gjinore, vlerën e barabartë për punën e barabartë, ngacmimet me bazë gjinore dhe ngacmimin seksual.⁶² Megjithatë, ky grup përkufizimesh është i kufizuar. Ligji në pjesën e përkufizimeve nuk përmban përkufizime të seksit që lidhet me tiparet biologjike të një personi kundrejt gjinisë, të cilën LBGJ-ja e përcakton si mundësi dhe attribute sociale të lidhura me të qenit grua apo burrë dhe marrëdhëniet mes tyre. Për më tepër, stereotipet gjinore dhe identiteti gjinor nuk janë përkufizuar. Gjithashtu, përkufizimi i gjinisë ka nevojë të përmirësohet.

LBGJ-ja përfshin stimuj për rritjen e pjesëmarrjes së barabartë të grave në jetën publike dhe politike.⁶³ Ndonëse stimujt kuptohen si mekanizëm për rritjen e numrit të grave në pozicionet zyrtare, ligji i referohet qartësisht edhe punësimit duke parashikuar rritjen e përfaqësimit të barabartë ekonomik sa i përket statusit dhe punësimit.

Neni 5 parashikon se LBGJ-ja zbatohet për të gjithë personat që jetojnë dhe qëndrojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë. Gjithashtu, shtetasit shqiptarë, me banim të përkohshëm ose të përhershëm jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë, gëzojnë mbrojtjen që ofron ky ligj, në marrëdhëniet me organet shtetërore shqiptare dhe personat fizikë e juridikë të huaj, me banim, të përkohshëm ose të përhershëm jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, gëzojnë mbrojtjen, që ofron ky ligj, në marrëdhëniet me organet shtetërore shqiptare.

Agjencia zbatuese përgjegjëse për LBGJ-në

Pjesa II e LBGJ-së, brenda neneve 10, 11, 12, 13 dhe 14 trajton rregullimin e mekanizmave institucionale përgjegjës për zbatimin jo vetëm të dispozitave të këtij ligji, por edhe për mbikëqyrjen e zbatimit dhe promovimit të zbatimit të parimit të barazisë gjinore në vend.

Organet përgjegjëse për arritjen e barazisë gjinore sipas **nenit 10 të LBGJ-së** janë:

1. Këshilli i ministrave.
2. Këshilli Kombëtar për Barazinë Gjinore
3. Ministria që mbulon çështjet e lidhura me barazinë gjinore - aktualisht është MSHMS

Në nenin 11, parashikohet organi këshillimor për LBGJ-në, i cili është Këshilli Kombëtar për Barazinë Gjinore dhe më pas, vjen **neni 12**, ku përcaktohen detyrat e Këshilli Kombëtar për Barazinë Gjinore

Neni 13/1, përcakton se autoriteti shtetëror përgjegjës për zbatimin e ligjit dhe të programeve shtetërore për barazinë gjinore është ministria që mbulon çështjet e barazisë gjinore.

⁶² Neni 4.

⁶³ Neni 8.

Institucionet shtetërore, në nivel qendror dhe vendor, kanë detyrimin ligjor të bashkëpunojnë me ministrin përkatës për shkëmbimin e informacioneve dhe për lehtësimin e përbushjes së funksionit të tij. Për këtë arsye, në çdo ministri, emërohet një nëpunës për barazinë gjinore.

Pjesa II përfshin në **Nenin 14**, organet e qeverisjes vendore, të cilëve, në mënyrë inkurajuese u kërkohet të bashkëpunojnë me organet e qeverisjes qendrore për zbatimin e legjisllacionit në fuqi dhe politikave shtetërore për barazinë gjinore, si dhe të bashkëpunojnë ngushtë me organizatat jofitimprurëse për arritjen e barazisë gjinore në fusha të ndryshme, në territorin që mbulojnë. Gjithashtu, këtyre organeve u kërkohet të kryejnë mbledhjen dhe përpunimin e statistikave vendore, të ndara sipas gjinisë, si dhe të emërojnë një ose disa nëpunës vendorë, që merren me çështje të barazisë gjinore, pranë tyre.

Makineria e barazisë gjinore në Shqipëri, e cila përbëhet nga disa struktura shtetërore, është ngritur për të zbatuar Ligjin për Barazinë Gjinore. Funkzioni i saj kryesor është monitorimi dhe garantimi i zbatimit të ligjit, parimit të mosdiskriminimit dhe barazisë mes grave dhe burrave. LBGJ-ja përcakton si autoritetin përgjegjës për çështjet e barazisë gjinore Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Në bazë të LBGJ-së, si dhe të Ligjit për Masat kundër Dhunës në Familje në marrëdhëniet familjare, Ministri kryen funksionet e përcaktuara në ligj, i ndihmuar nga një strukturë e personalizuar brenda ministrisë, që aktualisht është Sektori i Barazisë Gjinore brenda Drejtorisë së Përgjithshme të Shëndetësisë dhe të Politikave dhe Zhvillimit të Mbrojtjes Sociale, i cili është në funksionim në këtë Ministri që prej vitit 2006. Misioni i tij kryesor është promovimi i barazisë gjinore dhe i pjesëmarrjes së gjerë të grave në jetën ekonomike, politike dhe kulturore të vendit, si dhe formulimi dhe hartimi i politikave për parandalimin dhe reduktimin e dhunës në marrëdhëniet familjare dhe të dhunës me bazë gjinore në përgjithësi.

Që nga miratimi i tij në vitin 2008, ligji ka qenë thelbësor në përpjekjet për të institucionalizuar sistemin e kuotave gjinore në të gjitha nivelet e vendimmarrjes. Për më tepër, ligji ishte baza për krijimin e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor në proceset e buxhetimit të nivelit qendror. LGE është përdorur gjithashtu si një mekanizëm koordinues për të siguruar që gjinia të përfshihet në nivelin qendror dhe lokal duke marrë parasysh natyrën ndërsektoriale të ligjit dhe dimensionet e shumta të tij. Megjithatë ligji është përdorur gjerësisht si pikë referimi për disa nga aspektet e tij (të tilla si kuota gjinore, mekanizmat institucionalë për të siguruar barazinë gjinore etj.), jo të gjitha dispozitat e tij janë përdorur siç duhet që nga miratimi i tij. Prandaj, ndërsa shumë nga dispozitat e ligjit janë të rëndësishme sot, ekziston nevoja për të zgjeruar dhe thelluar mandatin dhe dispozitat e LGE-së, në mënyrë që t'i përgjigjen siç duhet përpjekjeve për të siguruar barazinë gjinore në të gjitha fushat e jetës.

Rëndësia e verifikimit nëse ligji i shërben ende qëllimit të tij

Ligji për Barazinë Gjinore është një nga mjetet më të rëndësishme në luftën për barazi gjinore në shoqërinë shqiptare. LBGJ-ja përcakton kornizën institucionale dhe të politikave për të luftuar diskriminimin dhe pabarazitë me bazë gjinore. Sidoqoftë, analiza e zbatimit të ligjit dhe intervistat me aktorë të ndryshëm theksojnë nevojën për një rishikim domethënës të LBGJ-së, nga fushëveprimi dhe objektivat e tij, deri në funksionimin e tij. Disa aspekte shpjegojnë pse ligji siç është aktualisht nuk i shërben qëllimit të tij.

Së pari, objektivat e ligjit pjesërisht janë ende të rëndësishme sot, pasi ai synon të sigurojë rritjen e përfaqësimit të grave në fusha të ndryshme të jetës dhe t'i mbrojë ato nga diskriminimi. Megjithatë, duhet të theksohet se disa pjesë të tjera të legjisllacionit që mbulojnë fusha të ngjashme me ato të LBGJ-së, të cilat janë miratuar dhe kanë ndryshuar që nga viti 2008 janë kthyer në pika kryesore referimi, duke e lënë LBGJ-në të vjetëruar. Për shembull, sigurimi i përfaqësimit të barabartë në vendimmarrje, kryesisht zgjedhjet lokale dhe qendrore, rregullohet nga Kodi Zgjedhor me ndryshimet e tij përgjatë viteve (2008, 2012, 2015 dhe 2020). Kodi Zgjedhor përmban një masë të gjerë për të siguruar përputhjen me kuotën gjinore dhe është ligji kryesor i referimit për këtë temë. Në fakt, për shkak të ndryshimeve më të fundit, dispozitat e Kodit Zgjedhor dhe LBGJ mbi kuotat gjinore nuk janë më në

përputhje mes tyre, prandaj një rishikim i këtij të fundit është i nevojshëm për të siguruar harmonizimin me të parën.

Së dyti, objektivi i deklaruar për të siguruar mbrojtje efektive nga diskriminimi për shkak të gjinisë nuk është i zbatueshëm me LBGJ-në pasi ajo bie nën fushën kryesore të Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i cili gjithashtu ka një mekanizëm zbatues, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD). Rastet e diskriminimit të përfaqësuar në KMD e konsiderojnë si bazë ligjore Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në vend të LBGJ-së.

Së treti, LBGJ-ja nuk përmban dispozita specifike mbi dhunën me bazë gjinore si një nga format më të rënda të diskriminimit dhe një manifestim i pabarazive midis burrave dhe grave. Këto janë të mbuluara nga ligji për dhunën në familje. Sidoqoftë, të dy ligjet duhet të jenë të ndërlidhura. Prandaj, LBGJ-ja duhet të jetë më mirë i lidhur me ligjet e tjera që trajtojnë barazinë gjinore, të cilat janë miratuar pas vitit 2008 dhe për këtë arsye nuk janë referuar në LBGJ.

Së katërti, gratë shqiptare vazhdojnë të jenë të marginalizuara dhe të diskriminuara dhe LBGJ-ja nuk ofron mbrojtje ndaj formave të shumta të diskriminimit. Gratë nga grupe të ndryshme përjetojnë forma të shumta të pabarazisë. Faktorë si raca, besimi, përkatësia etnike, mosha, aftësia e kufizuar, seksualiteti, vendndodhja dhe statusi i punësimit, kur gërshetohen edhe me gjininë, krijojnë përvoja veçanërisht shqetësuese lidhur me diskriminimin dhe pabarazinë, faktorë të cilët nuk përmenden nga LBGJ-ja. Kjo do të thotë që gratë vendosen në një pozitë të pafavorshme dhe të paqartë duke pasur mbrojtje të kufizuar ose aspak mbrojtje ndaj diskriminimeve të shumta që përjetojnë. Sipas mendimit të përfaqësuesve të shoqërisë civile në Këshillin Kombëtar të Barazisë Gjinore, ligji duhet të rishikohet plotësisht, pasi ka natyrë deklarative e cila duhet riparë urgjentisht. Parlamenti dhe qeveria duhet të rishikojnë legjislacionin dhe politikën ekzistuese për të siguruar që ka në fokus ata elementë ndërveprues midis gjinisë dhe karakteristikave të tjera që çojnë në diskriminim të shumëfishtë ndaj grave.

Së pesti, LBGJ-ja e përkufizon qartësisht gjininë si mundësitë dhe atributet shoqërore të lidhura me të qenit grua ose burrë, si dhe marrëdhëniet mes tyre. LBGJ-ja në përkufizimet e tij nuk bën dallimin mes gjinisë dhe seksit. Gjithashtu, nuk përmban asgjë sa i përket “identitetit gjinor”. LBGJ-ja në përkufizimet e tij nuk përfshin “dhunën për shkak të gjinisë” dhe “dhunën seksuale”. LBGJ-ja ndalon përgjithësisht diskriminimin, ndërsa ka nene specifike për “Mbrojtjen dhe trajtimin e barabartë gjinor në marrëdhëniet e punës”. Ligji nuk specifikon asnjë masë të posaçme për institucionet publike për të parandaluar diskriminimin për shkak të gjinisë dhe për të garantuar barazinë gjinore. Si përfundim në lidhje me përkufizimet, LBGJ-ja përfshin disa parime të barazisë gjinore të copëzuar dhe që nuk përputhen.

*“Ligji duhet të njohë ekzistencën e dallimeve të karakteristikave të seksit kur duhet të bëjë përkufizimin dhe kategorizimin e gjinisë. Ekzistenca e personave interseksuale konfirmon faktin se seksi është një spektër i gjerë dhe se ekzistojnë njerëz të tjerë me larmi karakteristikash seksuale të ndryshme nga ato të meshkujve dhe femrave. Ligji duhet të pranojë edhe faktin se gjinia duhet perceptuar dhe pranuar si zgjedhje personale e individëve për të përcaktuar seksin e tyre dhe autonominë trupore në shoqëri ashtu siç ata zgjedhin dhe ndjejnë”.*⁶⁴

LBGJ-ja ekzistuese nuk përfshin pabarazitë socio-ekonomike dhe karakteristikat e mbrojtura. Gjithashtu, në mënyrë që barazia gjinore të pranohet nga shoqëria, ligji duhet të përfshijë një nen që zbaton integrimin e barazisë gjinore në të gjitha strategjitë dhe / ose politikat e ndryshme të hartuara nga qeveria. Nenet mbi mosmarrëveshjet dhe sanksionet duhet të forcohen gjithashtu dhe jo vetëm ato që duhet të përputhen me Kodin Zgjedhor.

Gjetjet kryesore nga procesi i kontrollit post-legjislativ për Ligjin e Barazisë Gjinore

Ligji për Barazinë Gjinore, është një ligj i veçantë që synon të rregullojë çështjet themelore të barazisë gjinore në jetën publike, mbrojtjen dhe trajtimin e barabartë të grave dhe burrave në lidhje me shanset

⁶⁴ Intervistë me përfaqësues të Shoqërisë së Ndhmës Ligjore Tiranë.

*dhe mundësitë e barabarta për ushtrimin e të drejtave të tyre, si dhe pjesëmarrjen dhe kontributin në përparimin e të gjitha sferave shoqërore.*⁶⁵

Ligji për Barazinë Gjinore është miratuar kryesisht në mënyrë të tërthortë përmes legjislacionit tjetër përkatës dhe më e rëndësishmja është jetësuar përmes zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore, aktualisht në përsëritjen e tij të tretë (2016-2020). Që nga miratimi i tij në vitin 2008, ligji nuk ka pësuar asnjë ndryshim.

Në total, janë miratuar 6 akte nënligjore që kur u miratua LBGj-ja. Këto përfshijnë kryesisht vendimet e Këshillit të Ministrave për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe rregullimin dhe krijimin e Këshillit Kombëtar për Barazinë Gjinore. Rregullore të tjera për të funksionalizuar qëllimet e tjera të deklaruara të LBGj nuk janë diskutuar ose miratuar. Dy akte të rëndësishme nënligjore jo vetëm për zbatimin e LBGj, por edhe për procesin e Kontrollit Post Legjislativ janë VKM Nr. 465 datë 18.07.2012 "Për integrimin gjinor në programin buxhetor afatmesëm" dhe Udhëzimin nr. 1220 datë 27.05.2010 të Ministrit të Punës dhe Çështjeve Sociale (aktualisht Ministër i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale) mbi "Përcaktimin e vlerësimit dhe monitorimit të treguesve të barazisë gjinore dhe dhunës ndaj grave, përfshirë mbledhjen e dhunës në familje dhe analizën e të dhënave".⁶⁶ Përveç këtyre akteve nënligjore, disa pjesë të tjera të legjislacionit i referohen LBGj-së. Ndërsa Kodi Zgjedhor nuk përmend në mënyrë specifike LBGj, por ai i referohet kuotave gjinore, të cilat fillimisht u futën në LBGj. Nga ana tjetër, Ligji për Vetëqeverisjen Vendore i referohet LBGj-së, por nuk bën një zotim thelbësor për të arritur qëllimet e LBGj-së.

Ligji për Barazinë Gjinore përcakton vetëm disa rregulla themelore, por rregullat specifike përcaktohen në ligjet e posaçme. Trajtimi i barabartë i burrave dhe grave kërkohet të zbatohet brenda kornizës së termave dhe kushteve të vendosura nga aktet nënligjore ose ligje të tjera specifike.

Rregulloret nënligjore në zbatim të LGE janë:

- Vendimi i Këshillit të Ministrave (VKM) Nr. 122, datë 2.2.2009 "Për miratimin e rregullores së Këshillit Kombëtar për Barazinë Gjinore".⁶⁷
- Udhëzimi Nr. 1220, datë 27.5.2010, i Ministrit të Punës dhe Çështjeve Sociale "Për përcaktimin e treguesve për vlerësimin dhe monitorimin e treguesve të barazisë gjinore dhe dhunës ndaj grave, përfshirë dhunën në familje, monitorimin, mbledhjen dhe përpunimin e tyre".
- VKM Nr.573, datë 16.6.2011 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Reduktimin e Dhunës me Bazë Gjinore dhe Dhunës në Familje, 2011-2015, dhe Planit të Veprimit për zbatimin e saj".
- VKM Nr. 465, datë 18.7.2012 "Për integrimin gjinor në programin buxhetor afatmesëm".
- VKM Nr. 733, datë 20.10.2016 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Planin e Veprimit 2016-2020".
- Urdhri i Kryeministrit nr. 239, datë 13.12.2017 "Për krijimin e Këshillit Kombëtar për Barazinë Gjinore (KKBGJ).

Këshilli Kombëtar për Barazinë Gjinore ushtron veprimtarinë e tij bazuar në parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit, si dhe parime të tjera, të sanksionuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në Konventën "Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave", dhe të gjitha aktet e tjera ndërkombëtare, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 9970, datë 24.7.2008 "Për barazinë gjinore në shoqëri".⁶⁸ Këshilli Kombëtar për Barazinë Gjinore përfshin përfaqësues të qeverisë dhe shoqërisë civile të cilët emërohen sipas procedurës së përcaktuar në urdhrin e Kryeministrit për krijimin e Këshillit Kombëtar për Barazinë Gjinore. Mandati i anëtarëve të Këshillit Kombëtar për Barazinë Gjinore është 4 vjet, me të drejtë riemërimi, me përjashtim të anëtarëve që janë zgjedhur në

⁶⁵ Shihni nenin 1 të LBGj

⁶⁶ Informacion i marrë nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

⁶⁷ Vendim i marrë në zbatim të nenit 100 të Kushtetutes dhe pikes 4 të nenit 11 të LBGj.

⁶⁸ Neni 1 i Rregullores për Funkcionimin e Këshillit kombëtar për Barazi Gjinore.

detyrë.⁶⁹ Kryetari i Këshillit Kombëtar për Barazinë Gjinore është ministri që mbulon çështjet e barazisë gjinore, aktualisht është Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Bazuar në LBGj, propozimet mbi politikat për barazinë gjinore i janë besuar Këshillit Kombëtar për Barazinë Gjinore. Ky këshill ka për detyrë të këshillojë qeverinë për përcaktimin e kryerjes së politikave shtetërore bazuar në ligjin e barazisë gjinore, përveç çështjeve të shqyrtuara nga Këshilli Kombëtar i Punës dhe të sigurojë integrimin gjinor në të gjitha fushat.

Një akt tjetër i rëndësishëm nënligjor është Udhëzimi Nr. 1220, datë 27.5.2010 "Për përcaktimin dhe monitorimin e treguesve të barazisë gjinore dhe dhunës ndaj grave, përfshirë dhunën në familje, mbikëqyrjen, mbledhjen dhe përpunimin". Ky udhëzim i rëndësishëm urdhëron që mbledhja e të dhënave statistikore gjinore, monitorimi dhe vlerësimi i treguesve të barazisë gjinore dhe dhunës ndaj grave, përfshirë dhunën në familje, të kryhen në nivel lokal dhe kombëtar.

Një rol shumë të rëndësishëm në përcaktimin dhe mbledhjen e treguesve të barazisë gjinore dhe dhunës ndaj grave luan Drejtorja e Shanseve të Barabarta dhe Politikave Familjare (sot Sektori i Barazisë Gjinore brenda Drejtorisë së Përgjithshme të Shëndetësisë dhe Politikës së Mbrojtjes Sociale dhe Zhvillimit). Kjo është struktura për avancimin e barazisë gjinore dhe parandalimin e dhunës ndaj grave, përfshirë dhunën në familje, e cila vlerëson të dhënat statistikore, si dhe harton raporte në fushën e barazisë gjinore dhe dhunës ndaj grave. Me kërkesë të MShMS, Instituti i Statistikave të Shqipërisë (INSTAT) përcjell në strukturën statistikore të kësaj ministrie të gjitha të dhënat e mbledhura për treguesit e barazisë gjinore dhe dhunës në familje. Të gjitha të dhënat janë mbledhur bazuar në forma të ndryshme që janë pjesë e udhëzimit Nr. 1220, datë 27.5.2010.

Disa vjet pas këtij udhëzimi, në lidhje me treguesit e monitorimit të barazisë gjinore dhe dhunës ndaj grave, për fat të keq Ligji Nr. Nr. 17/2018, "Për statistikat zyrtare" nuk e ka konsideruar LGE-në dhe në asnjë prej neneve të saj nuk përmendet rëndësia e të dhënave për mosmarrëveshje gjinore.⁷⁰

Rregullore tjetër është, - Vendimi i Këshillit të Ministrave (VKM) Nr.573, datë 16.6.2011 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Reduktimin e Dhunës me Bazë Gjinore dhe Dhunës në Familje, 2011-2015, dhe Plani i veprimit për zbatimin e tij."⁷¹ Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, nenit 10 të ligjit nr. 9970, datë 24.7.2008 "Për Barazinë Gjinore në Shoqëri" dhe ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006 "Për masat kundër dhunës në marrëdhëniet familjare", i ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli të Ministrave. Kjo VKM (573) shoqërohet nga një analizë e ligjeve dhe politikave ndërsektoriale, duke përfshirë disa analiza mbi zbatimin e LBGj-së.

Vizioni i strategjisë ishte: "Një shoqëri në të cilën barazia gjinore respektohet dhe vlerësohet, mësohet, mbështetet dhe inkurajohet, ku dhuna për shkak të gjinisë e çfarëdo lloji nuk tolerohet, por dënohet, ku mbështeten dhe mbrohen ata që preken prej saj dhe ku ka mundësi të barabarta dhe trajtim të barabartë është një realitet për të gjithë, pavarësisht nga gjinia."⁷² Qëllimi i strategjisë ishte të tregonte mënyrat dhe mekanizmat institucionalë për përfshirjen e çështjeve gjinore në politikat publike, për zbutjen e dallimeve gjinore dhe parandalimin dhe luftën kundër dhunës për shkak të gjinisë. Qëllimi është që veprimet e ndërmarra në kontekstin e kësaj strategjie të kontribuojnë në drejtim të arritjes së katër rezultateve specifike afatgjata, të cilat nga ana e tyre ndikojnë në përmbushjen e vizionit të strategjisë."⁷³

Në muajin korrik 2012, Këshilli i Ministrave miratoi vendimin nr. 465 "për Integrimin Gjinor në Programin Buxhetor Afatmesëm". Kjo shënoi momentin e parë historik të integrit të çështjeve gjinore në sistemin e buxhetimit dhe bazën e parë ligjore për futjen e buxhetimit gjinor në Shqipëri. Pas vendimit, u

⁶⁹ Neni 5 i Rregullores për Funkcionimin e Këshillit kombëtar për Barazi Gjinore.

⁷⁰ Instituti i Statistikave. 2018. Ligji për statistikat zyrtare. Marrë, http://www.instat.gov.al/media/3973/liqj-nr-17-dt-542018_per-statistikat-zyrtare.pdf

⁷¹ Ministria e Mbrojtjes (2011). https://www.mod.gov.al/images/PDF/barazia_gjinore_strategji.pdf

⁷² VKM nr.573. faqe 37

⁷³ VKM nr.573. faqe 38

përgatitën një metodologji dhe një udhëzues për të ndihmuar zyrtarët qeveritarë të zbatojnë buxhetimin gjinor. Si rezultat, katër (4) programe buxhetore pilotuan buxhetimin gjinor në dokumentin e Planifikimit Afatmesëm të Buxhetimit (PBA) të 2013-2015. Futja e buxhetimit gjinor në vitin 2012 ishte një hap shumë i rëndësishëm drejt një qëllimi edhe më të madh siç është integrimi gjinor në Shqipëri. Për kohën, u konsiderua thelbësore për të arritur barazinë gjinore në Shqipëri, jo vetëm në hartimin dhe zbatimin e politikave, por edhe në hartimin e buxhetit. Prandaj, për këtë qëllim, institucionalizimi i buxhetimit gjinor ishte i domosdoshëm për të garantuar zbatimin e tij dhe Shqipëria miratoi një numër politikash dhe masash buxhetore për të pasuruar kornizën ligjore..

Ky vendim u ndryshua në vitin 2016 nga Këshilli i Ministrave dhe nga Vendimi Nr. 938, datë 28.12.2016, "Për miratimin e dokumentit të programit buxhetor Afatmesëm, i rishikuar, 2017-2019."⁷⁴ Me ndihmën teknike të ofruar nga UNËOMEN, gjatë fazës së dytë të përgatitjes së PBA 2016-2018, u identifikuan 5 programe të reja që kishin planifikuar qëllime, objektiva, produkte, aktivitete dhe kosto të lidhura me integrimin gjinor. Këto programe të reja iu shtuan 19 programeve buxhetore të identifikuarra prej kohësh, duke sjellë në 24 programe gjithsej që përfshijnë buxhetimin gjinor në PBA.

Një akt tjetër nënligjor është VKM Nr. 733, datë 20.10.2016 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Planin e Veprimit 2016-2020"⁷⁵. Kjo strategji ndërtohet gjithashtu bazuar në një vlerësim të strategjisë së mëparshme. Sidoqoftë, ky vlerësim nuk merr në konsideratë të konsiderueshme zbatimin e LBGj-së gjatë periudhës së zbatimit të Strategjisë Kombëtare për barazinë gjinore dhe Reduktimin e Dhunës në Familje, 2011-2015, dhe planin e veprimit për zbatimin e tij. Vizioni i strategjisë është "Një shoqëri e cila mban barazinë gjinore si një parakusht për zhvillimin e qëndrueshëm dhe synon zero tolerancë ndaj dhunës për shkak të gjinisë dhe dhunës në familje".

Kjo strategji ka katër qëllime strategjike:

- **Qëllimi Strategjik 1:** Fuqizimi ekonomik i grave dhe burrave.⁷⁶
- **Qëllimi Strategjik 2:** Garantimi i pjesëmarrjes dhe angazhimit faktik dhe të barabartë të grave në vendimmarrjen politike e publike.
 - Duke iu referuar LBGj-së, ky qëllim strategjik ka përcaktuar Objektivin 2.1: Rritja e vendimmarrjes në proceset publike të grave në nivel drejtues, proceset ligjvënëse, politikëbërëse dhe planifikuese në nivel qendror. *Rezultati i pritshëm: (i) rritja e pranisë dhe kontributit të grave në 40% në jetën publike dhe politike në nivel qendror.*
 - Gjithashtu nën këtë objektiv janë planifikuar aktivitetet: 2.1.2 -Nisma për të përmirësuar legjislacionin për një kuotë me të paktën 40% gra në bordet e drejtoreshave -që menaxhojnë dhe supervizojnë ente dhe institucione publike 2.1.3 - Nisma për të përmirësuar legjislacionin që të sigurojë minimumi me 40% gra në të gjitha bordet këshillimore dhe organet e zgjedhura, një përfaqësim dinjitoz të parashikohet për përfaqësuese nga Grupet vulnerabël (PAK, rome, etj); 2.1.4. Nisma për të siguruar gra në të gjithë kabinetet e ministrave për këshillimet, ekspertizat në të gjitha proceset e vendimmarrjes.
 - Objektivi 2.2: Rritja në 40% e grave në proceset publike në nivel vendimmarrës në pushtetin vendor. *Rezultati i pritshëm: (i) rritja e pranisë dhe kontributit të grave në politikëbërjen vendore në 40%, si pasojë e rritjes së numrit të tyre në këshillat bashkiake.*
 - **Qëllimi Strategjik 3:** Reduktimi i dhunës për shkak të gjinisë dhe dhunës në familje.
 - **Qëllimi strategjik 4:** Fuqizimi i rolit koordinues dhe monitorues të Mekanizmit Kombëtar të Barazisë Gjinore si dhe ndërgjegjësimi i shoqërisë për të përparuar barazinë gjinore.
 - Duke iu referuar Ligjit për Barazinë Gjinore, ky qëllim strategjik ka parashikuar: **Objektivin 4.1:** Përmirësimi i Sektorit të Barazisë Gjinore, në përputhje me rolin e tij sipas legjislacionit në fuqi dhe rekomandimeve të konventave e dokumenteve ndërkombëtare. Ky objektiv ka si tregues: (i) Në fund të vitit 2020, Sektori i Barazisë

⁷⁴ Në zbatim të nenit 100 të Kushtetutës dhe nenit 26 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, me propozim të Ministrit të Financave, Këshillit të Ministrave.

⁷⁵ <https://www.un.org.al/sites/default/files/SKGJB-EN-ëeb.pdf>

⁷⁶ Objektivi 1 dhe 3 nuk do të analizohen për efekt të këtij raporti, pasi nuk janë relevante.

- Gjinore në MShMS i fuqizuar (me strukturë të konsoliduar dhe efçente), në përputhje me rolin e tij koordinues dhe monitorues;
- Për të arritur këtë tregues janë planifikuar aktivitetet e mëposhtme: 4.1.2. Nisja/koordinimi i proceseve të monitorimit të LBGJ-së dhe LDHF-së etj., siç janë raportet e monitorimit të përgatitura (psh në lidhje me zbatimin e LBGJ)⁷⁷; 2016-2017, monitorimi i ligjit për barazinë gjinore; 4.1.3. Harmonizimi i legjislacionit shqiptar me legjislacionin ndërkombëtar dhe me *Acquis* të BE-së për integrimin e perspektivës gjinore, në përputhje dhe me rekomandimet e dala nga monitorimi i zbatimit të LBGJ-së apo nga rekomandimet nga Komiteti i CEDAW, etj.
 - Objektivi 4.2: Konsolidimi i rrjetit të nëpunësve në çështjet gjinorë në nivelin qendror dhe vendor dhe sigurimi i qëndrueshmërisë së tyre në punë - parashikohen treguesit: (i) Në fund të vitit 2020, numri i nëpunësve gjinorë në nivel qendror, me kohë të plotë, dedikuar tërësisht zbatimit të legjislacionit për barazinë gjinore, i rritur me 100% [pra nga 0 nëpunës gjinorë me kohë të plotë të emëruar në vitin 2015 (ose 0%), në 18 nëpunës gjinorë me kohë të plotë të emëruar deri në fund të vitit 2020 (ose 100%)]. (ii) Në fund të vitit 2020, numri i nëpunësve gjinorë me kohë të plotë në njësitë e vetëqeverisjes vendore, i rritur me 28% [pra nga 44 nëpunës gjinorë me kohë të plotë në nivel të vetëqeverisjes vendore në fillim të vitit 2016 (ose 72%), në 61 nëpunës gjinorë me kohë të plotë në fund të vitit 2020 (ose 100%), pra një rritje me 17 nëpunës gjinorë (ose me 28%)]
 - Për të arritur këtë tregues nën këtë objektiv janë planifikuar aktivitetet: 4.2.2. Emërimi i nëpunësve gjinore me kohë të plotë (NGJQ) (sigurimi i qëndrueshmërisë së rrjetit të NGJQ, kalimi nga pikat fokale tek zyrtarët gjinor, në përputhje me kërkesat e ligjit). Treguesi i kësaj veprimtarie janë; numri i NGJQ-ve me kohë të plotë të caktuar në nivelin qendror; përshkrime të azhurnuara të punës, në përputhje me legjislacionin në fuqi; % e buxhetit e pasqyruar në buxhetet përkatëse të ministrive të linjës, në mbështetjen e qëndrueshmërisë së këtij rrjeti; 4.2.4. Emërimi i NGJV-ve me kohë të plotë në 61 bashki të vendit, në përputhje me ligjin për Barazinë Gjinore. Treguesi i kësaj veprimtarie është: Rrjeti i NGJV përbëhet nga 44 punonjës të cilët përveç kësaj kryejnë funksionet e koordinatorit lokal kundër DV (d.m.th. 17 bashki të tjera duhet të plotësojnë këtë pozicion); ndërkohë, mbetet të shihet nëse funksionet e personave të deklaruar si NGJV janë në përputhje me ligjin për barazinë gjinore.
- Rregullorja e fundit është urdhri i Kryeministrit nr. 239, datë 13.12.2017 “Për krijimin e Këshillit Kombëtar për Barazinë Gjinore (KKBGj)⁷⁸. Ky vendim themelon KKBGj me pjesëmarrjen e 10 zëvendësministrave nga secila ministri dhe 3 përfaqësuesve të Shoqërisë Civile të Shqipërisë. Pika 6 e vendimit urdhëron Këshillin Kombëtar për Barazinë Gjinore të veprojë në përputhje me nenet 11 dhe 12 të LGE.

Legjislacioni ku zbatohet neni 15 i Ligjit për Barazinë Gjinore

*Kodi Zgjedhor*⁷⁹ - Kodi zgjedhor përmban disa dispozita që lidhen me barazinë gjinore. Ndryshimet më thelbësore në Kodin Zgjedhor ndodhën në vitin 2008, duke bërë të mundur zbatimin për herë të parë të kuotës gjinore prej 30% në zgjedhjet parlamentare të 2009 dhe 2013, dhe më pas në prag të zgjedhjeve të 2015, duke bërë të mundur aplikimin të kuotës gjinore 50% për kandidatët pjesëmarrës në zgjedhjet e qeverisjes vendore 2015.

Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, miratuar me Ligjin Nr. 10019, datë 29.12.2008, ndryshuar me Ligjin Nr. 74/2012, datë 19.07.2012 dhe Ligjin Nr. 31/2015, datë 02.04.2015 përfshin kuotat gjinore për herë të parë, të cilat synonin dhe sollën një nivel të përmirësuar të përfaqësimit të grave në parlament. Nga këndvështrimi gjinor, ky Kod përfaqëson një moment të rëndësishëm në përpjekjen e

⁷⁷ Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Plani i Veprimit 2016 – 2020.

⁷⁸ Vendimi është marrë në përputhje me nenin 102, pika 3 të Kushtetutës dhe pikën 1 të nenit 11 të LGE, nenin 10 pika 1 të Konventës së Stambollit.

⁷⁹ Republika e Shqipërisë. Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë. Miratuar nga Ligji nr.10019, datë 29.12.2008, miratuar me ligj nr.74 / 2012, datë 19.07.2012 dhe ligj nr. 31/2015, datë 02.04.2015. Marrë nga <http://cec.org.al/wp-content/uploads/2017/06/KODI-ZGJEDHOR-2015-Teksti.pdf>

Shqipërisë për të përparuar me çështjet e barazisë gjinore në përfaqësimin politik, edhe pse shumë çështje mbeten për t'u trajtuar në terma praktikë, duke kërkuar ndryshime të mëtejshme të Kodit. Neni 67, pikat 6 dhe 7 të Kodit Zgjedhor për listën e kandidatëve të partive dhe koalicioneve partiake parashikojnë, ndër të tjera, që për secilën zonë zgjedhore, të paktën tridhjetë për qind të listës shumë-emërore dhe një nga tre emrat e parë në lista shume-emërore t'i përkiste secilës gjini. Neni 175 i Kodit Zgjedhor për sanksionet në lidhje me barazinë gjinore është ndryshuar disa herë, duke arritur disa ndryshime me Ligjin Nr. 74/2012, datë 19.07.2012 dhe Ligjin Nr. 31/2015.

Kodi zgjedhor i Republikës së Shqipërisë pësoi ndryshime të reja në vitin 2020 me Ligjin Nr.

101/2020. Kodi Zgjedhor i cili hyri në fuqi në muajin tetor 2020, parashikon në nenin 67, pika 6 që "Për çdo zonë zgjedhore në zgjedhjet për Kuvendin jo më pak se një në çdo tre emra të listës shumë emërore duhet t'i përkasë gjinisë së nënpërfaqësuar, kurse në zgjedhjet për këshillat bashkiakë një në çdo dy emra të njëpasnjëshëm në renditje duhet t'i përkasë së njëjtës gjini." Ky nen fuqizohet edhe më shumë me sanksionet e parashikuara në nenin 175 të këtij Kodi, në lidhje me barazinë gjinore. Në nenin 175 parashikohet që "mospërmbushja nga subjekti zgjedhor i detyrimit të parashikuar në pikën 6 të nenit 67 të këtij ligji sjell refuzimin e listës shumë-emërore për tu regjistruar në KQZ ose sipas rastit për zgjedhjet vendore në KZAZ."⁸⁰

*Ligji për vetë qeverisjen Vendore*⁸¹ - ligji shpjegon parimet e të drejtave të njeriut dhe pjesëmarrjen gjithëpërfshirëse në vendimmarrjen lokale duke iu referuar legjislacionit në fuqi. Neni 9 mbi të drejtat dhe përgjegjësitë e një njësie të vetëqeverisjes lokale përmend, ndër të tjera, të drejtën për të "krijuar komitete, borde ose komisione për të ushtruar funksione të veçanta sa herë që ka nevojë dhe duke respektuar ligjin për barazinë gjinore". Megjithëse është e paqartë se cilit nen apo ligj i referohen funksionet speciale, pasi ato nuk përcaktohen ose përshkruhen më tej.

Një aspekt i rëndësishëm gjinor gjendet në matjen e performancës së shërbimeve publike. Për shembull, neni 33 përcakton që një strukturë e veçantë mund të krijohet për të paraqitur dhe monitoruar performancën e shërbimeve publike, përfshirë aspektet gjinore.

Për më tepër, në detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak të parashikojë që në përputhje me LBGJ-në, të emërojnë ose shkarkojë kryetarin e këshillit bashkiak, por nuk ka një fjali detyruese për zbatimin e ligjit për barazinë gjinore që kërkon përfaqësim të barabartë gjinor në të gjitha nivelet e qeverisjes. E njëjta dispozitë zbatohet për nënkryetarët e bashkive dhe drejtuesit e njësive administrative.

Vlerësimi dhe monitorimi i legjislacionit për barazinë gjinore

Shqipëria nuk zbaton një politikë të veçantë për kontrollin post-legjislativ. Sidoqoftë, ka disa dispozita të shpërndara në dokumente të ndryshme dhe përgjegjësi institucionale për domosdoshmërinë e vlerësimit dhe monitorimit të zbatimit të ligjit dhe efektivitetin e tij. Një nga nënproduktet më të rëndësishme të LBGJ-së ka qenë zhvillimi i strategjive kombëtare për barazinë gjinore. Deri më tani Shqipëria ka zbatuar katër të tilla (që nga viti 2007). Pas çdo strategjie është bërë një vlerësim për të përmbledhur arritjet dhe sfidat.

Në përputhje me LBGJ-në dhe Urdhrin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta Nr. 2498, datë 16.12.2008, i ndryshuar, me Urdhrin Nr. 2271, datë 08.12.2009, u krijua një Grup Punë Ndërinstitucional (GPN) ngritur si një grup këshillimor për të identifikuar dhe përcaktuar statistikën gjinore në mbështetje të politikave të monitorimit për barazinë gjinore në Shqipëri. Grupi ndërinstitucional hartoi një grupim treguesish jjinor, të nevojshëm për monitorimin e barazisë gjinore dhe dhunës ndaj grave. Kjo u pasua nga një udhëzim, Nr. 1220, datë 27.5.2010 "Për përcaktimin e

⁸⁰ Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë. Neni 67*Ndryshuar me ligj. Nr. 74 dt. 19.7.2012, ligjin 31/2015, Ndryshuar me ligjin nr. 101/2020

ndryshuar me

⁸¹ Republika e Shqipërisë. Ligji 139/2015 "për vetëqeverisjen vendore". Nxjerrë nga për disa shtesa e ndryshime në ligjin http://www.erru.al/doc/Ligj_nr.139-2015_date_17.12.2015_Per_vetqeverisjen_vendore.pdf_dhe_ligji_nr.38/2019, for some changes in laë no. 139/2015, Retrieved from <http://ëëë.parlament.al/Files/ProjektLigje/20190627102204ligji%20nr.%2038,%20dt.%2020.6.2019.pdf>

treguesve të vlerësimit dhe monitorimit të barazisë gjinore dhe dhunës ndaj grave, përfshirë dhunën në familje, grumbullimin dhe përpunimin e tyre". Monitorimi konsiston gjithashtu në analizën e ndikimit të legjislacionit për barazinë gjinore dhe të legjislacionit mbi diskriminimin, të mospërputhjeve të identifikuar dhe mënyrës se si janë trajtuar. Kjo bëhet me qëllim që të sigurohet se zbatimi i këtij legjislacioni çon në eliminimin e diskriminimit ndaj grave.⁸²

Vlerësimi i SKBGJ-së së parë (2007-2010), me të drejtë identifikoi si një nga sfidat kryesore forcimin e mekanizmave institucionalë dhe ligjorë. Siç identifikon SKBG 2011-2015 për periudhën e mëparshme (2007-2011) "në aspektin ligjor, sfida mbetet harmonizimi i vazhdueshëm i legjislacionit me standardet ndërkombëtare dhe përmirësimi dhe monitorimi i zbatimit të legjislacionit aktual mbi barazinë gjinore në Shqipëri përmes strukturave përgjegjëse për mbikëqyrjen e saj si dhe krijimin e një njësie të specializuar për të monitoruar progresin e strategjisë."⁸³

Prandaj, edhe pse ekzistojnë disa forma monitorimi dhe analiza të ndikimit të legjislacionit në barazinë gjinore, mbetet e domosdoshme të vendoset monitorimi dhe vlerësimi i rregullt, buxhetimi dhe burimet e mjaftueshme për ta bërë këtë një praktikë të rregullt dhe për të përfshirë edhe procedura të kontrollit post legjislativ.

Në vitin 2014 u përgatitën dy raporte kombëtare 4-vjeçare, së bashku me disa raporte të tjera vlerësimi që trajtonin çështjet e barazisë gjinore, si dhe situatën në lidhje me dhunën me bazë gjinore dhe dhunën në familje. Këto raporte së bashku me një raport vlerësimi të SKBGJ 2011-2015 shërbyen si informacion për zhvillimin e SKBGJ-së së tretë (2016-2020).

Ndryshe nga vlerësimi i SKBGJ 2011-2015 nuk ka asnjë analizë të sfidave me të cilat përballet në lidhje me vlerësimin e zbatimit të legjislacionit për barazinë gjinore.

Objektivat e përmbushura të LBGj

LBGj-ja në mënyrë të qartë synon të rrisë pjesëmarrjen e grave në jetën publike, veçanërisht përfaqësimin e tyre në sferën politike dhe administratën publike. Një përmbledhje e zhvillimeve të barazisë gjinore dhe progresit në Shqipëri që nga viti 2008 kur ligji hyri në fuqi tregon se LBGj ka qenë efektive në dy fusha që lidhen me nenet e parashikuara në ligj:

- 1) Përfaqësimi i barabartë në vendimmarrje përmes kuotave gjinore;
- 2) Zhvillimi i statistikave gjinore dhe të dhëna të ndara sipas gjinisë.

Kuotat gjinore

Duke marrë parasysh sesi u zbatua ligji pas miratimit të tij, mund të arrihet në përfundimin se ai ka arritur në një farë mase përfshirjen e kuotave gjinore për përfaqësimin e grave në politikë dhe vendimmarrje. Ekziston një mendim i përgjithshëm se LBGj u krijua për të institucionalizuar kuotat gjinore në politikë, sepse përfaqësimi politik i grave dhe vajzave ka qenë në vëmendjen e aktivistëve për të drejtat e grave, ndërkombëtarëve dhe partive politike. Por nenet e tjera shumë të rëndësishme të ligjit nuk janë detajuar dhe veshur me të njëjtin angazhim si kuotat gjinore.

Trendi rritës i pjesëmarrjes së grave në vendimmarrje pa dyshim i atribuohet kryesisht kuotave gjinore të vendosura në Kodin Zgjedhor nga LBGj-ja. Në pjesën III - përfaqësimi i barabartë gjinor në procesin e vendimmarrjes dhe pikërisht neni 15 i LBGj-së parashikonte pjesëmarrjen në procesin e vendimmarrjes, si më poshtë:

Neni 15 - Pjesëmarrja në procesin e vendimmarrjes

1. Përfaqësimi i barabartë gjinor në të gjitha organet e pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor dhe në institucionet e tjera publike arrihet kur:

⁸² Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2011-2015. Online:

https://ëëë.legislationline.org/download/id/6709/file/Albania_National_strategy_gender_equality_gender_based_violence_2011-2015_eng.pdf

⁸³ Ibid. faqe 14.

- a. sigurohet përfaqësim në masën mbi 30 për qind për secilën gjini, përfshirë edhe në organet e tyre drejtuese;
 - b. sigurohet respektimi në mënyrë të njëjtë për secilën gjini i procedurave dhe kritereve të konkurrencës, gjatë emërimit në këto organe;
 - c. sigurohet përfshirja mbi 30 për qind e secilës gjini në listën e kandidatëve për zgjedhjet në organet përfaqësuese vendore;
 - d. sigurohet përfshirja jo më pak se 30 për qind e secilës gjini në listën e kandidatëve të paraqitur nga partitë politike për sistemin proporcional për zgjedhjet e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë;
 - e. sigurohet përfshirja mbi 30 për qind të secilës gjini në organet administruese të procesit të zgjedhjeve qendrore dhe vendore.
2. Partitë politike përcaktojnë mënyrat dhe masat për të përmbushur kërkesat e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni.
 3. Partitë politike paguajnë një gjobë deri në një të dhjetën e fondit shtetëror për financimin e fushatës zgjedhore, nëse shkelin dispozitat e këtij neni, deri në ndreqjen e shkeljes.

LBGj-ja prezantoi kuotën për pjesëmarrjen e grave në politikë dhe vendimmarrje në nivelin 30% dhe më shumë. Në muajin nëntor 2008, sistemi zgjedhor i Shqipërisë u reformua, duke futur sistemin e përfaqësimit proporcional të listave. Sipas sistemit të ri, të 140 anëtarët e parlamentit zgjidhen përmes një sistemi përfaqësimi proporcional në 12 zona elektorale që korrespondojnë me 12 rajonet administrative.⁸⁴ Kodi Zgjedhor i ndryshuar në vitin 2009 përcaktoi kuotat gjinore për listat e kandidatëve dhe anëtarësimin në Komisionet e Zonave Administrative Zgjedhore (KZAZ) për herë të parë. Kuotat e reja gjinore rritën përfaqësimin e grave në parlament, por dobësitë në formulimin e dispozitave ligjore dëmtojnë objektivin e tyre.⁸⁵ Sipas raportit të OSBE/ODIHR kjo ka ndodhur për dy arsye; 1) Listat e kandidatëve të partive politike përfshinin 30 për qind të grave pothuajse të gjitha të renditura në fund të listave dhe në pozicione ndoshta të padëshirueshme; 2) Ligji nuk parashikonte një tavan për numrin e kandidatëve që mund të paraqiten në një listë krahasuar me numrin e përgjithshëm të vendeve në një zonë elektorale. Në disa raste, partitë listat e të cilave nuk plotësonin kërkesat gjinore, thjesht shtuan gratë në pozicione që tejkalonin numrin e mandateve. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) vendosi që listat e tilla plotësonin kërkesat gjinore, përkundër faktit se asnjë nga gratë e shtuara nuk mund të zgjidhej.⁸⁶ Raporti i OSBE / ODIHR rekomandoi që dispozitat e Kodit Zgjedhor që përcaktojnë kuotat gjinore për listat e kandidatëve, të rishikohen në mënyrë që të përmbushin standardin 30 për qind të kërkuar sipas LBGj-së dhe për të eliminuar hendeqet që lejojnë partitë të mos respektojnë qëllimin e ligjit.⁸⁷

Para zgjedhjeve lokale të vitit 2011, Kodi Zgjedhor u rishikua dhe parashikoi që gjinia e kandidatëve duhet të alternohet në çdo tre emra në një listë të kandidatëve për zgjedhjet lokale. Palët që nuk i përmbahen këtij rregulli duhet të paguajnë një gjobë, megjithëse lista është e regjistruar. Meqenëse gjoba është e ulët (30,000 lekë ose afërsisht 213 EUR), kjo kërkesë shpesh nuk respektohet.⁸⁸ Sipas KQZ-së, rreth 30 për qind e kandidatëve për zgjedhjet e këshillit ishin gra, por kishte vetëm 14 gra midis 872 kandidatëve për kryetar bashkie (1,6 për qind). U zgjodhën gjashtë nga gratë kandidate për kryetare bashkie.

Gjatë zgjedhjeve parlamentare në vitin 2013, kërkesa për kuotën gjinore për listat e kandidatëve nuk u plotësua nga PD, PS dhe Lëvizja Socialiste për Integritet (LSI) në një numër zonash elektorale, gjë që rezultoi në gjobë, megjithëse ishin regjistruar listat që ishin në mospërputhje. Megjithëse partitë politike plotësuan kërkesën e tyre ligjore për të emëruar të paktën 30 për qind të secilës gjini në anëtarësimin

⁸⁴ <https://www.idea.int/data-tools/data/gender-quotas/country-vieë/47/35>

⁸⁵ OSCE/ODIHR. (2009). Republika e Shqipërisë, Raporti Përfundimtar i Misionit të Vëzhgimit të Zgjedhjeve, Zgjedhjet Parlamentare, 28 June 2009,

P. 31. Marrë nga <https://www.osce.org/files/f/documents/9/8/38597.pdf>

⁸⁶ Ibid.

⁸⁷ Ibid.

⁸⁸ OSCE/ODIHR. (2011). Republika e Shqipërisë, Raporti Përfundimtar i Misionit të Vëzhgimit të Zgjedhjeve, Zgjedhjet Parlamentare, 8 maj 2011, P.20

e përgjithshëm të KZAZ-ve, përfaqësimi i grave në Komisionet e Qendrave të Votimit u konstatua nga vëzhguesit në ditën e zgjedhjeve me 14 për qind.⁸⁹ Disa ndryshime në Kodin Zgjedhor dobësuan kornizën ligjore, duke përfshirë mekanizmat më pak të rrepta të zbatimit për mosrespektimin e kuotave gjinore për listat e kandidatëve dhe një dispozitë më të butë mbi përfshirjen e nëpunësve publikë në fushata.⁹⁰

Ndryshimet e mëvonshme në muajin prill 2015 reflektojnë ndarjen e re administrative territoriale dhe trajtuan një rekomandim të kahershëm të OSBE / ODIHR për të promovuar gratë kandidatë duke rritur kuotën gjinore në listat e kandidatëve për këshillat lokale në 50 për qind, me gjininë që alternon çdo emër të dytë. Për më tepër, nëse paraqitet një vend i lirë pune në një këshill, zëvendësuesi duhet të jetë kandidati i radhës në listën e së njëjtës gjini. Të gjitha partitë plotësuan kërkesën e kuotës së re gjinore, dhe zgjedhjet rezultuan në 49.4 për qind të kandidatëve të këshillit bashkiak të ishin gra.⁹¹

Gjatë Zgjedhjeve Parlamentare në vitin 2017, Kodi Zgjedhor kërkoi që një kuotë gjinore të zbatohet për secilën listë të kandidatëve si një mjet për të korrigjuar nënpërfaqësimin politik të grave. Ai parashikon të paktën një grua dhe një burrë midis tre pozicioneve të para dhe të paktën 30 për qind të kandidatëve të secilës gjini në secilën listë. KQZ vendosi sanksione prej 1 milion lekësh kundër LSI dhe PS për mosrespektimin e kuotës gjinore përkatësisht në rrethet e Tiranës dhe Beratit. Sidoqoftë, KQZ-ja nuk e sanksionoi PD-në për mosrespektimin e kuotës në të 12 qarqet e vendit, duke rrezikuar vlerën e masës për të promovuar gratë kandidatë dhe domosdoshmërinë që partitë të konkurrojnë në një bazë të barabartë, në kundërshtim me angazhimet e OSBE.⁹² Ligji nuk lejon të mosregjistrohet një palë nëse kuota nuk respektohet. Sidoqoftë, partitë më të mëdha politike nuk e respektuan gjithmonë kuotën gjinore në listat e tyre të kandidatëve dhe gratë kandidatë morën pak vëmendje nga media. Ndërsa rreth 40 për qind e kandidatëve ishin gra, ato morën vetëm 26 për qind të vendeve në parlamentin e ri. Gratë gjithashtu ishin të nënpërfaqësuar në administratën zgjedhore, përfshirë pozicionet vendimmarrëse. Gjatë Zgjedhjeve Lokale të vitit 2019, sistemi i kuotave për regjistrimin e kandidatëve ka krijuar një mjedis të favorshëm për të shtuar pjesëmarrjen e grave në jetën politike. Vetëm ato lista të kandidatëve për këshilltarë që përfshinin 50 për qind të secilës gjini u regjistruan, duke rezultuar në 44 për qind të vendeve të këshilltarëve lokalë të fituar nga gratë në këto zgjedhje. Njëmbëdhjetë gra garuan për kryetare bashkie dhe tetë (13 për qind) u bënë kryetare bashkie. Sidoqoftë, pak gra mbajnë role drejtuese brenda partive politike.⁹³ Dy në pesë anëtarë të KQZ-së dhe 37 për qind e anëtarëve të KZAZ-ve ishin gra. Mosrespektimi i kuotës gjinore rezultoi në refuzimin e dy listave të kandidatëve.⁹⁴

Siç është e qartë, zbatimi i nenit 15 që lidhet me kuotën gjinore nuk u mor seriozisht në fillim nga partitë politike dhe nuk u respektua. Raportet dhe rekomandimet e komisionit të Venecias dhe OSBE / ODIHR krijuan mundësi për rishikimin e kuotave dhe forcimin e ligjit duke tërhequr kështu edhe vëmendjen e veçantë nga politika.

Në nenin 15, pikat a dhe b përcaktohet kërkesa prej 30% dhe më shumë e kuotës **për përfaqësimin e grave në organet drejtuese**. Ekzistojnë shumë pak raportime dhe dëshmi për përfaqësimin e barabartë të të dy gjinive në organet drejtuese brenda autoriteteve publike dhe se si janë procedurat e konkurrencës në raport me dispozitat e LBGj-së. Një studim i kryer në vitin 2016 informoi se ka një mungesë totale informacioni në lidhje me nivelin e pjesëmarrjes së grave në borde dhe në nivelet e larta të menaxhimit të biznesit në Shqipëri. Sipas këtij studimi të kryer në vitin 2016, 27% e anëtarëve të

⁸⁹

⁹⁰ OSCE/ODIHR. (2013). Republika e Shqipërisë, Raporti Përfundimtar i Misionit të Vëzhgimit të Zgjedhjeve, Zgjedhjet Parlamentare, 23 qershor 2013

⁹¹ OSCE/ODIHR. (2015). Republika e Shqipërisë, Raporti Përfundimtar i Misionit të Vëzhgimit të Zgjedhjeve, Zgjedhjet Parlamentare, 21 qershor 2015

⁹² OSCE/ODIHR. (2017). Republika e Shqipërisë, Raporti Përfundimtar i Misionit të Vëzhgimit të Zgjedhjeve, Zgjedhjet Parlamentare, 25 qershor 2017


⁹³ OSCE/ODIHR. (2019). Republika e Shqipërisë, Raporti Përfundimtar i Misionit të Vëzhgimit të Zgjedhjeve, Zgjedhjet, 30 qershor 2019

⁹⁴ Ibid.

bordit ishin gra ndërsa 43% e bordeve të rrethit nuk kishin asnjë anëtare femër.⁹⁵ Rreth 32% e bizneseve (kompani private) kishin një grua në pozicionin e drejtorit ekzekutiv / administratorit, 40% e pozicioneve të larta në kompani u janë caktuar grave.⁹⁶ Për më tepër, i njëjti studim zbuloi se ka 125 ndërmarrje shtetërore nën administrimin e institucioneve të qeverisë qendrore ku rreth një e treta e anëtarëve të bordit janë gra, ndërsa gratë në pozicione drejtuesesh ekzekutive janë rreth 13%. Situata duket problematike në ndërmarrjet nën administrimin e bashkive ku vetëm 18% e anëtarëve të bordit janë gra dhe vetëm 4% e drejtoresh ekzekutive/ administratore janë gra. Situata duket edhe më problematike duke përmendur se në 42 kompani në nivelin lokal nga 76, nuk ka grua në bord. Në përgjithësi, 26% e kompanive kanë vetëm një grua si anëtare të bordit.⁹⁷

Publikimi vjetor i INSTAT, "Burrat dhe gratë në shifra" ka zhvilluar disa të dhëna në lidhje me përfaqësimin e grave në borde si në tabelën më poshtë. **Si përfundim i kësaj pjese është e qartë që neni 15 u mor seriozisht dhe u bënë përpjekje për zbatimin e tij. Sidoqoftë, nuk ka qenë i suksesshëm në rritjen e pjesëmarrjes së grave në të gjitha sferat.**

Figura 1. Përqindja e përfaqësimit të grave në parlament



Për sa i përket ndikimit, zbatimi i ligjit për barazinë gjinore ka çuar në përmirësimin e bilancit gjinor në të gjitha nivelet e barazisë gjinore, veçanërisht në parlament. Kjo është gjithashtu e qartë nga përqindja në statistikat e pjesëmarrjes në disa legjislatura siç tregon tabela më sipër. Ekziston një ndryshim i qartë nga para vitit 2008 (kur u miratua ligji për barazinë gjinore dhe përfshiu kuotat gjinore, të cilave ligji i mëparshëm i mungonte). Mund të shihet se në periudhën para vitit 2008 përqindja e grave në parlament qëndronte kryesisht nën 10%. Futja e kuotës gjinore çoi në një rritje të konsiderueshme për të arritur nivelin më të lartë në legjislaturën e fundit. Prandaj, kuota gjinore ka shërbyer si një mekanizëm që jo vetëm rrit përgjegjësinë e partive politike për të përfshirë më shumë gra, por gjithashtu siguron hapësirën për zbatimin e kornizës ligjore për barazinë gjinore.⁹⁸

Ndërsa ligji ka kontribuar në përfaqësimin sasior të grave në politikën dhe strukturat vendimmarrëse është e rëndësishme të theksohet se duhet bërë më shumë për të siguruar pjesëmarrjen e tyre kuptimplote dhe ndikimin në jetën e zgjedhësve të tyre. Hulumtimet e mëparshme kanë treguar se përqindja e grave këshilltare në nivelin lokal nuk ka një efekt pozitiv në kuptimin e kompetencave në vendimmarrje.⁹⁹ Nje raport i UNDP arrin në përfundimin se “gratë këshilltare përballen me pengesa të shumta strukturore në fuqinë e tyre vendimmarrëse. Këto pengesa lidhen me kompetenca të dobëta të

⁹⁵ HDPC 2016. Gratë në bord dhe pozicione të lartë në shoqëritë shqiptare

⁹⁶ Ibid.

⁹⁷ Ibid.

⁹⁸ https://papers.ssrn.com/sol3/papers.cfm?abstract_id=3303499

⁹⁹ Dauti M. and Cepani E. (2015). Forcimi i pushtetit vendimmarrës të grave në Shqipëri, UNDP, Retrieved from, <https://www.al.undp.org/content/albania/en/home/library/poverty/study-strengthening-the-decision-making-power-of-council-Women-in.html>

këshillave vendorë, kapacitetet e dobëta fiskale të qeverive lokale, procesin përmes të cilit drejtuesit e partive zgjedhin gratë dhe kufizimet që drejtuesit e partive vendosin për vendimmarrësit lokalë. Nëse këto pengesa strukturore nuk adresohen, do të ketë pak ndryshim në fuqinë vendimmarrëse të grave këshilltare.”¹⁰⁰ Raporti gjithashtu tregoi se gratë veprojnë njëzëri kur janë në një numër më të madh, prandaj përpjekjet e tyre bashkëpunuese tejkalojnë linjat e partisë. Kjo do të thotë që sfidat po zhvendosen nga përpjekjet që lidhen me shkallën së vogël bashkëpunuese në nisma të mirëorganizuara që mund të mbështeten me kalimin e kohës.¹⁰¹

Në përgjithësi, një nga arritjet kryesore jo vetëm të Ligjit për Barazinë Gjinore, por në përgjithësi, agjenda e barazisë gjinore në Shqipëri ka të bëjë me përfaqësimin politik të grave. **Futja e kuotës gjinore në LBGj ishte nxitja e nevojshme për të rritur ndjeshëm përfaqësimin e grave në proceset politike. Numri i madh i grave që kanë përfitur nga kjo politikë siç përcaktohet në LBGj është një nga arritjet kryesore të ligjit.** Edhe pse kuota gjinore nuk është shteruar dhe duhet bërë më shumë për të siguruar që gratë të kenë një shans për të hyrë në politikë dhe vendimmarrje, nevojiten më shumë përpjekje për të siguruar që zëri i tyre të forcohet dhe ndikimi i tyre në vendimmarrje të jetë i qartë.

Të dhëna të zbërthyera sipas seksit

Neni 13 / d i LBGj-së përcakton që ministri i ngarkuar, aktualisht Ministri i MShMS-së, përcakton mekanizmat për mbledhjen e statistikave të ndara gjinore në bashkëpunim me Institutin e Statistikave dhe institucione të tjera shtetërore si dhe mbikëqyr mbledhjen dhe përpunimin e tyre; Për më tepër, sipas pikës d të nenit 13, ministri duhet të organizojë mbledhjen, analizimin dhe shpërndarjen e informacionit mbi çështjet gjinore. Ky kusht formon gjithashtu bazën për akte të tjera nënligjore të miratuara më vonë në lidhje me mbledhjen e të dhënave dhe treguesit. Për më tepër, neni 14/3 përcakton që organet e qeverisjes vendore kryejnë mbledhjen dhe përpunimin e statistikave lokale të ndara sipas gjinive.

Shqipëria ka bërë një progres të rëndësishëm në fushën e mbledhjes së të dhënave. Për 7 vjet rresht Instituti i Statistikave ka mbledhur dhe publikuar të dhëna të ndara gjinore. Duke filluar nga viti 2017, ky institucion mbledhi grupin më të plotë të të dhënave (që përfshin 34 tregues të lidhur me gjininë).¹⁰² Botimi Burrat dhe Gratë në Shqipëri ofron të dhëna në fushat e mëposhtme:

- Popullsia
- Shëndeti
- Punësimi dhe mbrojtja sociale
- Edukimi
- Statistikat gjyqësore
- Pjesëmarrja në vendimmarrje

Baza ligjore për mbledhjen e statistikave gjinore është LBGj. Në fakt, ligji që rregullon punën e Institutit të Statistikave nuk i referohet specifikisht të dhënave të ndara gjinore. Sidoqoftë, ky institut edhe me ndihmën e donatorëve sic është Sida apo UN Women kanë zhvilluar një modul të pavarur mbi statistikave gjinore. Megjithatë, LBGj nuk parashikon asnjë gjobë ose masë tjetër në ligj nëse institucionet nuk grumbullojnë statistika gjinore.

Në vitin 2020, qeveria shqiptare publikoi për herë të parë Indeksin e Barazisë Gjinore, i cili nuk përmban vetëm të dhëna të ndara sipas gjinisë, por gjithashtu kryen një analizë të thellë të situatës së barazisë gjinore në fushën e punës, parave, njohurive, kohës, fuqisë dhe shëndetit. Indeksi i Barazisë Gjinore fillimisht u prezantua nga Instituti Evropian për Barazi Gjinore (EIGE) me qëllim që të mbështesë politikëbërjen më të efektshme në këtë fushë. Nga viti 2019, indeksi kryesor i barazisë gjinore do të azhurnohet çdo vit me një fokus më të thellë në një nga fushat që do të përzgjidhen çdo vit. Indeksi vjen në kohën e duhur ndërsa Strategjia e re e Barazisë Gjinore është duke u hartuar, e ndërkohë duke u

¹⁰⁰ UNDP. 2015. Study: Forcimi i pushtetit vendimmarrës të grave në Shqipëria. Online: <https://www.al.undp.org/content/albania/en/home/library/poverty/study-strengthening-the-decision-making-power-of-councilWomen-in.html>

¹⁰¹ Ibid.

¹⁰² <https://eca.unWomen.org/en/neës/stories/2017/06/albania-publishes-the-largest-range-of-gender-statistics-to-date>

vlerësuar ajo e mëparshmeja. Ndaj ky është një moment kyç dhe një mundësi për të përforcuar me ligje mbledhjen e të dhënave gjinore që analiza e tyre të sjellë politika që janë diktuar nga evidencat. Prandaj, megjithëse nevojiten përmirësime në mbledhjen e të dhënave dhe përdorimin e tyre për hartimin e politikave, vlen të përmendet se LBGj-ja ka pasur një ndikim pozitiv në mbledhjen dhe shpërndarjen rregullisht të statistikave në lidhje me barazinë gjinore dhe / ose të dhëna të ndara sipas gjinisë. Këto të dhëna kanë shërbyer për të analizuar trendet e dhunës ndaj grave, përmbushjen e kuotës gjinore, përfaqësimin e grave në politikë dhe institucione të tjera vendimmarrëse, pjesëmarrjen e grave në vendimmarrje dhe tregues të tjerë.

Gjetje lidhur me shqetësimet e ngritura nga aktorë të ndryshëm gjatë konkluzimeve për të kryer kontrollin post-legjislativ

Gjatë procesit të kontrollit post-legjislativ të LBGj-së, u intervistuan aktorë të rëndësishëm dhe u konsultuan një sërë dokumentesh. Gjatë shqyrtimit të dokumenteve, raporteve dhe hulumtimeve të hartuara nga OSHC-të shqiptare, organizatat ndërkombëtare dhe nga ekspertë të ndryshëm të pavarur u vu re se në dokumente të ndryshme flitet për shkallën e ulët të zbatimit të Ligjit për Barazinë Gjinore, megjithatë nuk u ndërmor asnjë veprim për përmirësimin e pjesëve të këtij ligji siç ka ndodhur për shembull me Ligjin për masat kundër dhunës në familje, i cili ka pësuar ndryshime të ndryshme që nga miratimi i tij.

LBGj-ja shënoi progres në përpjekjet e Shqipërisë për të sjellë barazi gjinore në shoqëri, por nuk arriti potencialin e tij të plotë dhe ka mbetur kryesisht i papërdorur në vitet e fundit. Për shembull neni 15 në pjesën e III të ligjit ka përmbushur pjesërisht pikën 15.c (pasi nuk është shtrirë në zgjedhjet për kryetarë bashkie) si dhe është përmbushur pjesërisht 15.ç që ka diktuar ndryshimet në Kodin Zgjedhor. Për shkak të zbatimit të këtij të fundit, tani kemi më shumë gra në Parlamentin Shqiptar dhe në këshillat bashkiakë në nivel bashkie.

Neni 11 – Gjithashtu është mundësuar krijimi i Këshillit Kombëtar për Barazinë Gjinore dhe është kryer emërimi i punonjësve të barazisë gjinore në ministri dhe nivel bashkie. Megjithatë, të dyja rjetet, si ai i nëpunësve gjinore në nivel ministrie edhe ai në nivel bashkie janë të dobëta, pasi punonjësi mbingarkohet me detyra të tjera që nuk lidhen me barazinë gjinore dhe nuk janë as të trajnuar dhe as të fuqizuar sa duhet. Arritja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i grave në Shqipëri kërkon vëmendje të përkushtuar dhe të qëndrueshme kombëtare dhe ndërkombëtare.

Shqetësimet e ngritura në bazë të disa neneve të LBGj-së

Neni 13 / d mbi të dhënat e ndara sipas gjinisë - Mbledhja e të dhënave të ndara sipas gjinisë është e detyrueshme në Shqipëri që nga viti 2008 nga Ligji për Barazi Gjinore. Megjithatë, përdorimi aktual i të dhënave të ndara sipas gjinisë dhe statistikave gjinore për zhvillimin e politikave, buxhetimin dhe monitorimin e përparësive të zhvillimit kombëtar është ende tepër i pakënaqshëm.¹⁰³ Programi aktual Kombëtar Statistikor (2015-2020) nuk përfshin mbledhjen e të dhënave rutinë në një mënyrë të ndarë sipas gjinisë, duke paraqitur një sfidë për monitorimin në përputhje me standardet e BE-së dhe ato ndërkombëtare. Sistemi aktual statistikor karakterizohet nga një hendek i konsiderueshëm midis të dhënave dhe informacionit të mbledhur nga institucionet nga njëra anë, dhe treguesve të kërkuar në nivelin ndërkombëtar për monitorimin e barazisë gjinore nga ana tjetër. Të dhënat nuk janë të standardizuara dhe nuk janë mbledhur në mënyra rigoroze dhe të qëndrueshme, duke e bërë të vështirë monitorimin e të njëjtit tregues me kalimin e kohës.¹⁰⁴

Neni 14 - Përkushtuar në sigurimin e barazisë gjinore në nivelin lokal, siç është në përputhje me të gjitha paragrafët e këtij neni. Në vitin 2014 Shqipëria kaloi në procesin e ndarjes së re territoriale dhe administrative. U miratua një ligj i ri për Vetëqeverisjen Vendore” ("Ligji Organik"). Në përputhje me

¹⁰³ UN Women. (2016). *Gender Brief: Albania*. Online: <http://eca.unwomen.org/en/digital-library/publications/2016/10/albania-gender-brief>

¹⁰⁴ Ibid.

LBGj, nenet 54 dhe 64 të Ligjit Organik, përcaktojnë që të paktën 30 për qind e administratorëve të emëruar duhet të jenë gra.¹⁰⁵

Për më tepër, rritja e territorit në administrim (urban e rural), popullsia dhe përgjegjësitë e shtuara të bashkive duhet të përputhen me alokimet përkatëse buxhetore dhe personelin e aftë për menaxhimin dhe mbikëqyrjen e këtyre buxheteve dhe gjithashtu për të integruar angazhimet ndërkombëtare të Shqipërisë për barazinë gjinore (p.sh. për CEDAW, Platforma e Pekinit për Veprim, dhe *acquis* e BE-së për Barazi Gjinore) në detyrimet e qeverisjes vendore.¹⁰⁶ Përveç nevojës që ka LBGj-ja që të zbatohet në nivelin lokal me një angazhim të qartë nga NJQV-të. Këto të fundit duhet të përdorin pushtetin, kompetencat dhe partneritetet e tyre për të arritur barazi më të madhe për qytetarët e tyre në përputhje me Kartën Evropiane për Barazinë e Grave dhe Burrave në Jetën Lokale.¹⁰⁷ **Sipas intervistës me përfaqësuesit e Shoqatës së Bashkive Shqiptare dhe Shoqatës për Autonomi Lokale, neni 14 i LBGj nuk është në përputhje me zhvillimet e reja në Shqipëri dhe duhet të rishikohet.**¹⁰⁸ Gjithashtu, LBGj-ja nuk përfshin ndonjë dispozitë për buxhetimin e përgjegjshëm gjinor (BPGj) në nivelin lokal, megjithëse që nga viti 2012 Shqipëria ka përparuar në kornizën ligjore të BPGj dhe zhvillimin e politikave. Përveç kësaj, strukturat dhe mekanizmat specifikë duhet të operacionalizohen, të tilla si analiza e buxhetit të përgjegjshme ndaj gjinisë, vlerësimet gjinore dhe praktikatat e auditimit gjinor, për të siguruar që shërbimet trajtojnë interesat dhe nevojat e ndryshme të grave dhe burrave, dhe janë njësoj të arritshme për ta.¹⁰⁹ Për shumë vite, donatorët kanë financuar dhe mbështetur krijimin e njësisive të barazisë gjinore / dhunës në familje ose punonjësve, për të siguruar zbatimin e kornizës ligjore të barazisë gjinore në Shqipëri që adreson shqetësimet e barazisë gjinore në planifikimin vendor, megjithatë qëndrueshmëria e këtyre ndërhyrjeve mund të sigurohet duke integruar veprimet përkatëse brenda buxheteve lokale dhe Ligji për Barazinë Gjinore duhet të sigurojë këto dispozita.¹¹⁰

Neni 15 - Siç u përmend më lart ligji për Vetëqeverisjen Vendore ("Ligji Organik") në nenet 54 dhe 64 të Ligjit Organik, përcakton që të paktën 30 për qind e administratorëve të caktuar të jenë gra.¹¹¹ Megjithatë sipas studimit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹¹² vetëm 15 bashki nga 58 që iu përgjigjën sondazhit të kryer nga KMD-ja, kanë më shumë se 30% përfaqësim të grave në nivelin e nënkryetarit të bashkisë. Për më tepër, nga 53 bashki vetëm 8 prej tyre kanë 30% gra të emëruara si administratore. Në total, 27 nga 53 bashki nuk kanë gra në pozicionin e administratorit, megjithëse bashkia duhet të ketë të paktën 2 pozicione të tilla.¹¹³

Me këto zhvillime si më sipër LBGj-ja tregon se nuk ka mundur një autoritet që do të mbikëqyrë respektimin e detyrimit të vendosur nga neni 15, germa "a" e këtij ligji. Ndaj është e nevojshme të sigurohet një mekanizëm monitorimi dhe sanksionimi në lidhje me këtë dispozitë në mënyrë që të garantohet zbatimi efektiv i saj.¹¹⁴

Gjithashtu caktimi i një kuote prej 30% për këshillat bashkiakë në nenin 15 është tashmë më e ulët se parashikimi i Kodit Zgjedhor, i cili është rritur në 50% që nga viti 2015. Për më tepër, neni 15 i LBGj-së, vendos vetëm disa sanksione pagesash, ndërsa Kodi Zgjedhor vendos sanksione për refuzimin e listës e kandidatëve të partive politike nëse nuk është në përputhje me nenin 67 të Kodit Zgjedhor.¹¹⁵

¹⁰⁵ Vetëqeverisja vendore ("Ligji organik"). Nene 54 dhe 64.

¹⁰⁶ UN Women. (2016). *Gender Brief: Albania*. Online: <http://eca.unwomen.org/en/digital-library/publications/2016/10/albania-gender-brief>

¹⁰⁷ Council of European Municipalities (2006) European Charter for Equality of Women and Men in Local Life, Retrieved from: <http://ëëë.charter-equality.eu/the-charter/observatoire-europeen-en.html>.

¹⁰⁸ Intervistë me përfaqësuesit e Shoqatës së Bashkive Shqiptare dhe Shoqatës për Autonomi Lokale

¹⁰⁹ UN Women. (2016). *Gender Brief: Albania*. Online: <http://eca.unwomen.org/en/digital-library/publications/2016/10/albania-gender-brief>

¹¹⁰ UN Women. (2016). *Gender Brief: Albania*. Online: <http://eca.unwomen.org/en/digital-library/publications/2016/10/albania-gender-brief>

¹¹¹ Vetëqeverisja vendore ("Ligji organik"). Nene 54 dhe 64.

¹¹² Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi. 2019. Barazia Gjinore dhe Diskriminimi në Organet e Pushtetit Lokal. Retrieved from

¹¹³ Ibid

¹¹⁴ Ibid.

¹¹⁵ Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi. 2019. Barazia Gjinore dhe Diskriminimi në Organet e Pushtetit Lokal. Retrieved from <https://portavendore.al/ep-content/uploads/2019/06/Barazia-gjinore-dhe-diskriminimi-ne-organet-e-meruara-te-pushtetit-vendor.pdf>

Neni 16.7 - Siguron pagesa të barabarta për punë me vlerë të barabartë. Studimet mbi tregun e punës, pagat, pagat e jetesës, gjendjen e punës, shëndetin dhe punën e denjë në përgjithësi mezi gjenden në shoqërinë civile shqiptare, në qeveri ose nga akademikët.. Sipas Indeksit të Barazisë Gjinore¹¹⁶ hendeku gjinor i pagave është 10.7% në Shqipëri, siç llogaritet nga pagat e deklaruara në Drejtoritë Tatimore, të cilat si rezultat i informalitetit, shpesh nuk raportohen siç janë në realitet, veçanërisht pagat më të larta të cilat u përkasin burrave.¹¹⁷ Sipas një studimi të kryer në vitin 2012¹¹⁸, hendeku i gjinor i pagave në Shqipëri është llogaritur rreth 17.4% për qind. Kapërcimi i hendekut të pagave midis burrave dhe grave kërkon zbatimin instrumente ligjore dhe joligjore ekzistuese, si dhe krijimin e instrumenteve të reja.¹¹⁹ Faktorët që ndikojnë në hendekun gjinor të pagave janë të shumtë, siç janë shkalla e pjesëmarrjes së forcës së punës në tregun e punës, numri i grave që kanë punuar pa kontratë, pagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore. Hendeku gjinor në paga lidhet gjithashtu me nivelin e arsimit, ndërsa hendeku bëhet më i vogël me rritjen e nivelit të arsimit. Asnjë nga këta faktorë nuk është përpunuar më tej për të shërbyer si bazë informacioni për të diktuar politika ose masa që duhet të merret nga qeveria ose aktorë të tjerë në shoqërinë shqiptare.

Neni 18 – ngarkon me përgjegjësi punëdhënësin për mbrojtjen e punëmarrësit nga diskriminimi, ngacmimet dhe ngacmimet seksuale, megjithëse përputhen me Ligjin nr. 136/2015 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995" Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë "nuk ka asnjë provë për kontributin e këtij ligji për të inkurajuar viktimat dhe punëdhënësit të ngrihen dhe të marrin masa kundër kësaj dhune."¹²⁰

Neni 28 - parashikon Inspektoratin Shtetëror të Punës si përgjegjës për rastet e shkeljes së detyrimeve të përcaktuara në nenin 26 të ligjit. Neni 26 merret me çështjet e barazisë gjinore në media. Ky nen, në pikën e dytë, përcakton që transmetimi, shtypja dhe botimi i informacionit dhe materialit që përmban ose nënkupton ndryshime që janë poshtëruese ose përcmuese për shkak të gjinisë, ose që shfaqin qëndrime ekskluzive ose fyese ndaj secilit seks do të ndalohen. Sipas KMD-së, Inspektorati Shtetëror i Punës nuk mund të jetë më autoriteti përgjegjës në lidhje me detyrimet që rrjedhin nga neni 26 i LBGj-së¹²¹ Ky shembull tregon se, është e nevojshme një rishikim i plotë i autoriteteve përgjegjëse të cilat duhet të monitorojnë zbatimin e detyrimeve të parashikuara nga për të garantuar zbatueshmërinë e detyrimeve të këtij ligji.¹²²

Ligji për Barazinë Gjinore emëron ministrinë përgjegjëse për barazinë gjinore, aktualisht Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale si organ përgjegjës për koordinimin e zbatimit të ligjit në të gjitha nivelet. Analiza tregon se kjo barrë është vendosur kryesisht mbi një strukturë të vogël brenda ministrisë, e cila aktualisht nuk ka burime të mjaftueshme (financiare, njerëzore dhe teknike) për të kryer të gjitha përgjegjësitë e vendosura nga LBGj. Prandaj, për të sjellë ndryshimet e nevojshme në LBGj dhe zbatimin e tij është e nevojshme të angazhohen një numër palësh të interesuara, nga dega ekzekutive, legjislativi, organizatat e shoqërisë civile dhe grupet e interesit.

Përvoja të mëparshme, si ndryshimet në ligjin për masat kundër dhunës në marrëdhëniet familjare, theksojnë nevojën për një qasje gjithëpërfshirëse në procesin e hartimit të ligjit. Ekziston një ekspertizë dhe përvojë e rëndësishme për çështjet e barazisë gjinore në Shqipëri. Prandaj, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale mund të krijojë një task forcë të ngarkuar me rishikimin e Ligjit të Barazisë Gjinore në Shoqëri dhe futjen e tij për miratim në parlament. Kjo task forcë mund të ngarkohet me mbledhjen e kontributeve dhe rekomandimeve nga palët e interesuara joqeveritare, të tilla si organizata të shoqërisë civile, grupe të të drejtave të njeriut dhe organizata ndërkombëtare si dhe

¹¹⁶ INSTAT, MoHSP and EIGE. 2019. Gender Equality Index for the Republic of Albania, 2019.

http://www.instat.gov.al/media/6661/gender_equality_index_for_the_republic_of_albania_2020.pdf

¹¹⁷ Ibid.

¹¹⁸ GADC. 2012Pbarazi në paga – Rast në Shqipëri. Marrë nga https://www.gadc.org.al/media/files/upload/Gender_Inequalities_Pay.pdf

¹¹⁹ Ibid.

¹²⁰ MHSP and MEFA. (2019). *Analiza kombëtare për zbatimin e platformës së Pekinit për veprim - Pekin +25*.

¹²¹ Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi. 2019. Barazia Gjinore dhe Diskriminimi në Organet e Pushtetit Lokal. Marrë nga <https://portavendore.al/wp-content/uploads/2019/06/Barazia-gjinore-dhe-diskriminimi-ne-organet-e-meruara-te-pushtetit-vendor.pdf>

¹²² Ibid.

institucione të pavarura të të drejtave të njeriut siç janë Avokati i Popullit dhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Për ta bërë LBGj-në t'i shërbejë qëllimit, për t'iu përgjigjur nevojave aktuale dhe kontekstit, është thelbësore të sigurohet që ndryshimet të bazohen në të dhëna, prova dhe vlerësime të ndikimit të mundshëm. Kjo përfshin analizën e ndërveprimit midis LBGj-së dhe ligjeve të tjera që duhet të preken, duke e bërë LBGj më shumë operacionale sesa deklarative, dhe caktimin e institucioneve specifike për të zbatuar aspekte të ndryshme.

Siç është hartuar në vitin 2008, LBGj-ja përmban nene që nuk mund të zbatohen në praktikë, sepse gjuha e përdorur është e paqartë dhe mungon sigurimi i veprimeve konkrete për zbatim. Së fundmi, është i nevojshëm një proces transparent dhe i hapur për rishikimin e LBGj-së, në mënyrë që versioni i miratuar të pasqyrojë pikëpamje dhe nevoja të ndryshme.

Gjetje rreth kapaciteteve dhe funksionimit të MShMS

Siç u përmend më lart aktualisht agjencia përgjegjëse për barazinë gjinore në Shqipëri është Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Kjo ministri shërben si organ koordinues për të gjitha politikat, nismat dhe vendimet për të përparuar të drejtat e grave dhe për të promovuar fuqizimin e grave. Brenda ministrisë ekziston një strukturë / seksion i caktuar që merret specifikisht me barazinë gjinore. Sidoqoftë, një shqetësim i përgjithshëm është që ministria nuk është e pajisur mirë, as në burime financiare e as në njerëzore, për të kryer një larmi të gjerë të detyrave dhe përgjegjësive të përcaktuara në Ligjin për Barazinë Gjinore. Më poshtë paraqitet një analizë e detyrave dhe kompetencave të agjencive zbatuese, në letër dhe në praktikë.

Detyrat dhe kompetencat e agjencisë zbatuese të LBGj-së

Që nga muaji shtator 2017, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka qenë ministria kryesore e ngarkuar me çështjet që lidhen me barazinë gjinore, dhunën me bazë gjinore dhe dhunën në familje dhe përbën një pjesë thelbësore të mekanizmave kombëtarë për barazinë gjinore. Sipas ligjit për barazinë gjinore, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka një gamë të gjerë detyrash në zbatimin e ligjit dhe monitorimin e angazhimeve të barazisë gjinore si kundër angazhimeve kombëtare dhe ndërkombëtare. Më konkretisht, neni 13 i ligjit përcakton që ministria përgjegjëse për barazinë gjinore:

- a- *Zbaton dhe kontrollon këtë ligj, Strategjinë Kombëtare dhe Planin e Veprimit për Arritjen e Barazisë Gjinore si dhe detyrimet ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë në fushën e Barazisë Gjinore;*

Për këtë përgjegjësi, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka hartuar shpesh analiza të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore. Sidoqoftë, nuk ka vlerësim të qëndrueshëm dhe të rregullt të ndikimit të kuadrit ligjor që lidhet me barazinë gjinore, siç janë Ligji për Barazinë Gjinore dhe Ligji për Masat Kundër Dhunës në Marrëdhëniet Familjare. Shumica e ndryshimeve në këto ligje kanë ndodhur në mënyrë rastësore, sa herë që lind ndonjë nevojë e momentit apo ndodh ndonjë ngjarje.

Sa i përket angazhimeve ndërkombëtare, ministria përgjegjëse për barazinë gjinore shpesh ka raportuar mbi këto angazhime në mekanizma të ndryshëm raportues ndërkombëtarë, siç janë raportimi periodik për CEDAW, UPR dhe GREVIO. Mungon një ndjekje sistematike e rekomandimeve të marra dhe kapacitetet duhet të ngrihen më tej për të pasur një sistem në vend që ndjek të gjitha angazhimet ndërkombëtare, rekomandimet e marra në mënyrë që të ndjekë progresin dhe të përmbushë detyrimet.

Stafi i nivelit qendror dhe lokal kushtuar barazisë gjinore

Miratimi i Ligjit për Barazinë Gjinore sjell detyrimin institucional për të emëruar nëpunës për çështjet gjinore në çdo ministri të linjës dhe në organet e qeverisjes lokale. Neni 13/3 përcakton se "Institucionet shtetërore në nivel qendror dhe lokal kanë detyrimin ligjor për të bashkëpunuar me ministrin përkatës

në shkëmbimin e informacionit dhe në lehtësimin e kryerjes së funksioneve të tij." Ligji përcakton detyrimin që personeli përgjegjës për çështje gjinore të jetë të emëruar në çdo ministri dhe organ lokal. Aktualisht, pikat të tilla fokale janë emëruar në shumicën e ministrive të linjës dhe një numër njësisish të qeverisjes vendore. Kjo krijon një kornizë të mirë institucionale për zbatimin e Ligjit për Barazinë Gjinore. Megjithatë, mungesa e përgjegjësive të qarta, kombinimi i gjinisë barazia me detyrat e tjera dhe mungesa e burimeve të dedikuara financiare për të mbështetur punën e tyre, si dhe mungesa e koordinimit në nivelin institucional dëmton aftësinë e nëpunësve të barazisë gjinore për të luajtur një rol të rëndësishëm në zbatimin e Ligjit për Barazinë Gjinore dhe Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore. Prandaj, edhe pse emërimi i tyre është një arritje ligjit, është i domosdoshëm një rishikim thelbësor i roleve, përgjegjësive dhe burimeve të tyre për të çuar përpara procesin e zbatimit të Ligjit për Barazinë Gjinore.

Gjetjet në lidhje me situatën ekonomike në vend.

Në mënyrë që Ligji për Barazinë Gjinore të forcohet dhe zbatohet më tej, situata ekonomike e Shqipërisë duhet të jetë e qëndrueshme dhe në rritje. Sipas Bankës Botërore, Shqipëria është shndërruar nga një prej vendeve më të varfra në Evropë në një vend me të ardhura mesatare.¹²³ PBB-ja e Shqipërisë sipas çmimeve faktike në vitin 2018 u vlerësua në 12,8 miliardë €. ¹²⁴ Sipas raportit të progresit të KE-së, Shqipëria vijoi të ishte e vendosur për forcimin e stabilitetit makroekonomik dhe konsolidimin fiskal.¹²⁵ Megjithatë, edhe pse rimëkëmbja ekonomike përmirësoi kushtet në tregun e punës, pasiviteti dhe papunësia mbeten të larta, veçanërisht për gratë. Vendi po zbaton reforma të rëndësishme për të rritur dhe krijuar vende pune, ndërsa përparon agjendën e integritit në Bashkimin Evropian.¹²⁶ Pavarësisht nga zbatimi i politikave makroekonomike dhe sociale, varfëria në Shqipëri është një problem. Deri në vitin 2012, Anketa e Matjes së Standardit të Jetesës (/LSMS/AMNJ)¹²⁷ tregoi se varfëria në Shqipëri u rrit nga viti 2008 në vitin 2012.¹²⁸

Për më tepër, LSMS (2012) theksoi se varfëria nuk është më vetëm një çështje rurale, pasi ka pasur një zhvendosje të varfërisë nga zonat rurale në ato urbane, ku këto të fundit kishin një rritje më të madhe të varfërisë. Që nga viti 2016, INSTAT po zbaton statistikën e BE-së për të ardhurat dhe kushtet e jetesës (EU-SILC) sipas rekomandimeve të Eurostat. Bazuar në këtë metodologji, në muajin nëntor 2019, INSTAT publikon për herë të parë rezultatet kryesore të Anketës së të Ardhurave dhe Kushteve të Jetesës (EU-SILC) që mat kushtet e jetesës, varfërinë relative dhe privimin material në familjet shqiptare.¹²⁹ Sipas botimit të fundit të INSTAT, në vitin 2018, vlerësohen rreth 671,000 individë që jetojnë nën pragun e rrezikut nga varfëria. Kjo shifër e vendosi Shqipërinë në vendin e 27-të nga 30 vendet për numrin e popullsisë në rrezik varfërie. Kjo shkallë relative e varfërisë nuk tregon numrin e

¹²³ Banka Botërore, 2020. <https://www.worldbank.org/en/country/albania>

¹²⁴ INSTAT, 2019. http://www.instat.gov.al/media/6854/produkti-i-brendsh%C3%ABm-bruto-final-2017-gjysm%C3%AB-final-2018_final.pdf

¹²⁵ Komisioni Evropian. 2019. Raporti Progresit për Shqipërinë.

¹²⁶ <https://www.worldbank.org/en/country/albania/overview>

¹²⁷ Anketa e Matjes së Standardit të Jetesës (LSMS) ishte një nga burimet kryesore të informacionit për të matur kushtet e jetesës dhe ai u krye në kontekstin e monitorimit të vazhdueshëm të varfërisë dhe krijimit e një sistemi vlerësimi të politikave në kuadrin e Strategjisë Kombëtare për Ekonomik dhe Social Zhvillimi (SKZHES), në ditë Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integritim (SKZHI). LSMS është një studim me shumë qëllime i kryer pranë familjeve dhe deri në vitin 2012, situata e varfërisë dhe për të siguruar një mjet të nevojshëm për të ndihmuar politikëbërësit në monitorimin dhe zhvillimin e programeve sociale. Gjatë kësaj periudhe, niveli i varfërisë ekstreme u rrit nga 1.2% në 2.2%¹²⁷. Fraksioni i popullatës konsumi i së cilës per capita është nën 4891 lek (çmimet e 2002) u rrit nga 12.5 % në 2008 në 14.3 % në 2012¹²⁷. Kjo do të thotë se në vitin 2012 rreth 420000 persona ishin të varfër.

¹²⁸ INSTAT. 2012. Albania Trends in Poverty 2002,2005,2008,2012. Living Standard Measurement Survey (LSMS). 2012 (revised).

http://ëëë.instat.gov.al/media/1312/living_standard_measurement_survey_2012_revised.pdf

¹²⁹ Treguesit e varfërisë në Anketën e të Ardhurave dhe Kushtet e Jetesës bazohen në konceptin relativ të varfërisë, i cili konsideron të ardhurat e disponueshme të familjes, numrin e anëtarëve të familjes (madhësia e familjes) dhe shpërndarjen e të ardhurave midis grupeve të popullsisë. Treguesi kryesor është rreziku i varfërisë (varfëria relative), e cila tregon përqindjen e individëve me të ardhura nën 60% të të ardhurave mesatare të barazuara, të përcaktuara gjithashtu si vija relative e varfërisë.

personave që janë në varfëri, por sa prej tyre kanë të ardhura nën kufirin e përkufizuar të varfërisë dhe kanosen nga varfëria.¹³⁰

Indeksi i barazisë gjinore për fushën e parave është 59,6 pikë për Shqipërinë dhe është më i ulët se mesatarja e BE-28 për 20.8 pikë.¹³¹ Kjo fushë përbëhet nga dy dimensione; ai ekonomik dhe burimet financiare. Sipas Indeksit të Barazisë Gjinore (2019) vlera për indeksin në nënfushën e situatës ekonomike (79.6) është shumë më e lartë se në nënfusha e burimeve financiare (44.6%).¹³² Për më tepër, Indeksi për Punësimin në Shqipëri është 67.6¹³³. Për të gjykuar mbi përparimin e barazisë gjinore në Shqipëri, panorama makroekonomike është shumë e rëndësishme për të kuptuar sesi alokohen fondet në sektorë të ndryshëm, si arsimit, shëndetësia ose për fuqizimin e grave. Zgjedhjet e duhura politike mund të sigurojnë që politika ekonomike të promovojë barazinë gjinore dhe të drejtat e grave.¹³⁴ Por shumë shpesh, politika ekonomike vepron si një pengesë për përparimin, madje dhe e dëmton barazinë gjinore. Politikat ekonomike të nivelit makro përfshijnë vendime mbi tatimet, shpenzimet qeveritare, tregtinë, investimet dhe politikat e borxhit. Politikat makroekonomike në Shqipëri duhet të hartohen brenda kontekstit të qëllimeve shoqërore të barazisë dhe mirëqenies të përshkruara në Agjendën e KB 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm.

Shqipëria ka shumë detyrime që burojnë nga Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (ICESCR/ KNDESK), Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW) dhe instrumenta të shumtë detyrues të ligjit ndërkombëtar të të drejtave të njeriut, përfshirë Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG/OZHQ), dhe veçanërisht qëllimi nr. 5 për barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave. Gratë dhe vajzat në Shqipëri përballen me pengesa të shumta për të gëzuar të drejtat e tyre njerëzore në sferat sociale, politike, kulturore dhe ekonomike të jetës. Qeveria është kryesisht përgjegjëse për heqjen e këtyre pengesave dhe sigurimin e barazisë thelbësore midis grave dhe burrave. Reformat e qeverive gjithashtu kanë një ndikim të madh në adresimin e pabarazive gjinore. Sidoqoftë, për shkak se pabarazia gjinore është kaq e shumanshme, nuk ka një rregullator të vetëm dhe qasja më e mirë e politikave do të ndryshojë në vende të ndryshme, duke u varur nga niveli i zhvillimit ekonomik, boshllëqet ekzistuese gjinore dhe shpejtësia me të cilën teknologjia e re ndikon në ekonomi.¹³⁵

Krijimi i një mekanizmi monitorimi mbi përfaqësimin e grave në administratën publike, veçanërisht ato në pozicionet vendimmarrëse, do të ndihmonte në gjurmimin e arritjes së disa synimeve të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm.¹³⁶ Këto synime përfshijnë pjesëmarrjen e plotë dhe efektive të grave në të gjitha nivelet e vendimmarrjes në jetën politike, ekonomike dhe publike (SDG/OZHQ 5.5), punësim të plotë dhe produktiv për të gjitha gratë, burrat dhe të rinjtë, nga të gjitha prejardhjet (SDG/OZHQ 8.5) dhe vendimmarrje të përgjegjshme, gjithëpërfshirëse, pjesëmarrëse dhe përfaqësuese në të gjitha nivelet (SDG/OZHQ 16.7). Në fund, disponueshmëria më e mirë e të dhënave për përfaqësimin e grave në pozitën e vendimmarrjes do të kontribuonte në zhvillimin dhe zbatimin e ligjeve dhe politikave jodiskriminuese (SDG/OZHQ 16.b) dhe institucioneve efektive, të përgjegjshme dhe transparente të administratës publike (SDG/OZHQ 16.6).

¹³⁰ INSTAT, 2019. Income and Living Conditions Survey (EU-SILC) in Albania, 2017-2018. Retrieved from <http://www.instat.gov.al/media/6544/income-and-living-conditions-in-albania-2017-2018.pdf>

¹³¹ INSTAT, MoHSP and EIGE. 2019. Gender Equality Index for the Republic of Albania, 2019. http://www.instat.gov.al/media/6661/gender_equality_index_for_the_republic_of_albania_2020.pdf

¹³² INSTAT, MoHSP and EIGE. 2019. Gender Equality Index for the Republic of Albania, 2019. http://www.instat.gov.al/media/6661/gender_equality_index_for_the_republic_of_albania_2020.pdf

¹³³

¹³⁴ Rrjeti Gjinor për Zhvillim. 2019. Barazia gjinore në nivelet e ekonomisë makro

¹³⁵ Dabla-Norris and Kochhar, K. 2019. Mbyllja e Hendekut Gjinor. Përfitimet ekonomike nga përfshirja e më shumë grave në fuqinë punëtore janë më të mëdha nga sa mendohej. <https://www.imf.org/external/pubs/ft/fandd/2019/03/pdf/closing-the-gender-gap-dabla.pdf>

¹³⁶ Per listen e plotë të Qëllimeve për Zhvillim shihni: <http://www.undp.org/content/undp/en/home/sustainable-development-goals.html>

Rekomandime për përparimin e statusit aktual të LBGj

Rekomandime për Parlamentin e Shqipërisë

- Kuvendi i Shqipërisë duhet të konsiderojë institucionalizimin e kontrollit post legjislativ për të gjithë legjislacionin e miratuar, përfshirë LBGj.
- Ligji duhet të pranojë ekzistencën e larmive të gjinisë dhe karakteristikave gjinore kur bëhet fjalë për përcaktimin dhe kategorizimin e gjinisë. Ekzistenca e njerëzve interseksual konfirmon faktin se seksi është një spektër dhe që ekzistojnë njerëz me larmi të karakteristikave të seksit përveç meshkujve dhe femrave. Ligji gjithashtu duhet të pranojë që gjinia duhet të perceptohet dhe pranohet si zgjedhja e dikujt për të destinuar seksin e tyre dhe autonominë trupore në shoqëri ashtu siç ata zgjedhën dhe ndihen.
- Forcimi i zbatimit praktik të qëllimit të parë të LBGj-së për të siguruar mbrojtje efektive nga diskriminimi, i cili aktualisht bie kryesisht nën kompetencat e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Ligjit Kundër Diskriminimit.
- Forcimi i ligjit për mekanizmin institucional përgjegjës për zbatimin e LBGj-së:
 - Forcimi dhe qartësimi i roleve për Këshillin Kombëtar për Barazinë Gjinore dhe më shumë pushtet për të kryer KPL-në.
 - Forcimi i roleve, rritja e fondeve dhe burimeve të qarta për nëpunësit e barazisë gjinore për zbatimin e LBGj-së në terren. Të prezantohet një seksion specifik për kontrollin post-legjislativ në LBGj-në e rishikuar dhe të lidhet me Rregulloren e Kuvendit, në mënyrë që procedurat dhe rolet të specifikohen sipas institucioneve përgjegjëse.
- Të shihet mundësia e krijimit të një mekanizmi institucional për të zbatuar ligjin, i ngjashëm me Komisionerin për Mbrojtjen nga diskriminimi. Ky komisioner i pavarur mund të mbulojë zbatimin e LBGj-në dhe LDhF.
- Të shihet mundësia e rishikimit të LBGj-së për t'u përshtatur më shumë me kornizën aktuale ligjore në Shqipëri dhe për të pasqyruar natyrën ndërsektoriale të agjendës së barazisë gjinore.
- Organizatat e shoqërisë civile dhe akademikët duhet të përfshihen në mënyrë specifike dhe t'u jepen role dhe përgjegjësi në LBGj-në e rishikuar. Ato duhet të jenë pjesë integrale e procesit të PLS për LBGj dhe zbatimin e tij.
- Ligji për Barazinë Gjinore duhet të përfshijë një nen ku të parashikohet që barazia gjinore të përmendet në preambulën e çdo ligji dhe strategjie ose në përcaktimin e kontekstit të politikës ose programit, si dhe në kornizën ligjore që i referohet asaj.
- Ligji duhet të sigurojë që barazia gjinore të jetë pjesë në objektivat (et) e të gjitha strategjive të vendit për të vendosur një pikënisje dhe për të inkurajuar angazhimin e të gjithë aktorëve të përfshirë në zhvillimin e nismës për barazi gjinore.
- LBGJ-ja duhet të theksojë rëndësinë e treguesve të barazisë gjinore për të ndjekur se ecuria e barazisë gjinore është e zbatueshme për të gjitha institucionet publike. Përndryshe, mund të jetë e nevojshme të vendosen tregues të rinj bazuar në dhënat përkatëse, të ndara sipas seksit. Ligji për statistikën zyrtare duhet të përfshijë rëndësinë dhe kërkesat për mbledhjen e të dhënave të ndara gjinore.

Rekomandime për Qeverinë e Shqipërisë

Zbatimi i LBGj-së është përgjegjësi e qeverisë, e cila duhet të sigurojë që parimi i barazisë jo vetëm të jetë *de jure* por edhe *de facto*. Gjithashtu, zbatimi i ligjit, është detyrë e qeverisë në mënyrë që të eliminojë faktorë të ndryshëm që pengojnë zbatimin e parimit të barazisë gjinore në vend dhe të krijojnë mundësi për të edukuar publikun për këtë ligj specifik, bazuar edhe në Strategjinë Kombëtare për Edukimin Ligjor. Ky ligj, parashikon këtë rregullim ligjor për të krijuar mekanizma shtesë për trajtim të barabartë midis gjinive në të gjitha sferat e jetës shoqërore, ndër të tjera, në jetën politike dhe publike,

punësimin, arsimin, shëndetësinë, ekonominë, përfitimet sociale, sportet, kulturën dhe sfera të tjera të përcaktuara nga ky ose ndonjë ligj tjetër. Gjithashtu, është e rëndësishme pjesëmarrja në përgatitjen e legjislacionit, dokumenteve strategjike dhe programeve, duke siguruar përfshirjen e buxhetimit gjinor dhe integrimin gjinor.

- Forcimi i strukturës dhe përcaktimi i fushës specifike të një agjencie / drejtorie me përgjegjëse për zbatimin e LBGJ-së dhe për gjithë procesin pohues të zbatimit të parimit të barazisë gjinore në shoqërinë shqiptare. Zhvillimi i një strukture më të madhe profesionale me burime të mjaftueshme financiare që do të shërbejë gjithashtu si një qendër e barazisë gjinore edhe për të mbajtur të dhëna, dokumentacion, legjislacioni, analiza etj.
- Forcimi i rolit të Këshillit Kombëtar për Barazinë Gjinore dhe rishikimi i detyrave të tij të përcaktuara me ligj, në Nenin 12 “Detyrat e Këshillit Kombëtar për Barazinë Gjinore”. GREVIO inkurajon fuqimisht autoritetet shqiptare të forcojnë rolin e Këshillit Kombëtar për Barazinë Gjinore duke dhënë kompetenca të qarta për vendimmarrjen për t'i dhënë mundësi këtij organi të ushtrojë në mënyrë efektive funksionet e tij si një organ koordinues. Ai më tej fton autoritetet të alokojnë burime njerëzore dhe financiare të dedikuara për trupin koordinues për të ushtruar në mënyrë efektive funksionet e tij si një organ koordinues (paragrafi 36).
- Në zbatim të nenit 15 të LBGJ-së, MShMS në bashkëpunim me INSTAT të krijojë një instrument për të matur nivelin e përfaqësimit gjinor në zbatimin e kuotës gjinore për bordet, institucionet e pavaruara, organet vendore dhe qendrore.
- MShMS-ja duhet të hapë procesin e rishikimit të plotë të zbatimit të LBGJ bazuar në diskutime të gjera. Ky proces duhet t'i paraprijë ndryshimeve ligjore në Ligjin për Barazi Gjinore në Shoqëri në Republikën e Shqipërisë. Krijimi i një nënstrukture të qëndrueshme brenda asaj kryesores për kërkimin dhe zhvillimin e mjeteve për integrimin e barazisë gjinore në Shqipëri në bashkëpunim me Akademinë dhe shoqërinë civile dhe komunitetin e donatorëve.
- Të shihet mundësia e rishikimit të nenit 23 “Vlerësimi i punës së papaguar”, pika 2 e këtij neni mbi përfitimet duhet të plotësohet (përveç përfitimeve nga shërbimet e komunitetit, politikat e punës dhe punësimin, si dhe formimin profesional) me forma të tjera të përfitimeve, duke iu referuar gjithashtu modeleve më të mira të vendeve të tjera.
- Buxhetimi gjinor është bërë tashmë pjesë e qeverisë si një instrument për të integruar perspektivën gjinore në planifikimin ekonomik dhe buxhetin e qeverisë. Ai synon të miratojë një perspektivë për përmirësimin e barazisë së grave dhe burave bazuar në një vlerësim gjinor në secilën fazë të planifikimit, programit dhe realizimit të buxheteve qeveritare. Pra, është detyrë e MShMS të propozojë akt nënligjor ose rregullorë të veçantë për këtë instrument të rëndësishëm.
- Të shihet mundësia e organizimit të një séance edukuese lidhur me LBGJ-në, në mënyrë të vazhdueshme, përmes ASPA-s, për të gjithë stafin e administratës publike, për rëndësinë dhe zbatimin e tij në administratën publike.
- Mediat, publiku i gjerë dhe komunitetet e ndryshme duhet të informohen në lidhje me ekzistencën dhe mbrojtjen që jep ky ligj për të hapur rrugën për pranimin e barazisë si një e drejtë, si një koncept normal në shoqërinë shqiptare dhe që të mos shihet vetëm në funksion të kuotave gjinore.
- LBGJ-ja duhet të përforcojë kërkesën për analiza sektoriale gjinore dhe integrimin gjinor në sektorë të rëndësishëm, si ujësjellës e kanalizime, infrastruktura, energjetika etj..
- Të shihet mundësia që sektori përgjegjës për barazinë gjinore të funksionojë në mënyrë efektive si një mekanizëm koordinues, duke shtuar burime, financiare dhe njerëzore.

Qeveria e Shqipërisë duhet të rishikojë Kodin e Qeverisjes së Korporatave të Shqipërisë dhe çdo ligj që rregullon qeverisjen e korporatave për kompanitë që operojnë në Shqipëri. Kodi i Qeverisjes së Korporatave të Shqipërisë duhet të përfshijë parimet e barazisë gjinore dhe kuotat gjinore siç parashikohen në Ligjin për Barazinë Gjinore në Shoqëri në Republikën e Shqipërisë. Kodi duhet të përmbushë standardet më moderne ndërkombëtare dhe evropiane, parimet e OECD-së dhe angazhimin e Shqipërisë për barazinë gjinore.

Shtojca

Shtojca.1 Rekomandime të rëndësishme për pjesët e Ligjit të Barazisë Gjimore

Më poshtë janë paraqitur disa rekomandime për ndryshime që mund t'i bëhen neneve të caktuara të LBGj-së:

Neni 1 - Objekti dhe Neni 2 - Qëllimi

Objekti dhe qëllimi i këtij ligji duhen përmirësuar ndjeshëm. Në formën e tij aktuale, ky nen është i kufizuar në adresimin e diskriminimit për shkak të gjinisë dhe nuk përmban objektiva në lidhje me arritjen e barazisë gjimore në shoqëri. Qëllimi i ligjit duhet të zgjerohet për të përfshirë fusha që aktualisht nuk janë në ligj, të tilla si barazia dhe qasja në shëndetësi dhe në drejtësi.

Neni 3 - Parimet Themelore

Në Shqipëri, standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut janë drejtpërdrejt të zbatueshme. Aktet më të rëndësishme ndërkombëtare janë përfshirë gjithashtu në Kushtetutën e Shqipërisë. LBGj është në përputhje me *Acquis Communautaire* të BE-së, Konventën "Për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Grave. Sidoqoftë, LBGj duhet të përfshijë legjislacionin tjetër të rëndësishëm ndërkombëtar në parimet e tij themelore siç janë UDHR, Pakti mbi të Drejtat Civile dhe Politike (ICCPR), konventat e ILO, GJED dhe GJEDNJ.

Neni 4 - Përkufizimet

Duhen përgatitur një seri e re përkufizimesh duke u përpjekur që ato të jenë të shteruese. Përkufizimet që do të përcaktohen duhet të merren në konsideratë nga nenet e këtij ligji. Ligji duhet të pranojë ekzistencën e larmive të karakteristikave të seksit kur bëhet fjalë për përkufizimin dhe kategorizimin e gjinisë. Ekzistenca e njerëzve interseksual konfirmon faktin se seksi është një spektër dhe që ekzistojnë njerëz me larmi të karakteristikave të seksit përveç meshkujve dhe femrave. Ligji gjithashtu duhet të pranojë që gjinia duhet të perceptohet dhe pranohet si zgjedhja e dikujt për të përdorur seksin e tyre dhe autonominë trupore në shoqëri ashtu siç zgjedhin dhe ndjehen. Për më tepër, përkufizimet e LBGj-së duhet të përputhen me përkufizimet në pjesë të tjera të legjislacionit, siç janë Ligji për Masat Kundër Dhunës në Marrëdhëniet Familjare dhe Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Neni 5 - Zbatimi i ligjit

Për të zbatuar ligjin ai vetë duhet të sjellë ose përfshijë nene dhe pika të qarta duke pasur parasysh që pa një kornizë efektive institucionale, e cila mundëson zbatimin e ligjit, atëherë zbatimi i tij nuk do ishte efektiv. Gjithashtu, në nenin Zbatimi i ligjit, një pikë duhet t'i kushtohet zbatimit dhe integritetit gjinor në ligjet dhe strategjitë e tjera. Ky nen mund të përfshijë gjithashtu dispozita që lidhen me KPL-në.

Neni 6 - Ndalimi i diskriminimit gjinor

Gjithçka që është diskriminim duhet të parashikohet si veprim i ndaluar në LBGj. E drejta për mbrojtje nga diskriminimi është një e drejtë universale, e sanksionuar edhe në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e cila është e zbatueshme në Shqipëri.¹³⁷ Neni 14 i GJEDNJ-së thotë: "Gëzimi i të drejtave dhe lirive të përcaktuara në këtë Konventë do të sigurohet pa diskriminim në bazë të seksit,

¹³⁷ Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Neni 14. Retrieved from https://e.echr.coe.int/Documents/Convention_ENG.pdf. Gëzimi i të drejtave dhe lirive të përcaktuara në këtë Konventë do të sigurohet pa diskriminim në çdo bazë të tillë si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimi politik ose mendimi tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, shoqata me një pakicë kombëtare, pronë, lindja ose statusi tjetër.

racës, ngjyrës, gjuhës, fesë, mendimit politik ose ndonjë mendimi tjetër, origjinës kombëtare ose shoqërore, pakicave kombëtare, pronës, lindjes ose status tjetër”. Ndaj sugjerohet që neni 6 duhet të rishikohet duke marrë parasysh nenin e lartpërmendur të GjEDNj-së.

Neni 7 - Masat e nevojshme për sigurimin e barazisë gjinore

LBGj-ja duhet të detyrojë zyrtarët në ministri dhe bashki të kryejnë detyrat dhe përgjegjësitë e tyre sipas këtij ligji dhe akteve të tjera ligjore që rrjedhin nga ky ligj dhe legjislacioni në fuqi. Me këtë dispozitë, ligjvënësi krijon bazën që i gjithë aparati shtetëror të jetë i vetëdijshëm për rëndësinë e barazisë gjinore si një standard i përparuar.

Neni 8- Masat e posaçme të përkohshme

Kuota gjinore nuk duhet të konsiderohet si një masë e përkohshme speciale, por një masë e veçantë. Masa të tilla nuk duhet të ndalen së ekzistuari edhe nëse arrihen qëllimet e barazisë gjinore.

Neni 9 - Masat e veçanta

Rishikimi i masave speciale, përfshin masa më të veçanta për të arritur barazinë gjinore siç janë programet për të rritur pjesëmarrjen e seksit më pak të përfaqësuar në vendimmarrje dhe jetën publike; masat për fuqizimin ekonomik dhe pjesëmarrjen e grave në botën e punës; masa të veçanta për të përmirësuar barazinë gjinore në arsim, shëndetësi, kulturë dhe shpërndarje dhe / ose rialokim të burimeve duke përfshirë pronat etj. Sigurimi i buxhetit për barazinë gjinore, si në nivelin lokal ashtu edhe në atë kombëtar duhet të përfshihet si masë e veçantë.

Pjesa II - Organet përgjegjëse për arritjen e barazisë gjinore dhe detyrat e tyre

Pjesa II duhet riparë bazuar në gjetjet e këtij KLP-je dhe duhen caktuar detyra dhe përgjegjësi të përshtatshme për secilën pjesë të mekanizmit të barazisë gjinore në Shqipëri. Ligji duhet të detyrojë që institucionet publike të zbatojnë nenet si t'u sugjerojë atyre private ta zbatojnë atë. Seksioni aktual mbi organet përgjegjëse është i kufizuar në ministrinë përgjegjëse për barazinë gjinore. Kjo bën që ligji të jetë pjesërisht i zbatueshëm. Prandaj, duhet të identifikohen qartë më shumë institucione dhe përcaktohen role të zbatueshme. Kjo përfshin:

- Parlamenti duhet të kërkojë që parimet e barazisë gjinore të përfshihen në Rregulloren e Kuvendit duke iu referuar LBGJ-së.
- Njësitë e Qeverisjes Vendore duhet të përmenden specifikisht dhe të ngarkohen me detyrime/sanksione midis institucioneve përgjegjëse për zbatimin e LBGJ-së si në sigurimin e barazisë gjinore në strukturat e tyre, ashtu edhe në buxhetimin e duhur gjinor çështjet e barazisë në buxhetet e tyre lokale.
- Organizatat e shoqërisë civile gjithashtu duhet të përmenden në më shumë detaje duke marrë parasysh rolin e rëndësishëm që luajnë në sigurimin e barazisë gjinore në shoqëri. Prandaj, ato mund të vishen me rol advokimi dhe monitorimi. Të sanksionohet bashkëpunimi i ngushtë me institucionet e tjera për të siguruar parimet e barazisë gjinore.
- Gjykatat gjithashtu duhet të përmenden dhe të kenë përgjegjësi për të adresuar pretendimet dhe çështjet e paraqitura para saj.
- Institucionet e tjera mund të përmenden në seksione specifike, siç është seksioni i barazisë gjinore në media ku Autoriteti i Mediave Audiovizive gjithashtu mund të luajë një rol të rëndësishëm në adresimin e diskriminimit gjinor në media.
- Për Inspektoratin Shtetëror të Punës duhet të bëhet një referencë më e detajuar në lidhje me rolin e tyre për të siguruar barazinë gjinore në botën e punës.

Pjesa III - Përfaqësimi i barabartë gjinor në procesin e vendimmarrjes

Duhen caktuar role dhe përgjegjësi të qarta të secilit organ që të sigurohet përfaqësimi i barazisë gjinore në vendimmarrje, siç është Organizata që do të menaxhojë Kodin Zgjedhor për nenet në zbatim në lidhje me kuotën gjinore të Kodit Zgjedhor; kryetarët e bashkive dhe këshilli i qytetit për zbatimin e kuotave në nivelin lokal.

Pjesa IV - Mbrojtja dhe trajtimi i barabartë gjinor në marrëdhëniet e punës

E gjithë pjesa IV, duhet të rishikohet dhe të harmonizohet me me Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, direktivat e Komisionit Evropian siç është Direktiva Nr. 2000/78 / KE e 27 nëntorit 2000 mbi krijimin e një kornize të përgjithshme për trajtim të barabartë në punë dhe profesion. Kjo direktivë zbatohet për të gjithë personat në sektorin publik dhe privat në lidhje me kushtet e mundësisë së punësimit, të vetëpunësimit ose të profesionit, duke përfshirë kriteret e përzgjedhjes dhe kushtet e rekrutimit në çdo degë dhe në të gjitha nivelet e hierarkisë profesionale. Gjithashtu, kjo pjesë duhet të jetë në përputhje me dispozitat e Organizatës Ndërkombëtare të Punës dhe konventën më të fundit dhe të përparuar C190 - Konventa kundër Dhunës dhe Ngacmimit në vendin e punës. Kodi i Punës i Shqipërisë, sjell detyrimin për të rishikuar pjesën IV të LBGj-së dhe përafrimin me Kodin e Punës dhe kornizat ndërkombëtare të sipërpërmendura për Botën e Punës. Gjithashtu, duhen marrë në konsideratë praktikatat e GJEDNJ-së dhe GJED-së duke pasur parasysh se Shqipëria nuk ka ende një praktikë gjyqësore mbi diskriminimin në tregun e punës.

Pjesa V - Mbrojtje e barabartë nga diskriminimi për shkak të gjinisë në fushën e arsimit dhe kualifikimit

Pjesa V duhet të rishikohet. Kjo pjesë duhet të përfshijë edukimin mbi barazinë gjinore dhe kundër dhunës në fëmijëri në përputhje me Konventën e Stambollit. Ligji i ri për barazinë gjinore duhet të japë drejtimin specifik që sektori i arsimit duhet të ndjekë në lidhje me barazinë gjinore.

Pjesa VI - Trajtimi dhe mbrojtja e barabartë nga diskriminimi gjinor në media

Diskriminimi gjinor, gjuha e urrejtjes dhe seksizmi në media është një fenomen i përhapur në shoqërinë shqiptare. LBGj-ja duhet të forcojë nenin në lidhje me çështjet e lartpërmendura dhe gjithashtu të zbatojë sanksionet dhe rolin e Autoritetit të Mediave Audiovizive

Pjesa VII - Zgjidhja e mosmarrëveshjeve dhe sanksioneve

E gjithë pjesa duhet të rishikohet dhe sanksionet duhet të harmonizohen në nivelin e legjislacionit të lidhur me të, siç është rasti i Kodit Zgjedhor dhe të vendosen të tjera për moszbatim të LBGj-së sipas rëndësisë.

Shtojca 2 : Lista e Institucioneve të konsultuara

Nr.	Institucionet e konsultuara në lidhje me kuotën gjinore	Përgjigjur ose jo
1	Agjencia e Sigurimit të Depozitave	Përgjigjur
2	Avokati I Popullit	Përgjigjur
3	Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit	Përgjigjur
4	Autoriteti I Komunikimeve Elektronike dhe Postare	
5	Autoriteti I Konkurrencës	Përgjigjur
6	Autoriteti I Mbikëqyerjes Financiare	Përgjigjur
7	Autoriteti I Mediave Audiovizive	
8	Banka e Shqiperise	Përgjigjur
9	Kryeministria	Përgjigjur
10	Enti Rregullator I Energjisë	Përgjigjur
11	Enti Rregullor I UJit	Përgjigjur
12	Instituti i Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit	

13	Instituti i Lartë të Deklarimit të Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesave	
14	Këshilli Kombëtar I Radio -Televizionit	
15	Komisioneri per Mbrojtjen nga Diskriminimi	Përgjigjur
16	Komisioneri për Mbikqyrjen e Shërbimit Civil	Përgjigjur
17	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale	Përgjigjur
18	Kontrolli I Lartë I Shtetit	Përgjigjur
19	Komisioni Qendror I Zgjedhjeve	
20	Ministria e Shëndetësisë	Përgjigjur
21	Prokuroria e Përgjithshme	
22	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike	
23	Këshilli I lartë I Prokurorisë	

Shtojca 3: Lista e individëve të konsultuar/intervistuar

Nr	Institucioni	Personi kontaktuar	Pozicioni
1	Parlamenti i Republikës së Shqipërisë	Vasilika Hysi	Zëvendëskryetar parlamenti
2	Nënkomisioni për barazinë Gjinore dhe kundër Dhunës në Familje	Eglantina Gjermeni	deputet
3	Komisioneri kundër Diskriminimit	Robert Gajda	Komisioner Këshilltare
4	Komisioneri kundër Diskriminimit	Brunilda Menalla	Këshilltare
5	GREVIO	Iris Luarasi	Zëvendës Presidente GREVIO Drejtore për Linjën e Këshillimit për Gra e Vajza dhe Gazetarë
6	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	Brunilda Dervishaj	Sektori për Barazinë Gjinore
7	Këshilli për Barazinë Gjinore	Ines Leskaj	Përfaqësues të OSHC në këshill/Drejtore e Rrjetit për Fuqizimin e Grave Shqiptare
8	Këshilli për Barazinë Gjinore	Aurela Bozo	Përfaqësues të OSHC në këshill / Drejtore e Qendrës për Nisma Civile
9	Këshilli për Barazinë Gjinore	Altin Hazizaj	Përfaqësues të OSHC në këshill / Drejtor i CRCA/EXPAT
10	Ministria e Drejtësisë	Besmir Beja	Drejtore e Përgjithshme Drejtoria e Përgjithshme e Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit
11	Ministria e Drejtësisë	Iris Aliaj	Këshilltar / ish ekspert juridik në Qendrën për Nisma Civile

12	Ministria e Punëve të Brendshme	Romina Kuko	Zëvendësministër
13	Ministria e Punëve të Brendshme /Drejtoria e Policisë	Alma Katragjini	Pikë Fokale për Gjininë
14	Përfaqësues të Autoriteteve Vendore	Agron Haxhimal	Shoqata e Bashkive Shqiptare
	Përfaqësues të Autoriteteve Vendore	Adelina Farrici	Shoqata për Autonomi Vendore
15	UNDP	Edlira Papavangjeli	Barazia Gjinore dhe Aksesimi në Drejtësi, Menaxhere Programi në UNDP Shqipëri
16	Tirana Legal Aid Society	Anisa Metalla	Eksperte ligjore
17	National Democratic Institute	Ana Kadovic Gasper Gjeluçi	Drejtoreshë Ekzekutive
18	Avokati i Popullit	Etleva Sheshi	Avokati i Popullit
19	OSBE	Miranda Veliaj Sihana Nebiu	Për projektin për Mbështetjen Parlamentare dhe Edukimin Civil (PACEP)
20	UN Women	Estela Bulku Megi LLubani Erisa Cela	
21	Fakulteti i Shkencave Sociale	Daniela Kalaja	Pedagoge në Departamentin për Barazi Gjinore
22	Fakulteti i Shkencave Sociale	Elona Dhembo	Pedagoge në Departamentin për Barazi Gjinore
23	Fakulteti i Shkencave Sociale	Merita Pone	Pedagoge në Departamentin për Barazi Gjinore
24	INSTAT	Majlinda Nesturi	Drejtoreshë e Statistikave Sociale
25	INSTAT	Maldi Dema	Drejtoreshë e Koordinimit dhe Ceshtjeve Ligjore.
26	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	Merita Xhafaj	Drejtoreshë e Përgjithshme Drejtoreshë e Politikave dhe e Zhvillimit Të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale/ Shefe e Sektorit të Barazisë Gjinore
27	Drejtoreshë e Strategjive në Kryeministri	Oriana Arapi	Drejtoreshë e Përgjithshme Drejtoreshë për Zhvillimin dhe Mirëqeverisjen
28	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	Klement Zguri	Kryetar i KQZ
29	Përfaqësues nga Gjykata e Tiranës		
30	Drejtoreshë e ASPA	Kleopatra Maliqi	Drejtoreshë
31	Aleanca LGBT	Xheni Karaj	
32	Ekspertë Gjinorë	Ermira Danaj	
33	Ekspert gjinor dhe të statistikave	Ania Plaku	

Shtojca 4. Pyetjet kërkimore

1. A parashikon procesi i hartimit të ligjit në vend (nga qeveria dhe parlamenti) raste të qasjes “Cikli legjislativ”, që do të thotë një rishikim ciklik i politikave, legjislacionit, miratimit, zbatimit, vlerësimin dhe ndryshimin e legjislacionit?
2. Në çfarë mase zbatohen në legjislacion vlerësimet:
 - Ex-ante (The **term ex ante** është fjalë latine që do të thotë “bazuar në hamendësim dhe parashikim”. Gjithashtu përkthehet si paraprakisht ose para një ngjarjeje dhe bazuar në parashikime sesa ne rezultate)
 - Vlerësimet e Ndikimit Rregullator (Regulatory Impact Assessments-RIA)
 - A praktikohet një memorandum/manual shpjegues për legjislacionin e ri që praktikohet ose zbatohet?
 - Nëse ka dokumenta ex-ante, në ç'masë përfshihen në to indikatorë dhe informacione bazë? Si është cilësia e tyre dhe niveli i detajimit? Këto dokumenta mund të jenë të dobishme kur vlerësohet ndikimin e legjislacionit vite më vonë?
3. Në ç'masë ministritë apo institucione qeveritare kryejnë vlerësime ex-post (Pas ngjarjes/faktit) të ndikimit të legjislacionit? A mbahen nga ministrisë apo a komunikohen edhe parlamentit gjetjet e këtyre vlerësimeve nëse mbahen?
4. Deri në çfarë mase ekziston interesi ose ndërgjegjësimi në parlament (stafi dhe deputetët) për rëndësinë e kontrollit parlamentar post legjislativ apo vlerësime ex-post të ndikimit të legjislacionit? A ka pasur raste specifike si shkelje e legjislacionit, raportime për ligje joefektive, skandale, kërkesa për informacion nga media, peticione etj) që tregojnë nevojën për analizen e impaktit ex-post legjislativ. A janë diskutuar këto në takimet e komisioneve parlamentare, seancat plenare, nga ndonjë deputet ose grup parlamentar?
5. Cila është baza (potenciale) ligjore për KPL (kontroll parlamentar post legjislativ) në parlament? (Kushtetuta, legjislacioni mbi kompetencat e parlamentit, Rregullorja e Kuvendit apo legjislacion specifik që përfshin klauzolat e rishikimit)
6. Cilat drejtori ose seksione në Sekretariatit e parlamentit janë të rëndësishme për të fuqizuar kapacitetin e brendshëm organizativ të parlamentit në lidhje me procesin KPL (kontroll parlamentar post legjislativ)? Sa interes, kompetenca dhe kapacitete kanë Departamentet e Komisioneve të Parlamentit, Departamenti i kërkimit, Departamenti Ligjor të realizojnë kërkime në lidhje me impaktin e legjislacionit?
7. A kërkon/ka kërkuar ndonjëherë Parlamenti (apo ndonjë komision parlamentar) vlerësime legjislative nga një institucione zyrtare ose jo, organizata, universitete apo konsulentë?
8. Nëse parlamenti zhvillon ose është i interesuar për të kryer KPL, cili është qëllimi i tij? A parashikohet që KPL të shohë zbatimin e legjislacionit në dimensionin juridik të tij? Gjithashtu, a përfshin KPL nga parlamenti raste të vlerësimit të ndikimit të legjislacionit? Nëse nuk ka praktikë të përcaktuar, atëherë cila është e preferuar nga deputetët?
9. Cilat janë rezultatet e kërkesave për informacion të komisionit/eve për KPL nga Parlamenti? (Rezultatet mund të jenë në lidhje me raporte specifike të miratuara nga komisionet ose seanca plenare; dhe ndjekjen për të verifikuar zbatimin e rekomandimeve).
10. A janë në dispozicion (online ose ndryshe) të publikut puna e Komisionit parlamentar dhe raportet e tij? Kështu që edhe puna parlamentare për KPL të jetë transparente në të njëjtën mënyrë?

Metodologji

Në mbledhjen e informacionit dhe shkrimin e studimit të rastit, mund të merrni parasysh:

- Identifikimi i deklaratave publike nga bashkëbiseduesit kryesorë parlamentarë ose palët e interesuara

- Intervistë me kryetarin dhe anëtarët e komisionit/eve.
- Takimi i stafit kryesor parlamentar, përfshirë. Drejtorët e departamenteve juridike, kërkimore dhe komitetit
- Intervistimi i bashkëbiseduesve në ministri / qeveri
- Kontaktimi i organizatave përkatëse profesionale, qendrave kërkimore, universiteteve
- Mbledhja e të dhënave sasiore ose statistikave të rëndësishme për disa nga pyetjet e mësipërme.

Shtojca 5 Disa mendime shtesë për përmirësime në bazën ligjore ku duhet të mbështetet LBGj

LBGj mbështetet mbi Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Konventën "Për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Grave", dhe nga të gjitha aktet e tjera ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.¹³⁸ Sidoqoftë, LBGj duhet të marrë parasysh edhe angazhime të tjera ndërkombëtare të Shqipërisë siç janë Konventa e Stambollit dhe Direktivat e BE-së në fushën e barazisë gjinore, praktikat e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) dhe Gjykatës Evropiane të Drejtësisë (GJED), Konventat e ILOs përfshirë konventën C-190. Kështu, LBGj paraqitet si një ligj primar (kornizë) në lidhje me ligjet specifike të cilat duhet të kenë detyrimin të marrin parasysh LBGj-në dhe të aplikojnë kritere dhe standarde për trajtim të barabartë midis gjinive, duke përfshirë në parimet themelore edhe kornizën ligjore të LBGj-së. LBGj gjithashtu duhet të përdoret në çështjet e mosmarrëveshjeve në gjykata. Nuk ka asnjë të dhënë nëse ligji është përdorur deri më tani.

Objekti, qëllimi, parimet themelore dhe përkufizimet e LBGj-së duhet të rishikohen duke marrë gjithashtu parasysh nenin 7 të UDHR, i cili thotë: "Të gjithë janë të barabartë para ligjit dhe kanë të drejtë pa asnjë diskriminim për mbrojtje të barabartë të ligjit".¹³⁹ Gjithashtu neni 2 i UDHR duhet të merret në konsideratë. Trajtimi i barabartë para ligjit sigurohet dhe garantohet nga Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (ICCPR).¹⁴⁰ ICCPR detyrimisht përcakton shtetet për të respektuar dhe siguruar të drejtat e të gjithë individëve në territorin e tyre dhe që janë nën autoritetin e tyre pa diskriminim, duke nxjerrë akte edhe më të përshtatshme për mbrojtjen e këtyre të drejtave. Në nivelin evropian, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) duhet të konsiderohet si një akt me rëndësi të veçantë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të drejtave të familjes. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në shumë raste, ka vendosur praktika dhe standarde për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, përfshirë ato që kanë të bëjnë me mbrojtjen e barabartë të gjinive. Gjykata e Shqipërisë nuk ka prodhuar ndonjë çështje gjyqësore bazuar në LBGj-në ndaj duhet parë mundësia që çështjet e GJEDNJ të merren në konsideratë. Për më tepër, BE ka nxjerrë një numër të madh direktivash që i referohen trajtimit të barabartë të gjinive, kështu që Shqipëria mund t'i marrë parasysh dhe t'i përfshijë ato në legjislacionin kombëtar dhe në LBGj në mënyrë të qartë.

Megjithëse LBGj përfshin nene të rëndësishme, disa prej të cilëve edhe prej natyrës së tyre thjesht deklarative nuk janë zbatuar siç duhet. Për shembull, referojuni nenit 14 të ligjit (Organet e Qeverisjes Vendore), por edhe nene të tjerë të tillë si neni 23 (Vlerësimi i punës së papaguar). Gjithashtu, për shembull në nenin 14/4 kërkohet nga qeveria shqiptare të caktojë një ose disa punonjës lokalë të barazisë gjinore në strukturat e tyre, por nuk përmend caktimin e burimeve të mjaftueshme për të përmbushur këtë detyrim ligjor. Ligji aktual nuk i detyron zyrtarët në ministri dhe në bashki të kryejnë detyrat dhe përgjegjësitë e tyre sipas këtij ligji dhe akteve të tjera ligjore që rrjedhin nga ky ligj dhe legjislacioni në fuqi.

¹³⁸ Article 3 of the LGE.

¹³⁹ Deklaratë Universale e të Drejtave të Njeriut. (1948). Nxjerrë nga <https://ëëë.un.org/en/universal-declaration-human-rights/>

¹⁴⁰ Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (ICCPR). <https://ëëë.ohchr.org/en/professionalinterest/pages/ccpr.aspx>

- a) *Zbaton dhe mbikëqyr zbatimin e këtij ligji, strategjisë kombëtare dhe planit të veprimit për arritjen e barazisë gjinore, si dhe të detyrimeve ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë në fushën e barazisë gjinore si dhe detyrimet ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë në fushën e Barazisë Gjinore;*

Mbi këtë përgjegjësi, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka hartuar shpesh analiza të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore. Sidoqoftë, nuk ka vlerësim të qëndrueshëm dhe të rregullt të ndikimit të kuadrit ligjor që lidhet me barazinë gjinore, siç janë Ligji për Barazinë Gjinore dhe Ligji për Masat Kundër Dhunës në Marrëdhëniet Familjare. Shumica e ndryshimeve në këto ligje kanë ndodhur në mënyrë rastësore, sa herë që lind ndonjë nevojë e momentit apo ndodh ndonjë ngjarje.

Sa i përket angazhimeve ndërkombëtare, ministria përgjegjëse për barazinë gjinore shpesh ka raportuar mbi këto angazhime në mekanizma të ndryshëm raportues ndërkombëtarë, siç janë raportimi periodik për CEDAW, UPR dhe GREVIO. Një ndjekje sistematike e rekomandimeve të marra mungon dhe kapacitetet mund të ndërtohen më tej për të pasur një sistem në vend që ndjek të gjitha angazhimet ndërkombëtare, rekomandimet e marra në mënyrë që të ndjekë progresin dhe të përmbushë detyrimet.

- b) *I propozon Këshillit të Ministrave ndryshime ligjore e nënligjore, nënshkrimin e akteve ndërkombëtare në fushën e barazisë gjinore dhe të të drejtave të grave, si dhe ndërmarrjen e masave të tjera, që synojnë të zhdukin dallimet ndërmjet gjinive në gëzimin e të drejtave dhe ofrimin e mundësive, pasi këshillohet me Këshillin Kombëtar të Barazisë Gjinore;*

Këshilli Kombëtar për Barazinë Gjinore nuk e ka realizuar plotësisht potencialin e tij për të ndikuar në vendimmarrjen dhe drejtimin strategjik në përpjekjet për të arritur barazinë gjinore. KKBGj nuk takohet rregullisht, dhe roli dhe përgjegjësitë e tij mund të përcaktohen më mirë për t'i dhënë mandatit të tij forcë për të nxitur ndryshime. Për më tepër, numri i akteve nënligjore të nxjerra në LBGj-ja është shumë i ulët, duke u kufizuar në akte nënligjore për zhvillimin e strategjive kombëtare për barazinë gjinore, krijimin e Këshillit dhe një për buxhetimin e përgjigjshëm gjinor. Aspekte të tjera të ligjit nuk rregullohen siç duhet përmes akteve nënligjore, të cilat e bëjnë zbatimin e tij mjaft të vështirë.

- c) *bashkëpunon dhe u ofron mbështetje organizatave jofitimprurëse, aktive në fushën e barazisë gjinore;*

Përfshirja dhe pjesëmarrja e organizatave të shoqërisë civile, veçanërisht e organizatave të grave është zhvilluar dhe shënuar mirë në punën e ministrisë përgjegjëse për barazinë gjinore. Ekzistojnë disa mekanizma me të cilët këto organizata janë pjesë e vendimmarrjes dhe politikëbërjes për çështje që lidhen me barazinë gjinore. Së pari, KKBGj-ja ka në përbërjen e tij, përveç agjencive qeveritare, edhe tre përfaqësues të shoqërisë civile që punojnë me të drejtat e njeriut / barazinë gjinore. Meqenëse KKBGj-ja është një nga organet më të rëndësishme këshilluese në përcaktimin e agjendës për barazinë gjinore në vend; pjesëmarrja e shoqërisë civile në të shënon një njohje të rolit të rëndësishëm që OShC-të luajnë në arritjen e fuqizimit të grave.

Një rrugë tjetër për të angazhuar dhe mbështetur organizatat e shoqërisë civile, aktive në barazinë gjinore, është përmes konsultimeve dhe pjesëmarrjes në procesin e hartimit të politikave. OShC-të më shpesh janë një palë kryesore e interesuar në diskutimin dhe hartimin e politikave, ligjeve, strategjive dhe ndërhyrjeve të qeverisë në fushën e barazisë gjinore, veçanërisht në luftimin e dhunës me bazë gjinore. Këto të fundit kanë luajtur një rol të rëndësishëm në krijimin e mekanizmit të koordinuar të referimit për rastet e dhunës, duke miratuar ligjin për barazinë gjinore dhe tre raundet e strategjive kombëtare të barazisë gjinore. Ata janë gjithashtu aktivë në monitorimin e zbatimit të tyre dhe për të ruajtur përgjegjshmërinë e institucioneve të ndryshme qeveritare. Përkundër një niveli të bashkëpunimit dhe njohjes së ndërsjellë midis shoqërisë civile dhe institucioneve qeveritare, ka pak ose aspak mbështetje financiare nga ministria përgjegjëse për barazinë gjinore për punën e organizatave të grave. OShC-të mbështeten pothuajse vetëm tek donatorët për të kryer iniciativat dhe aktivitetet e tyre. Në fushën e ofrimit të shërbimeve, një pjesë e konsiderueshme sigurohet nga organizata joqeveritare dhe mbështetja financiare nga qeveria nuk është bërë një dukuri e rregullt.

d) *organizon edukimin dhe përgatitjen profesionale të nëpunësve për çështjet e barazisë gjinore;*

Ligji për Barazinë Gjinore përcakton Punonjësit e Barazisë Gjinore si pozicione me kohë të plotë brenda administratës publike në nivelin qendror dhe lokal. Megjithatë, aktualisht këto pozicione nuk janë plotësisht funksionale, veçanërisht në ministritë e linjës, ku ato shërbejnë më shumë si pika fokale gjinore me detyra shtesë. Detyrat e tyre nuk parashikojnë plotësisht integrimin gjinor në politikën, planifikimin, buxhetimin dhe proceset e monitorimit në ministritë e tyre përkatëse. Mungesa e nëpunësve të barazisë gjinore me kohë të plotë dhe me aftësi të përshtatshme, paraqet një sfidë për integrimin e gjinisë në të gjithë sektorët.¹⁴¹

Në nivelin qendror, të 11 ministritë kanë caktuar një Punonjës të Barazisë Gjinore. Policia e Shtetit ka gjithashtu një pikë kontakti për çështjet e barazisë gjinore. Sidoqoftë, përkundër këtij titulli, punonjës i barazisë gjinore, këta persona nuk kanë arsimimin dhe / ose trajnimin e duhur për t'u marrë me çështje gjinore. Këta punonjës kanë detyra dhe përgjegjësi të tjera në institucion përveç trajtimit të çështjeve gjinore. Në nivelin lokal, të 61 bashkitë emëruan Punonjës të Barazisë Gjinore. Pavarësisht nga detyrat dhe përgjegjësitë e tyre të zakonshme, këta punonjës në shumicën e rasteve luajnë rolin e Koordinatorit Lokal për menaxhimin e rasteve të dhunës në familje. Ekziston një mungesë e përkufizimit në titullin e punës për personat që merren me çështje gjinore në nivelin lokal dhe qendror. Disa prej tyre janë emëruar Punonjës të Barazisë Gjinore, dhe disa Koordinatorë Lokalë kundër Dhunës në Familje (DV). Të dy punonjësit e barazisë gjinore në nivelin qendror dhe lokal, nuk kanë një përshkrim të qartë të punës. Përshkrimi i punës u përgatit disa vite më parë, por nuk përdoren si duhet. MShMS-ja aktualisht po rishikon përshkrimet e vendeve të punës. Të dy titujt e punës dhe përshkrimet e punës duhet të jenë në përputhje me nenin 13/3 dhe nenin 14/4 të Ligjit për Barazinë Gjinore në Shqipëri.¹⁴²

e) *Ndërton mekanizmat e mbledhjes së statistikave, të ndara sipas gjinisë, në bashkëpunim me Institutin e Statistikave dhe me institucionet e tjera shtetërore, si dhe mbikëqyr mbledhjen dhe përpunimin e tyre;*

Që nga viti 2013 dhe botimi "Burrat dhe Gratë në Shqipëri" ka siguruar të dhëna të ndara sipas gjinisë për një larmi fushash, përfshirë punësimin, kujdesin shëndetësor, statistikën gjyqësore, pjesëmarrjen në vendimmarrje, arsimin etj. Ekzistojnë mekanizma të tjerë të mbledhjes së të dhënave, përfshirë REVALB, sistemi për mbledhjen e të dhënave mbi bazën gjinore dhe dhunën në familje, si dhe statistikën e mbledhura nga agjenci individuale, të tilla si Ministria e Brendshme dhe Ministria e Drejtësisë. Janë bërë përpjekje të rëndësishme për të përmirësuar mbledhjen e të dhënave dhe statistikën mbi barazinë gjinore. Sidoqoftë, duhet të theksohet se këto kryesisht shtyhen përpara nga bashkësia ndërkombëtare dhe financohen përmes fondeve të donatorëve, gjë që vë në pikëpyetje qëndrueshmërinë e tyre afatgjatë dhe pronësinë e institucioneve lokale.

f) *vetë ose në bashkëpunim me institucione të tjera, ndërton dhe realizon veprimtari për edukimin, trajnimin, informimin dhe ndërgjegjësimin e qytetarëve, si dhe nëpunësve e funksionarëve të administratës publike e sistemit gjyqësor mbi konceptin e barazisë gjinore, mosdiskriminimin e gruas, eliminimin e stereotipave gjinorë, kuptimin e drejtë të rolit të femrës e të mashkullit, të nënës e të babait në familje dhe shoqëri;*

Ndërgjegjësimi është një nga metodat kryesore për të sjellë parimet e barazisë gjinore në shoqëri. Ky parim është përcaktuar mirë në Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore (2016-2020), ku objektivi 4.4 është "Rritja e ndërgjegjësimin të shoqërisë për të pranuar barazinë gjinore si një parakusht për zhvillimin". Për të arritur këtë objektivi, parashikohet që deri në fund të vitit 2020, numri i individëve në

¹⁴¹ https://www.unWomen.org/-/media/field%20office%20eca/attachments/publications/country/albania/un%20gender%20brief%20albania%202016_en_ëeb.pdf?la=en&vs=5235

¹⁴² Ligji për Barazinë gjinore në Shqipëri. Marrë nga <https://www.osce.org/albania/36682?download=true>

shoqërinë tonë që besojnë se barazia gjinore është një kusht i domosdoshëm për zhvillimin rritet me 30%. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është e ngarkuar me monitorimin e kapacitetit të stafit në nivelin e qeverisjes qendrore dhe lokale për të garantuar përmbushjen e të drejtave të njeriut. Sektorit të Barazisë Gjinore brenda ministrisë i është besuar të zbatojë llogaridhënien dhe koordinimin, si dhe funksionet e monitorimit për fushat e mbuluara në SKBGJ. Sidoqoftë duhet të theksohet se Objektivi Strategjik 4 (të cilit i përket rritja e ndërgjegjësimit) zë vetëm 7% të të gjithë buxhetit të alokuar për secilin prej objektivave strategjikë.

Për më tepër, ekziston një hendek financues i konsiderueshëm në Planin e Veprimit, i cili parashikohet të mbyllet nga fondet e donatorëve. Duhet të theksohet se ka nisma të organizatave të shoqërisë civile që punojnë për të drejtat e njeriut dhe të drejtat e grave në mënyrë specifike. Këto përfshijnë fushata, seanca informuese, edukim dhe trajnim të popullatës së gjerë për çështje që kanë të bëjnë me barazinë gjinore, nga fuqizimi politik i grave të luftimi i dhunës ndaj grave. Këto aktivitete të ndërgjegjësimit kryhen kryesisht nga organizata të shoqërisë civile dhe ndonjëherë përmbajnë bashkëpunim me agjencitë qeveritare, por ato nuk janë gjithmonë të koordinuara dhe dakorduara me to me qëllim që të përmbushin Planin e Veprimit që shoqëron Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore.

- g) brenda tremujorit të parë të çdo viti, i paraqet Këshillit Kombëtar të Barazisë Gjinore raportin e vitit paraardhës për veprimtarinë e realizuar, ecurinë e punës për arritjen e barazisë gjinore, problemet e hasura dhe rrugët për kapërcimin e tyre;*

Që nga themelimi, KKBGJ-ja ka kryer disa nga detyrat dhe përgjegjësitë e saj, por nuk ka përfituar plotësisht nga kompetencat që i janë dhënë nga Ligji për Barazinë Gjinore për të përcaktuar drejtimin strategjik të agjendës së barazisë gjinore në vend. KKBGJ-ja takohet rrallë dhe mbetet prapa në dhe nuk është e efektshme që të veprojë në përputhje me atë që është shkruar në letër. KKBGJ-ja duhet të forcohet, të takohet rregullisht, të ketë një profil më të lartë dhe të ushtrojë rolin e saj në një mënyrë që përcakton vizionin strategjik dhe objektivat e agjendës së barazisë gjinore për të gjitha agjencitë qeveritare në të ardhmen.

Ligji për Barazinë Gjinore nuk i siguron Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale autoritetin për të vendosur sanksione. Ekziston një seksion për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe sanksionet për shkelje të neneve specifike të ligjit, kryesisht në lidhje me mosrespektimin e kuotave gjinore në partitë politike dhe diskriminimin gjinor në punë, por në këtë drejtim Inspektorati i Punës është i ngarkuar me kryerjen e gjobave dhe çështje të tjera për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve duhet të zgjidhen në përputhje me Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë. Rastet e diskriminimit për shkaqe gjinore në vendin e punës rregullohen gjithashtu në Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Komisioneri përkatës për Mbrojtjen nga Diskriminimi mund të gjobisë ose të përfaqësojë ankuesit në gjykatë. Sipas të dhënave nga DMK, diskriminimi për shkaqe gjinore në vendin e punës, nuk është një praktikë e mirëvendosur ligjore, pasi pak raste janë raportuar pranë këtij institucioni. Nga ana tjetër, gjobat për mosrespektimin e kuotave gjinore fillimisht rezultuan joefektive pasi shumë parti politike preferuan të paguanin gjobat sesa të siguronin kuotën 30% në listat e partive. Futja e sistemit zinxhir për këshilltarët lokalë dhe mospranimi i listave që nuk respektojnë parashikimin e kuotës 50% në zgjedhjet lokale ishte shumë efektive dhe kjo ishte e dukshme në rritjen e menjëhershme të numrit të grave këshilltare në dy zgjedhjet e fundit lokale.

Burimet njerëzore në agjencinë zbatuese

Brenda Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ekziston një Sektor për Barazinë Gjinore, i cili është kryesisht i ngarkuar me koordinimin e punës për barazinë gjinore ndërmjet ministrive të linjës përmes punonjësve të tyre të barazisë gjinore, si dhe në nivelin lokal përmes pikave fokale gjinore dhe / ose koordinatorët kundër dhunës në familje. Në organogramin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Sektori i Barazisë Gjinore përbëhet nga dy specialistë dhe një përgjegjës sektori. Duke marrë parasysh shumëllojshmërinë e gjerë të detyrave të ngarkuara me sektorin përgjegjës dhe

spektrin e gjerë të çështjeve të barazisë gjinore, burimet njerëzore nuk janë të mjaftueshme për të kryer sasinë e punës që kërkohet prej tyre.

Punonjësit e sektorit të barazisë gjinore konsiderohen nëpunës civilë dhe procedura për rekrutimin dhe përfundimin e tyre kryhet bazuar në ligjin nr. 152/2003 "Për nëpunësin civil". Sipas një analize të rolit të drejtorisë, ka disa sfida mënyrën si drejtorja ushtron rolin e saj. Mungesa e burimeve të mjaftueshme financiare, njerëzore dhe teknike janë faktorët më të rëndësishëm që dëmtojnë aftësinë e drejtorisë për të shërbyer si një organ koordinues. Ekziston gjithashtu një mospërputhje midis kornizës ligjore dhe organizative, të cilat nga njëra anë janë rezultat i vendimeve politike dhe rezultat i një papajtueshmërie midis kornizës organizative dhe individuale.

Roli i kontributeve

Ministria përgjegjëse për barazinë gjinore ka një praktikë të mirë konsoliduar të konsultimit me aktorë të ndryshëm, përfshirë joqeveritarë, grupe interesi, partnerë ndërkombëtarë dhe ekspertë. Partnerët ndërkombëtarë përfshihen rregullisht në politikëbërje përmes mbështetjes financiare dhe ekspertëve për agjencitë qeveritare. Këto bëhen përmes komunikimit të rregullt dhe planeve të punës që identifikojnë përparësitë dhe sfidat që duhen adresuar. Nga ana tjetër, organizatat e shoqërisë civile këshillohen, ftohen të japin kontribute ose të ngrenë çështje shqetësuese përmes mjeteve të ndryshme, takimeve, letrave zyrtare dhe postave elektronike dhe mjeteve të tjera të advokimit.

Nevojat e grupeve të cënueshme konsiderohen siç duhet jo vetëm përmes hulumtimit, analizës dhe vlerësimit të kontekstit, por gjithashtu edhe përmes përfshirjes së grupeve joqeveritare që avokojnë për të drejtat e tyre në procesin e politikëbërjes.

Megjithëse Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore përfshin një analizë të situatës dhe mbledh të dhëna nga burime të ndryshme, nuk ka asnjë analizë sistematike dhe vlerësim të ndikimit të zbatimit të dispozitave specifike të Ligjit për Barazinë Gjinore. Treguesit nuk ofrojnë gjithmonë informacion për përgatitjen dhe zbatimin e ligjit. Agjencia e ngarkuar për barazinë gjinore ka përgatitur shumë raporte mbi barazinë gjinore, përfshirë raportimin tek mekanizmat ndërkombëtarë të të drejtave të njeriut. Sidoqoftë, një analizë e plotë e ligjit për barazinë gjinore ndër vite mungon. Në mënyrë të ngjashme, legjislacioni tjetër në lidhje me barazinë gjinore rishikohet më shumë bazuar në dukuri që garantojnë ndryshime, shqetësime të ngritura nga organizata të shoqërisë civile, sfida që dalin nga puna e institucioneve të ndryshme, sesa një analizë e plotë e zbatimit të ligjit në tërësinë e tij dhe neni me artikull.

Përgjegjësitë

Pjesa VII e Ligjit për Barazinë Gjinore vendos përgjegjësinë e vendosjes së gjobave për shkelje të neneve specifike në lidhje me diskriminimin në vendin e punës në Inspektoratin Shtetëror të Punës. Sipas ligjit, shkeljet e neneve të veçanta dënohen me gjobë nga Inspektorati Shtetëror i Punës me një gjobë prej një maksimumi 80,000 lekë në varësi të subjektit mbi të cilin vendoset gjoba. Shkeljet e mëtejshme të ligjit, atëherë kur përbëjnë një vepër penale, trajtohen në përputhje me dispozitat e Kodit Penal.

Një mekanizëm tjetër i parashikuar në Ligjin për Barazinë Gjinore është zgjidhja e mosmarrëveshjeve (neni 30) sipas të cilit "Çdo ankesë për shkeljen e barazisë gjinore sipas këtij ligji do të shqyrtohet ose gjykohet nga organet administrative në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative. Palët, bazuar në zgjedhjen e tyre, sipas rastit, mund të kryejnë çdo procedurë ndërmjetësimi për zgjidhjen me pajtimin e parashikuar në legjislacionin në fuqi, për adresimin e shkeljeve sipas këtij ligji. Si përfundim, organizatat jofitimprurëse të licensuara për ofrimin e shërbimeve sociale mund të përfaqësojnë ose ofrojnë mbështetje në procedurat ligjore në emër të ankuesit.

Prandaj, ligji identifikoi tre mekanizma dhe aktorë të cilët janë të përfshirë në adresimin e ankesave dhe sigurojnë që shkeljet e ligjit të adresohen siç duhet përmes procedurave ekzistuese. Sidoqoftë duhet të theksohet se dispozitat e ngjashme të gjobave dhe sanksioneve për diskriminimin me bazë gjinore në

vendin e punës dhe fusha të tjera sanksionohen gjithashtu në Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i cili ka në dispozicion një mekanizëm institucional për të zbatuar dispozitat e ligji.

Agjencia që merret me barazinë gjinore nuk ka të ngritur një mekanizëm për të marrë dhe adresuar ankesat nga përfituesit e ligjit. Edhe pse fillimisht Inspektorati Shtetëror i Punës ishte nën varësinë e ministrinë përgjegjëse për barazinë gjinore, aktualisht Inspektorati i Punës është nën varësinë e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, për shkak të riorganizimit të degës ekzekutive në vitet e fundit. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nuk ka mekanizma dhe procese të mirëfillta dhe zyrtare për të trajtuar ankesat që vijnë nga shkeljet e ligjit.

Për sa i përket zbatimit dhe rishikimit të ligjit bazuar në përvojën praktike, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ose përmes konsultimit me organizatat e shoqërisë civile ose në kuadrin e funksioneve të kontrollit dhe mbikëqyrjes së Kuvendit të Shqipërisë u përgjigjet sfidave në zbatim. Një shembull i tillë ka qenë funksionimi dhe funksionaliteti i mekanizmave të koordinuar të referimit për adresimin e dhunës me bazë gjinore, ku shqetësimet e ngritura nga palë të ndryshme të interesit kanë çuar në procese rishikimi dhe përpjekje për të përmirësuar funksionalitetin e këtyre të fundit.

Ajo që mungon është një proces i rregullt dhe sistematik i marrjes dhe mbledhjes së të dhënave nga palë të ndryshme të interesit në nivelin lokal ose qendror. Ky proces do të lejonte më shumë marrje të informacionit, ose përmes Këshillit Kombëtar për Barazinë Gjinore ose përmes sektorit përgjegjës për barazinë gjinore në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Takimet dhe konsultimet jo vetëm që duhet të burojnë nga nevoja për të bërë ndryshime në legjisllacionin ekzistues, por gjithashtu duhet të organizohen rregullisht si një mjet për të monitoruar zbatimin e ligjit në mënyrë periodike dhe për të marrë vendime të bazuara në informacion gjatë gjithë procesit të politikëbërjes.

Kuvendi i Shqipërisë

Në një shtet demokratik pushteti buron nga populli. Përfaqësuesit e zgjedhur prej tij janë ata të cilët ushtrojnë pushtetin legjislativ. Detyra kryesore e tyre është të vendosin drejtimin politik të shtetit nëpërmjet shqyrtimit dhe miratimit të ligjeve (funksioni legjislativ). Për arsyen se Kuvendi është organi që legjitimizohet nga vullneti popullor, nëpërmjet zgjedhjeve, ai gëzon një pozitë të fortë në sistemin shtetëror dhe kjo shprehet qartë në Kushtetutën e Shqipërisë. Përveç kësaj Kuvendi gëzon një të drejtë kontrolli mbi organe dhe institucione të tjera kushtetuese apo të krijuara me ligj (funksioni kontrollues), duke i ndaluar në këtë mënyrë këto organe të ndërmarrin, në mënyrë të pavarur, vendime në kundërshtim me vullnetin popullor. Të gjithë anëtarët e Parlamentit kanë përgjegjësinë të përfaqësojnë opinionin e zgjedhësve të tyre gjatë debateve të ndryshme parlamentare në mënyrë të tillë që të shprehin, sa të jetë e mundur, çfarë kërkon shumica e zgjedhësve, që përfaqësohet nga mazhoranca parlamentare.

Struktura dhe organizimi i Kuvendit

Kuvendi i Shqipërisë përbëhet nga 140 deputetë. Ai zgjidhet për një periudhë 4 vjeçare. Kuvendi i Shqipërisë është i përbërë nga një dhomë e vetme dhe anëtarët e tij zgjidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë. Kuvendi i zhvillon punimet e tij vjetore në dy sesione. Ai e organizon veprimtarinë e tij nëpërmjet një akti normativ, që është Rregullorja e Kuvendit, e cila varet drejtpërdrejt vetëm prej normave kushtetuese dhe miratohet me shumicën e të gjithë anëtarëve të Kuvendit (neni 75/2 i Kushtetutës).

Detyrat e Kuvendit

Funksioni legjislativ

Kuvendi është organi, i cili vë në jetë (e bën reale) një nismë legjislativë (e drejta për të propozuar një ligj), duke ushtruar kështu pushtetin që atij i është dhënë me Kushtetutë, pushtetin legjislativ. Të drejtën për të iniciuar një nismë të tillë në më të shumtën e rasteve e ushtron qeveria dhe kjo ndodh sidomos atëherë kur kjo qeveri gëzon shumicën parlamentare dhe si rrjedhojë ekziston probabiliteti më i madh që të arrihet në një rezultat të kënaqshëm të kësaj nisme. Por të drejtën për të iniciuar një nismë ligjvënëse e ka edhe çdo deputet, si dhe 20 mijë zgjedhës (neni 81 i Kushtetutës). Projektligjet e propozuara i nënshtrohen procedurës përkatëse për miratim dhe me shumicën e votave në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të tij, një projektligj bëhet ligj. Por ka dhe raste kur në Kushtetutë është parashikuar një shumicë e cilësuar për të arritur nga një projekt në një ligj. Kjo parashikohet për ato nisma legjislativë siç mund të jenë amendimet kushtetuese dhe ligje të tjera të cilësuar shprehimisht në Kushtetutë.

Funksioni elektoral (për të zgjedhur)

Anëtarët e Kuvendit janë përgjegjës për zgjedhjen e Kryeministrit, kabinetit qeveritar dhe për miratimin e programit të Këshillit të Ministrave. Si rrjedhim i kësaj qeveria është e varur (lidhur ngushtë) nga shumica parlamentare. Gjithashtu, nga Kuvendi zgjidhet dhe Presidenti i Republikës. Por nuk janë vetëm këto organe kushtetuese, që zgjidhen nga Kuvendi. Kuvendi ngarkohet nga Kushtetuta dhe me përgjegjësinë për zgjedhjen e tre anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese. Anëtarët përzgjidhen ndërmjet kandidatëve të renditur në tri vendet e para të listës nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, sipas ligjit. Përsa i përket gjyqësorit Kuvendi gëzon të drejtën të zgjedhë 5 anëtarë të Këshillit të Lartë të Gjyqësorit si dhe Inspektorin e Lartë të Drejtësisë. Çka vlen të theksohet është dhe ajo që parashikon Kushtetuta në lidhje me gjyqësorin (neni 135 i Kushtetutës), ku Kuvendit i parashikohet e drejta të krijojë me ligj gjykata për fusha të veçanta, por jo gjykata të jashtëzakonshme. Nga Kuvendi zgjidhet edhe Avokati i Popullit dhe po me kërkesë të motivuar të deputetëve, Kuvendi vendos për shkarkimin e tij. Kuvendi zgjedh gjithashtu Prokurorin e Përgjithshëm mes 3 kandidatëve të propozuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë si dhe 5 anëtarë të këtij Këshilli.

Funksioni kontrollues

Ndarja e pushteteve e realizuar në praktikë parashikon që Kuvendi (legjislativi) të monitorojë dhe të kontrollojë mënyrën se si Qeveria (ekzekutivi) vë në zbatim kuadrin ligjor të nxjerrë nga Parlamenti. Që kjo të bëhet efektive Kuvendit i janë dhënë një sërë kompetencash kontrolli. Pra, Kuvendi zotëron një sërë mekanizmash ligjorë kontrolli, të cilat i ushtron mbi pushtetin ekzekutiv dhe institucione të tjera qendrore të rëndësishme kushtetuese ose të krijuara me ligj. Kjo nxjerr në pah pozitën e tij të konsoliduar si një organ qendror kushtetues me pushtet përveçse ligjvënës, ashtu dhe kontrollues, por kjo gjithmonë e parë nën dritën e parimit të ndarjes së pushteteve (neni 7 i Kushtetutës). Në kuadrin e kompetencave të kontrollit vlej të theksohet kontrolli që ai ushtron mbi ekzekutivin nëpërmjet instrumenteve të tillë ligjorë siç janë seancat e pyetjeve, mocioneve e debateve parlamentare mbi çështje të implementimit të politikës nga Qeveria, zbatimit të ligjeve dhe qëndrimeve të saj mbi çështje të ndryshme. Një mjet tjetër i rëndësishëm që i jepet Kuvendit është dhe e drejta për ngritjen e komisioneve hetimore për të shqyrtuar një çështje të veçantë. Vlen të theksohet, se përfundimet e nxjerra nga këto komisione nuk janë detyruese për gjykatat, por mund t'i njoftohen Prokurorisë, e cila i vlerëson, sipas procedurës së caktuar ligjore. Pra, arrihet në përfundimin se roli i Kuvendit nuk qëndron vetëm në bërjen e ligjeve, por edhe në kontrollin dhe drejtimin politik të vendit.

Rrjeti i Komiteteve Parlamentare për të Drejtat e Njeriut dhe Barazinë Gjinore në Ballkanin Perëndimor (HUGEN)

Fondacioni Westminster për Demokraci (WFD) është organi publik i Mbretërisë së Bashkuar, i përkushtuar për të mbështetur demokracinë në botë. Duke funksionuar drejtpërdrejt në mbi 40 vende, WFD punon me parlamentet, partitë politike dhe grupet e shoqërisë civile si në zgjedhje për të ndihmuar në sisteme politike më të drejta dhe më gjithëpërfshirëse, të përgjegjshme dhe transparente. Duke qenë aktiv në Ballkanin Perëndimor që nga viti 1992, WFD është në gjendje të mbështesë përpjekjet për të përmirësuar qeverisjen në rajon, institucionet politike, sundimin e ligjit, barazinë gjinore dhe pajtimin pas konfliktit.

WFD ka nisur një program tridhjetë-mujor (nga prilli 2019 deri në nëntor 2021), i cili synon të krijojë një rrjet të të drejtave të njeriut dhe barazinë gjinore të komisioneve parlamentare (HUGEN) në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Programi mbështetet dhe financohet nga Ministria e Punëve të Jashtme Norvegjeze dhe përfshin komisione parlamentare nga tetë parlamente nga rajoni i Ballkanit Perëndimor. Programi zbatohet nga zyra rajonale e WFD në Beograd në bashkëpunim me zyrat e vendit në të gjithë rajonin.

Duke punuar në të gjithë rajonin e Ballkanit Perëndimor, programi do të mbështesë anëtarët e parlamentit dhe stafin parlamentar në forcimin e bashkëpunimit parlamentar në rajon, rritjen e kapaciteteve mbikëqyrëse të parlamenteve dhe përmirësimin e zbatimit të standardeve më të mira të të drejtave të njeriut dhe barazisë gjinore.